



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

# SHËRBIM KONSULENCE, PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE, PËR KATËR BASHKI, VLORE, SARANDË, HIMARË, KONISPOL

Pjesa I: Vlerësimi dhe Raporti Analizës

## VLORE



BASHKIA VLORE



THYMIO PAPAYANNIS AND ASSOCIATES INC.  
spatial planning and design





**SHËRBIM KONSULENCE,  
PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE,  
PËR KATËR BASHKI, VLORE, SARANDË, HIMARË, KONISPOL**

Pjesa III: Projekt-Plani i Zhvillimit të Territorit

Vlorë

Data: 30 Nëntor 2016

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE .....</b>	<b>5</b>
<b>1.1 Ndarja e Territorit në Pesë Sisteme Territoriale .....</b>	<b>5</b>
1.2 ZONIMI SIPAS KATEGORIVE BAZË DHE NËNKATEGORIVE TË PËRDORIMIT TË PROPOZUAR TË TOKËS .....	9
1.3 Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi .....	29
1.4 POZICIONIMI I RRJETEVE TË INFRASTRUKTURËS SI EDHE KUSHTET TEKNIKE PËR REALIZIMIN E TYRE.....	33
1.4.1 <i>Transporti ekzistues</i> .....	33
1.4.2 <i>Infrastruktura publike ekzistuese</i> .....	34
1.4.2.1 <i>Infrastruktura rrugore</i> .....	34
1.4.2.2 <i>Furnizimi me ujë</i> .....	43
1.4.2.3 <i>Rrjeti i kanalizimeve</i> .....	51
1.4.2.4 <i>Furnizimi me energji dhe telekomunikacioni</i> .....	53
1.4.2.5 <i>Menaxhimi aktual i mbetjeve urbane</i> .....	55
1.4.2.6 <i>Hapësirat e gjelbërta dhe publike</i> .....	56
1.5 ZONAT E RËNDËSISË KOMBËTARE, TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE MONUMENTET, SHOQËRUAR ME PROPOZIMET PËR ZGJERRIMIN E TYRE.....	60
1.6 ZONAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN .....	65
1.7 TIPOLOGJITË E PROPOZUARA HAPËSINORE DHE METODAT E NDËRHRYJES NË TERRITOR.....	68
1.8 PËRCAKTIMI I NJËSIVE QË DO T'Ë NËNSHTROHEN HARTIMIT TË PDV-VE SIPAS LIGJIT .....	79
1.9 SHPËRNDARJA E POPULLSISË DHE PARASHIKIMIET DEMOGRAFIKE .....	81
1.10 PLANI I STREHIMIT SOCIAL .....	83
<b>2. PLANI I MBROJTJES SË MJEDISIT .....</b>	<b>85</b>
2.1 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E PEIZAZHIT NATYROR DHE KULTUROR .....	90
2.2 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E ELEMENTEVE UJORE .....	92
2.3 PARASHIKIMET PËR SHTIMIN DHE/OSE ZGJERIMIN E HAPSIRAVE TË GJELBRA DHE MBROJTJA E BIODIVERSITETIT96	
2.4 PARASHIKIMI I VARIANTEVE PËR ZGJIDHJE TË PROBLEMATIKËS SË EVIDENTUAR PËRSA U PËRKET HOTSPOTEVE97	
2.5 PARASHIKIMET PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJËRIT .....	98
2.6 ZHURMAT DHE NDOTJA AKUSTIKE.....	100
2.7 PARASHIKIME PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE .....	100
2.8 PARASHIKIME PËR MBROJTJEN E TOKËS .....	102
2.9 VEPRIMI MBI ASETET E BASHKISË VLORË/ KOHEZIONI SOCIAL .....	103
<b>3. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE .....</b>	<b>106</b>
3.1 INFRASTRUKTURË PUBLIKE E PROPOZUAR.....	106
3.1.1 <i>Transporti i propozuar</i> .....	106
3.1.2 <i>Infrastrukturë rrugore e propozuar</i> .....	108
3.2 RRJETI I PROPOZUAR I INFRASTRUKTURES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE.....	112
3.2.1 <i>Rrjeti i propozuar i furnizimit me uje</i> .....	114
3.2.2 <i>Rrjeti i propozuar i kanalizimeve</i> .....	119
3.2.3 <i>Rrjeti i furnizimit me energji dhe telekomunikacioni</i> .....	127
3.2.4 <i>Menaxhimi i mbetjeve urbane</i> .....	131
3.3 KONSIDERATA MBI PLANET E NIVELEVE TË TJERA DHE NDIKIMI I TYRE MBI TERRITOR.....	132
3.4 TIPOLOGJIA DHE SHPËRNDARJA NË TERRITOR E SHËRBIMEVE SOCIALE .....	133
<b>4. PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PPV.....</b>	<b>160</b>
4.1 FAZAT E ZBATIMIT TË ZHVILLIMIT, TË NDARA NË PERIUDHA KOHORE BRENDA VLEFSHMËRISË SË PLANIT. ....	160
4.2 KOSTO E PËRGJITHSHME PËR ZBATIMIN DHE AKTIVITETET KRYESORE TË FINACUARA TË SHOQËRUARA ME PLANIN E INVESTIMEVE KAPITALE. ....	171
4.3 INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PPV .....	182

4.4 NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË KUADRIN LIGJOR DHE ADMINISTRATIV NË NIVEL VENDOR .....	190
4.5 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TEMRMAT E REFERENCËS PËR PLANET VENDORE .....	191
4.6 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCËS PËR PLANET SEKTORIALE.....	195
4.7 EVIDENTIMI I FAKTORËVE QË MUND TË SHKAKTOJNË NJË RISHIKIM TË PJESSHËM TË PPV .....	197
<b>5. SHTOJCA E PPV-VE.....</b>	<b>198</b>
<b>2. PROPOZIME TË PPV-SË .....</b>	<b>199</b>
<b>6. RAPORTI PËR KAPACITETET INSTITUCIONALE .....</b>	<b>205</b>
6.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DEPARTAMENTIT TË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT BASHKIA VLORË.....	206
6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki .....	207
6.1.2 Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit.....	209
6.1.2.1 Planifikim pro-aktiv; takime me përfaqësuesit e komunitetit dhe grupeve të interesit për përgatitjen e planeve dhe raporteve.....	210
6.1.2.2 Nevoja për infrastrukturë dhe lehtësimin e kërkesave të agjensive të shërbimeve.....	211
6.1.2.3. Asistenca për procedurat e legalizim-rregjistrim të pronës dhe ballafaqime me çështje të tjera të planifikimit dhe të zhvillimit .....	211

## Lista e Tabelave

Tabela 1 Ndarja e Territorit sipas Pesë Sistemeve Territoriale.....	7
Tabela 2 Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë.....	26
Tabela 3 Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi .....	30
Tabela 4 Kategorite e Sistemit Rrugor .....	39
Tabela 5 Projektionet e popullsisë 2011-2031 Bashkia Vlorë .....	81
Tabela 6 Statusi i banimit të banesës.....	83
Tabela 7 Kërkesat Cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE.....	93
Tabela 8 Monitorimi i gurove dhe rehabilitimi .....	98
Tabela 9 Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP) .....	98
Tabela 10 Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t`u monitoruar .....	99
Tabela 11 Objektivat për reduktimin e mbetjeve.....	102
Tabela 12 Monitorimi i tokës bujqësore .....	102
Tabela 13 Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në Bashkinë Vlorë.....	103
Tabela 14 Standardet e kërkuarapër shërbimet sociale në Shqipëri.....	135
Tabela 15 Të dhënat për përlllogaritjen e popullsisë së turizmit .....	136
Tabela 16 Shkollat 9-vjecare (gjendja dhe nevojat e tanishme) .....	139
Tabela 17 Shkollat e mesme (gjendja dhe nevojat e tanishme) .....	140
Tabela 18 Kopshtet (gjendja dhe nevojat e tanishme) .....	140
Tabela 19 Standardet e aplikuara per Facilitetet kryesore Publike dhe Urbane.....	143
Tabela 20 Normat për ambientet arsimore .....	147
Tabela 21 Aplikimi I standardeve të parkimeve në plazh.....	153
Tabela 22 Arsimi në njësinë administrative Novosele.....	155
Tabela 23 Arsimi në njësinë administrative Orikum .....	155
Tabela 24 Arsimi për njësinë administrative Shushice.....	156
Tabela 25 Shëndetësia në njësitë administrative Orikum dhe Shushicë .....	157

## Lista e Figurave

Figura 1 Rezervuarët me ujë të ëmbël .....	47
Figura 2 Shetitorja e Vlorës .....	57
Figura 3 Sheshi Pavarësia.....	58
Figura 4 Harta e shpërndarjes së Monumenteve të kulturës në Vlorë .....	61
Figura 5 Shpella e Haxhi Alisë (majtas); Shpella e Shëngjergjit (Bletës) (djathtas) .....	104
Figura 6 Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore.....	113
Figura 7 Poli ekonomik Vlorë-Fier-Berat.....	132

## Lista e Hartave

Harta 1 - Pesë Sistemet territoriale .....	8
Harta 2-Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara .....	12
Harta 3-Nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara.....	28
Harta 4-Njësitë Strukturore.....	32
Harta 5-Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm i propozuar.....	50
Harta 6- Hapësirat publike, rrugët e biçikletave dhe këmbësore të propozuara.....	59
Harta 7- Harta e zonave e objekteve historike të propozuar .....	64
Harta 8-Zonat, polet, korridoret ekonomik të propozuar .....	67
Harta 9-Harta e tipologjisë së ndërtimeve .....	71
Harta 10-Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar.....	78
Harta 11-Zonat me prioritet zhvillimi dhe zonat subject i PDV .....	80
Harta 12-Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore.....	89
Harta 13-Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar .....	118
Harta 14-Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar .....	126
Harta 15-Rrjeti i furnizimit me energji të propozuar .....	130
Harta 16-Objektet e shërbimeve sociale të propozuara .....	159

# 1. Plani i Propozimeve Territoriale

## 1.1 Ndarja e Territorit në Pesë Sisteme Territoriale

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) është drejtimi i zhvillimit të sistemit urban të banimit dhe harmonizimi i tij me 4 sistemet e tjera në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë (Ligji nr.107/2014, Neni 20). Në këta kontekst, ruajtja, mënyra e përdorimit dhe, sipas rastit, konsolidimit të sistemeve të tjera territoriale janë pjesë e këtij objekti. Pikërisht për qëllime planifikimi dhe menaxhimi, territori ndahet në 5 sisteme territoriale, të cilat përcaktohen në nivel makroplanifikues që në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, dhe detajohen përmes Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së PPV-së. Propozimet territoriale të prezantuara në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Vlorë, të detajuara në këtë dokument, janë reflektuar edhe në sistemet territoriale të propozuara, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit (VKM nr.671), si mëposhtë:

### *Sistemi urban*

Ky sistem përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme në territor. Analiza e këtij sistemi jap një vështrim të përgjithshëm të të gjithë peizazhit të ndërtuar dhe të theksojë llojshmërinë tipologjike të pranishme në zonën e territorit bashkiak. Zonat e zhvillimit territorial urban përbejnë një pjesë të vogël të territorit të Bashkisë Vlorë dhe i referohen zonave urbane ekzistuese, duke përfshirë dhe vendbanimet e reja, zonat turistike, dhe aktivitete të ndryshme ekonomike.

### *Sistemi infrastrukturor*

Ky sistem përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar dhe në nivel vendor. Analiza dhe hartëzimi i këtij sistemi dëshmon për llojshmërinë e gjerë të mjeteve të lëvizjes dhe përshkueshmërinë e mundshme në gjithë territorin me anën e pranisë së një rrjeti të shpërndarë të rrugëve të shtruara dhe të pashtuara. Sistemi i infrastrukturës përbëhet nga rrjeti kombëtar dhe rajonal i rrugëve, rrjeti hekurudhor, portet dhe infrastruktura urbane, rrjeti i furnizimit me ujë dhe rrjeti i kanalizimeve. Pjesa më e madhe e sistemit infrastrukturor është e përqendruar në qytet dhe në periferi të zonës urbane të Vlorës. Ky sistem përmban edhe infrastruktura të tjera si shërbime të furnizimit me energji elektrike dhe të mbetjeve urbane.

### *Sistemi bujqësor*

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Në përgjithësi, në tokat bujqësore ndalohet zhvillimi për shkak të vlerës së saj produktive dhe ndikimit në rritjen e ekonomisë së zonave rurale dhe mundësisë së shpërndarjes së të ardhurave lokale. Në mënyrë të pashmangshme një pjesë e kësaj zone është shndërruar gradualisht për përdorim urban (zgjerimi i zonave të banimit, aktiviteteve produktive ose turizmit) në varësi të kërkesave dhe nevojave për zhvillimin ekonomik.

#### *Sistemi natyror*

Zonat natyrore janë në përgjithësi zona ku përjashtohet zhvillimi por gjithashtu shërbejnë për qëllime të burimeve rekreative. Ata ndahen në kategori të veçanta dhe tiparet e tyre natyrore si shpatet dhe pyjet me pisha bëhen “pengesa” natyrore që kufizojnë dhe orientojnë zhvillimin urban. Të gjithë elementet e sistemit natyror janë hartëzuar me kujdes dhe së bashku formojnë sistemin natyror dhe përshkruajnë mundësinë e tyre drejt një të ardhmeje të qëndrueshme për rajonin.

#### *Sistemi ujor*


Të gjithë elementet që lidhen me ujin përbëjnë sistemin ujor. Uji përbën një nga burimet madhore të territorit. Territori ofron një pasuri ujërash, por për shkak të keqmenaxhimit dhe ndotjes, i njëjti territor vuan nga një pamjaftueshmëri kronike e ujit. Përveç rivendosjes së një përdorimi më racional të ujit, kanalet dhe lumenjtë mund të luajnë një rol themelor në lehtësimin e depërtimit të gjerë fizik të territorit. Lumenjtë dhe kanalet mund të bëhen një “hapësirë publike” territoriale që ka fuqinë të riorientojë territorin drejt burimeve të tij më të çmuara.

Përgjithësisht, kjo PPV ka adaptuar një qasje konservative përse i përket konvertimit të sistemeve territoriale, duke u munduar të ruajë sa më shumë tokat e sistemit bujqësor dhe natyror. Për këtë arsye, PPV-ja propozon kryesisht tipologji ndërhyrjeje në territor që kanë të bëjnë me konsolidimin apo rigjenerimin e përdorimeve ekzistuese për të përmbushur nevojat ekzistuese edhe ato të propozuara për zhvillimin e Bashkisë Vlorë.

**Tabela 1 Ndarja e Territorit sipas Pesë Sistemeve Territoriale**

<b>Sistemet Territoriale</b>	<b>Sipërfaqe (ha)</b>	<b>Novosela</b>	<b>Shushice</b>	<b>Qender</b>	<b>Vlore</b>	<b>Orikum</b>	<b>Total</b>
<b>Sistemi Urban</b>	Ekzistuese	345.29	179.56	574.85	1405.38	414.31	<b>2919.38</b>
	E propozuar	369.96	200.17	637.13	1421.20	490.61	<b>3119.07</b>
<b>Sistemi Natyror</b>	Ekzistuese	3120.50	858.63	1581.50	281.24	29438.58	<b>35280.45</b>
	E propozuar	3156.80	849.02	1734.32	281.06	29418.93	<b>35440.13</b>
<b>Sistemi Bujqesor</b>	Ekzistuese	7301.01	2731.60	5193.55	928.35	3328.91	<b>19483.42</b>
	E propozuar	7266.44	2719.47	4736.96	772.61	3252.34	<b>18747.82</b>
<b>Sistemi Ujor</b>	Ekzistuese	5451.59	247.65	466.86	0.00	415.23	<b>6581.32</b>
	E propozuar	5425.23	247.65	697.08	3.06	417.24	<b>6790.28</b>
<b>Sistemi Infrastrukturor</b>	Ekzistuese	372.61		90.36	126.13	68.12	<b>657.22</b>
	E propozuar	372.17	0.07	101.65	264.71	86.18	<b>824.79</b>





Harta 1 - Pesë Sistemet territoriale

## **1.2 Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës**

Komponenti themelor i Planit të Zonimit është harta e propozuar e përdorimit të tokës. Çdo zonë e propozuar, përfshin parimet e zhvillimit, që do të shprehet në formën e rregullores. Procesi i zonimit, në vetvete, ka një rëndësi strategjike për të bërë planifikimin dhe është i bazuar në praktikën më të mira dhe eksperiencën profesionale të Konsulentit. Një qasje sistematike, e cila merr në konsideratë një sërë parimesh udhëzuese, normash ekzistuese, si edhe kufizimet kryesore në nivel kombëtar, është hartuar për të mbështetur procesin e zonimit dhe për të minimizuar zgjedhjet arbitrare, duke synuar paralelisht planifikimin e një sërë rregullash të thjeshta dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i cili do të lehtësojë procesin e zbatimit.

### *Parimet gjithëpërfshirëse të zonimit*

Parimet e procesit të zonimit, të përdorura në krijimin e Planit të Zonimit, kanë marrë parasysh evolucionin historik të zonës, si edhe diferencimin gjeografik dhe morfologjinë e territorit, të cilat krijojnë një strukturë hapësinore unike të bregdetit të Vlorës. Në të njëjtën kohë, procesi i zonimit përfshin edhe filozofinë e qëndrueshmërisë, të miratuar në nivel global me konsideratë të veçantë në udhëzimet e politikave kombëtare dhe praktikën e suksesshme të ndjekura në vendet evropiane. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor përpiqen të krijojnë barazi dhe drejtësi brenda zonës së planifikimit, duke ruajtur edhe rritjen e potencialit të zhvillimit për brezat e ardhshëm.

Një detyrë e rëndësishme në procesin e zonimit është identifikimi dhe propozimi i zonave urbane dhe rurale të zgjerimit për çdo njësi të zonës së studimit, si edhe përcaktimi i zonave të reja të zhvillimit. Kjo nënkupton një seri vendimesh që janë të bazuara në:

- i. vizionin hapësinor për zhvillimin e ardhshëm në bashkëpunim me bashkinë;
- ii. identifikimin e nevojave programore në bazë të parashikimeve shkencore, adaptimin e standardeve kombëtare dhe praktikën më të mira ndërkombëtare;
- iii. detajimin e hollësishëm të tokës për çdo lokalitet në studim;
- iv. planifikimin ekzistues dhe rregulloren e kufizimeve.

Mënyra se si faktorë të ndryshëm janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit të nënndarjeve, shpjegohet si më poshtë:

### *Modelet primare të përdorimit të tokës*

Kjo përfshin evidentimin e përdoruesve primarë të tokave, që ndodhen në nënndarjet ekzistuese në nivel rajonal, duke përfshirë të gjithë territorin e bashkisë. Një klasifikim i parë është bërë ndërmjet tokës urbane dhe asaj jo-urbane, bujqësore dhe sistemeve natyrore të zonës së planifikimit. Zona është identifikuar fillimisht sipas përdorimit kryesor të tokës dhe në rastet kur mbizotëron një larmi përdorimesh, duhet të bëhen nënndarje të tjera, që korrespondojnë me përdorimin ekzistues. Konsulenti ka përdorur klasifikimin e hartave PINS Bregdeti për klasifikimin e zonave si tokë urbane, tokë bujqësore, pyje dhe kullota.

#### *Ndarja dytësore e përdorimit të tokës*

Në një fazë të dyte, për ndarjen e zonave të ndryshme, janë marrë parasysh karakteristikat e veçanta brenda një modeli të përdorimit kryesor të tokës. Kjo përfshin studimin e ndryshëm për zona të ndryshme, në të cilin bëhet dallimi mes zonave të banuara dhe zonave me karakter të përzier (banim i kombinuar me veprimtari të tjera), si dhe nivelet e ndryshme të densitetit. Analiza është bërë në mënyrë të ngjashme, edhe pse me më pak hollësi për kategoritë jo-urbane të tokës, sidomos në zonat që janë identifikuar si zona zhvillimi nga vizioni hapësinor.

#### *Zhvillimi historik*

Përcaktimi i strukturës hapësinore ka marrë në konsideratë procese të ndryshme të zhvillimit urban, të cilat kanë përcaktuar karakterin e peisazhit, që është formuar nga vendndodhja e zonave dhe rrethinat e tyre kufitare. Kjo nënkupton një trajtim të diferencuar midis pjesëve malore dhe zonës në drejtim të detit, në lidhje me vendndodhjen e zhvillimeve të reja, si edhe mënyrën se si zona të ndryshme janë të lidhura me njëra - tjetrën. Në shkallë urbane ajo përfshin konsideratat për zonat e ndërtuara në kohë dhe regjime të ndryshme, lagjet e vjetra në zonat historike dhe rolin historik të lokaliteteve të caktuara brenda qytetit.

#### *Sistemi Infrastrukturor - Referenca për hierarkinë e rrjetit rrugor*

Nënndarjet hapësinore të zonave të zhvillimit janë kryer në përputhje me hierarkinë e rrjetit rrugor. Zonat homogjene të banimit (lagjet) dhe zonat periferike (fshatrat) duhet të përcaktohen dhe jo të përshkohen nga arteriet rrugore urbane (kryesore dhe dytësore), dhe ato ndërrurbane (kombëtare ose rajonale). Vëmendje e veçantë i është kushtuar artikullimit të trafikut automobilistik në brendësi të qendrës së zonave tradicionale dhe atyre turistike, si edhe atyre që lidhen me ambientet ujore, me qëllim për të shmangur parandalimin e varësisë së zonave të banuara me detin. Kategorizimi i hierarkisë së rrjetit ekzistues dhe atij të ri rrugor në çdo zonë, u bë paralel me procesin e zonimit të shfrytëzimit të tokës.

#### *Referenca të kufizimeve gjeografike*

Nënndarja sipas kufizimeve gjeografike (lumenj, shpate, kodra, fusha etj), është një qasje shumë praktike në procesin e përcaktimit më të hollësishëm të zgjerimeve urbane dhe atyre periferike, si edhe të zonave të reja të zhvillimit. Në fazën e analizës Konsulenti identifikoi në kontekstin e Hartave Përrjashtimore, fushat dhe kriteret e përjashtimit të zhvillimit, të bazuar në përkufizimin e zonave natyrore, sipërfaqet e shpateve të pjerrëta, zonat e prirura për përmytje, sikurse ato të mbrojtjes së burimeve ujore sipas legjislacionit kombëtar dhe PINS Bregdeti. Në mënyrë të ngjashme janë vendosur një sërë kriteresh për zonat e mbrojtjes mjedisore dhe peisazheve, të cilat marrin në konsideratë parametrat topografikë dhe vizual, të tilla si mbrojtja e majave të kodrave, grykave dhe luginave, deltave aktive, etj, sikurse përmendet në pikat e mëposhtme:

- *Mbrojtja e sistemit natyror*


Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.

- *Sistemi Bujqësor*

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me toka bujqësore. Në veçanti:

Mbrojtjen e tokave bujqësore primare në zonën fushore të Novoselës, Shushicës dhe Orikumit. Mbrojtjen e peisazheve kulturo-bujqësore, të cilat pasqyrojnë historinë e bujqësisë tradicionale në rajon, duke përfshirë ullishtat e lashta, që janë përcaktuar nga zonimi i territorit.



Harta 2-Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara

Përveç faktorëve të mësipërm, ndarja e zonave dhe përcaktimi i zonave të zhvillimeve të reja, si edhe zonat e reja të zgjerimit, janë bazuar në parimet e mëposhtme duke marrë në konsideratë udhëzimet ekzistuese dhe praktikat më të mira të vlerës universale, si me poshtë vijon:

i. *Përqendrimi i zhvillimit*

Bazuar në parimet e PINS Bregdeti, zonimi ka për qëllim të mbështesë një numër të kufizuar polesh zhvillimi, të identifikuar aktualisht me ndikim të ulët, duke respektuar nevojën primare për të ruajtur vlerën e një peizazhi thelbësisht të paprishur dhe të pazhvilluar në shkallë rajonale. Zonimi synon në këtë mënyrë të shmangë zhvillimet sporadike (të shpërndara, autonome), që ndikojnë në natyrën e virgjër të peizazhit në tërësi të Bregdetit Jugor dhe komprometojnë vlerën e saj të përgjithshme duke kufizuar përfitimet potenciale në ato ekonomike.

ii. *Racionalizimi i zhvillimeve ilegale*

Zonat e zgjerimit urban janë përcaktuar për lehtësimin, racionalizimin dhe konsolidimin e zhvillimit ekzistues sporadik, dhe/ose të paligjshëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të politikës së planifikimit bregdetar, strategjive dhe planeve, si edhe me skemat përkatëse të planifikimit.

iii. *Përdorimi ekonomik i infrastrukturës*

Zonimi ka mbështetur shfrytëzimin ekonomik të infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të propozuar, pa shkaktuar dëmtime gjatë përdorimit.

iv. *Homogjeniteti i zonave*

Zonimi ka siguruar rregulla të plota në mënyrë të thjeshtë, që do të jenë të lehta për t'u zbatuar. Shkalla e zonave duhet të marrë parasysh:

- Sigurimin e një zonë të një madhësie absolute, në mënyrë që të shmanget një strukturë e fragmentuar urbane dhe rregulloreje të komplikuar, duke ruajtur korrektësinë brenda morfologjisë urbane.
- Të mund të përgjithesojë përdorimin sipas përdorimit kryesor në çdo zonë. Për shembull, një zonë rezidenciale do të jetë përshkruar si një zonë homogjene, pa pasur nevojën për të detajuar në një hartë të përdorimit të tokës hapësirat publike të hapura, zonat e parkimit që gjenden brenda tij, etj.

Bazuar në mjetet metodologjike të paraqitura më lart dhe përkufizimet e 14 kategorive bazë të përdorimit të tokës është përdorur sipas nenit 76 të VKM 671 të 2015. Sistemi i klasifikimit të zonave të përdorimit të tokës, është analizuar më tej nëpërmjet

nënkategorive brenda çdo zone të përdorimit të përgjithshëm të tokës, në lidhje me destinacionin e tij të dëshiruar. Konsulenti ka konsideruar dokumente e PPK edhe PINS Bregdeti të miratuar, si një udhëzues kryesor për të përcaktuar metodologjinë e përdorimit të tokës për planin lokal duke përfshirë dhe kufizimet e saj, si edhe sigurimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore të miratuara rishtazi për planifikimin territorial. Sistemi i propozuar i klasifikimit, i cili është paraqitur më poshtë dhe është reflektuar në hartat e Përdorimit të propozuar të Tokës, do të finalizohet në formulimin e Rregullores Lokale.

Për të siguruar reliazimin e objektivave të përcaktuar në vizionin për zhvillimin e territorit, PPV përcakton kategoritë dhe nënkategoritë sipas Përdorimit të Propozuar të Tokës për secilën nga njësitë strukturore të përcaktuara. Përkufizime dhe propozime të lidhura me kategoritë e përdorimit të tokës përshkruhen më poshtë:

### **1. N-Tokë natyrore**

Nëndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

- Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.
- Përdorimi N-Tokë natyrore, përfshin, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin dhe biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme.

Brenda kategorisë N- Tokë natyrore janë identifikuar 8 nën-kategoritë:

- N1 -Rezervë strikte natyrore [Zona A1 - Strikte e Mbrojtur (K.I)].
- N2- Zona per Rekreacion Natyror [Zona A2 (Rezervat natyror i menaxhuar (K.IV) Llogara, Karaburun; Peizazh i mbrojtur (K.V) Vjosa, Narta)].
- N3- Zona Buferike [Zona B (Rezervat natyror i menaxhuar (K.IV) Llogara, Karaburun)].
- N4- Zona Rekreative (Ekoturizëm) [Zona D2 (Rezervat natyror i menaxhuar (K.IV), Llogara, Karaburun)] janë zona të lejuara për përdorim të parashikuara sipas MP të Butrintit për zonat D të projektuara.
- N5- Rrafshnaltat strategjike dhe luginat e thella. Brigjet bregdetare, shpatet e larta, shkëmbinjt bregdetare, zonat me zhvillime të ndaluara, hapsirë publike për në plazh – zona me zhvillim të ndaluar.
- N6- Zonat e mbrojtura të peizazhit (përcaktuar me kriterin viziv, zonat me zhvillim të ndaluar, peizazh publik) - janë lejuar vetëm funksionet me përdorim rekreativ sikurse është belvedere , shtigjet, zonat e pushimit.

- N7- Tokë Natyrore (mbetet zonë natyrore) dhe që mund të lejohet të zhvillohet në disa raste me intensitet të ulët.
- N8 – Plazhet janë zona me ndalim zhvillimi.

Sipërfaqet me përdorim N-Tokë Natyrore, siç tregohen edhe në hartën e propozuar për përdorimin e tokës, janë të përqëndruara kryesisht në njësitë administrative. Më poshtë po interpretojmë sistemin natyror në Bashkinë Vlorë.

Në kategoritë N1, N2, N3, N5 dhe N6 janë përfshirë burimet natyrore kryesore të Bashkisë, të cilat përfshijnë zonat e pyejeve dhe vijat natyrale bregdetare.

Një përqindje e vogël e territorit të Bashkisë është e mbuluar me pyje. Në bazë të ligjit 8906/2002 neni 12 parashikohet që:

- i. Pyjet në zonat e mbrojtura përjashtohen nga klasifikimi si pyje për shfrytëzim;
- ii. Menaxhimi i pyllit dhe i pasurive pyjore, i ujërave e pasurive ujore, si dhe i pasurive të tjera pronë shtetërore, që ndodhen brenda një zone të mbrojtur, bëhen nga administrata e ruajtjes së zonës. Administrata këto veprimtari i ushtron drejtpërdrejt ose nëpërmjet një subjekti të autorizuar prej saj;
- iii. Kur këto pasuri janë pronë private, ato menaxhohen e përdoren nga pronari ose përdoruesi i ligjshëm vetëm në përputhje me planin e menaxhimit të zonës, të miratuar nga Ministria e Mjedisit;
- iv. Dispozitat për ndërhyrjet kundër dëmtuesve dhe sëmundjeve që sjellin dëme në pyjet ose në ujerat e zonave të mbrojtura zbatohen vetëm me miratimin e administratës së zonës përkatëse dhe në shkallën e përcaktuar prej saj.

Peizazhi më kritik dhe vlerat mjedisore janë pyjet me pisha bregdetare që sigurojnë vendosjen e plazheve me rërë. Më i rëndësishmi është Pylli i Sodes, i cili është konsideruar si një zonë e mbrojtur, menaxhimi i të cilit është përgjegjësi e Bashkisë Vlorë. Një ndalim i përgjithshëm ndërtimi është aplikuar për këtë zonë. Aty janë të lejuara aktivitetet shplohese, rekreative, piknik, shtigje që lidhen me plazhin. Pjesa tjetër e zonave pyjore bregdetare do të ruhet dhe menaxhohet nga mjetet publike ose private në varësi të statusit të pronës. Në rast se një zonë e pyllëzuar bëhet pjesë e zonës së zhvillimit të turizmit e përcaktuar nga zonimi hapësinor, jo më shumë se 3% e sipërfaqes totale të saj do të përdoret për aktivitete apo strehim.

Vija bregdetare është një burim natyror e cila përfaqëson në të njëjtën kohë, asetet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Zona bregdetare e Bashkisë Vlorë është formuar nga një ndërthurje e plazheve me rërë dhe plazheve shkëmbore. Zonimi i bregdetit i nënshtrohet kryesisht konsideratave për zhvillimin e turizmit.



Plazhet (N8) janë konsideruar sipas përkufizimit zona të mbrojtura, ku asnjë ndërtim i përhershëm është i lejuar, përveç strukturave të përkohshme (subjekt i rregulloreve të veçanta të parashikuara nga PPV).

Për pjesën, shkallë publike për në plazh – zona me zhvillim të ndaluar, për bregdetin aplikohet kufizimi i përgjithshëm prej 30 m për zhvillimin e ndërtimeve të mbyllura. Në mënyrë që të sigurohet ruajtja e gjendjes natyrore të bregdetit, është aplikuar si një rregull i përgjithshëm fakti që zhvillimi do të jetë i përqendruar në pole të përzgjedhura dhe nuk do të zërë më shumë se 25% te gjatësisë së përgjithshme të vijës bregdetare.

Një parametër thelbësor për mbajturi kapacitetin territorial është i lidhur me kapacitetin e plazheve të cilat luajnë rol kyç në atraktivitetin e zonës dhe komoditetin e vizitorëve. Zona bregdetare e Vlorës është e strukturuar në dy pjesë, në bregdetin Adriatik dhe Jonian, me indentitet dhe karakteristika të dallueshme.

#### *Bregdeti Adriatik*

Kjo tokë bregdetare, e cila ka karakteristikat tipike të peisazhit Adriatik, është tërësisht i paprekur dhe një burim i madh për zhvillimin e turizmit të zonës dhe përfshin disa territore me vlera të veçanta panoramike si dhe me ekosistem të ndjeshëm. Në total në zonë gjenden 5-6 plazhe me rërë, secila me karakteristika të ndryshme që janë trajtuar me standarte të ndryshme nga plani në përputhje me vizionin për të promovuar zhvillimin e turizmit.

- Vija bregdetare e Adriatikut në Novosel - plazhet me rërë
- Bregdeti Adriatik i Qendrës - plazhet me rërë
- Bregdeti Adriatik i Qendrës – relievi piktoresk i plazhit të Zhukës.
- Bregdeti Adriatik i Qendrës - Plazh i Nartës / Zvërnec.
- Bregdeti Adriatik i Vlorës - Pjesa e parë nga Pylli i Sodës deri në port (Plazhi i vjetër).
- Bregdeti Adriatik i Vlorës - Pjesa e dytë nga porti deri në zonë e Ujit të Ftohtë.

#### *Bregdeti Jonian*

Ky është burimi kryesor turistik i Bashkisë Vlorë, ku shumica e infrastrukturës ekzistuese të turizmit është e përqendruar dhe përkon me një nga segmentet më karakteristike dhe të identifikueshme të Rivierës Shqiptare, siç është identifikuar edhe në vizion. Vija bregdetare e vazhdueshme që shtrihet nga Vlora deri në Karaburun mund të identifikohet në segmentet e mëposhtme kryesore:

- Plazh i Lungomares Vlorë (Ujë i ftohtë)
- Vlorë Riviera – plazhet pas tynelit
- vija bregdetare Rradhimë - plazhe bregdetare
- Vija bregdetare Orikum - plazhet

- Plazhi i Orikum
- Plazhet e virgjëra përgjatë gadishullit të thepisur të Karaburunit
- Ishulli i Sazanit është një atraksion me potencial të lartë turistik për Bashkinë

## **2. B - Bujqësi**

Nën ndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me tokat bujqësore. Brenda kategorisë B-Bujqësi, janë identifikuar 6 nën-kategoritë:

- B1- Tokë bujqësore e mbrojtur fushore - kultivime me ara.
- B2- Tokë bujqësore e mbrojtur kodrinore- kultivime me ullishte, pemëtore, vreshtë.
- B3- Tokë bujqësore dytësore - kultivime të përziera që mund të lejojnë disa zhvillime të agrikulturës (depot dhe magazinat e fermës duhet të kenë intensitet të ulët).
- B4- Zonat e dedikuara për aktivitete mbështetëse për bujqësinë dhe blegtorinë.
- B5- Zonë e propozuar me mundësi për zhvillimin e agroturizmit
- B6- Tokë e pafrytshme për rigjenerim - ndodhet pas lagunës së Nartës, tokë e kripëzuar.

Në mënyrë të detajuar specifikimet e mëposhtme janë përcaktuar për zonat B1, B2, B3 dhe B5:

### *Tokë bujqësore e mbrojtur fushore (B1)*

Zonat e ulta fushore janë toka bujqësore primare, zakonisht për ujitje dhe përbëhen nga prodhime të zonës si (patate, fasule, perime) si dhe vreshta dhe kultivime komplekse. Duke patur parasysh se zona rurale nuk duhet të ndryshojë karakterin e saj në të ardhmen si pasojë e presioneve të parashikuara, mund të themi se kjo tokë bujqësore e ka ruajtur kryesisht strukturën e saj. Përgjithësisht është e ndaluar çdo zhvillim apo aktivitet që nuk lidhet me përdorimin e tokës për zonë bujqësore. Një përqindje e vogël e kësaj toke që ndodhet përgjatë rrjetit rrugor kryesor, zakonisht në afërsi të fshatrave ekzistuese ngjitur me tokën urbane është shndërruar në funksion të zhvillimit të zonave ekonomike. Rast i vecantë për tu konsideruar është edhe toka bujqësore e papërdorur e pozicionuar në brendësi të vijës bregdetare të lagunes nga Novosela në Nartë përtej vijës hekurudhore. Ky territor ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të kripëzimit dhe lënies pas dore të sistemit të ujitjes dhe kullimit. Në këtë zonë akoma ekzistojnë disa aktivitete të nxjerrjes së kripës dhe peshkimit. Pjesa më e madhe e kësaj zone është e caktuar për rehabilitim për tu përdorur për bujqësi dhe pjesa tjetër për krijimin e një natyre të re (siç është përcaktuar edhe në përshkrimin e zonimit në seksionin e ardhshëm).

*Tokë bujqësore e mbrojtur kodrinore (B2)*

Shpatet e kultivuara në zonat kodrinore lidhen kryesisht me kultivimin e pemëve (toka bujqësore dytësore, pemë frutore dhe ullishte). Kjo tokë zë një pjesë të madhe të territorit dhe luan një rol thelbësor për karakterin e peizazhit, si një mjedis rural i qytetit të Vlorës. Ka vlera produktive, vizuale dhe rekreacioni dhe për këtë arsye duhet ruajtur dhe mbrojtur. Disa segmente janë përdorur për shtimin e vendbanimeve ekzistuese të pozicionuara në kodra. Për pjesën tjetër të zonës së mbetur do të aplikohen kufizime të rrepta që lejojnë vetëm një përqindje shumë të vogël për përdorim residential dhe agroturizem në zona të caktuara.

*Tokë bujqësore dytësore (B3)*

Zona me karakter bujqësor dytësor. Kjo zonë është karakterizuar nga tokë agrikulturore e abandonuar dhe me kultivim në nivel të ulët. Gjithashtu kjo lloj toke shtrihet deri në fund të Vjosës në Novoselë dhe gjithashtu është përgjithsisht jo funksionale.

*Zona e propozuar me mundësi për zhvillimin e agroturizmit (B5)*

Zona me pamje të mirë dhe panoramë tërheqëse që mund të kenë vlera për promovimin e agroturizmit (Kodrat e Panajas).

Objektet agro-turistike- agroturizmi përbën një potencial të veçantë, pozitiv, për zhvillimin ekonomik lokal në zonat rurale të Qendrës, në promovimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe kulturore të zonës. Objektet agro-turistike të zhvilluara janë të tipit fermë për rritjen, vjeljen dhe përpunimin e ushqimeve lokale tradicionale. Turistët kanë mundësinë për të shijuar peizazhet bujqësore dhe të provojnë shijet e prodhimeve vendase dhe ushqimin tradicional, njohjen nga afër me jetën e përditshme në fshat, të marrin informacion në lidhje me historinë e zonës, dhe të marrin pjesë në aktivitetet rurale.

Kriteri për pozicionimin e objekteve agro-turistike përfshin:

- Vendodhjen në brendësi të zonave të peizazhit bujqësor;
- Vendodhjen atraktive në lidhje me natyrën dhe mjedisin ndërtimor;
- Vendodhjen në afërsi të zonës me vlera historike, kulturore apo natyrore, sikurse janë vendndodhjet tradicionale, vendet arkeologjike, parqet periferike dhe mjediset ujore;
- Aksesueshmërinë e lehtë me transport publik;
- Distancën e mjaftueshme nga zhurmat dhe aktivitetet ndotëse.

Objektet agroturistike mund të përmbajnë:

- Një shtëpi fshati;

- Akomodime me dendësi të ulët në fshat, akomodimi në vila tradicionale apo njësi apartamentesh;
- Restorante;
- Hapësira ndihmëse në shkallë të vogël për informimin e turistëve të produkteve lokale apo aktiviteteve kulturore;
- Prezantime të mënyrës së përgatitjes së ushqimit;
- Hapësira parkimi.

### **3. IN - Infrastrukturë**

Kjo kategori i referohet të gjitha pjesëve të infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin elektronik, furnizimit me energji elektrike, mbrojtjes së tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjen kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm. Prandaj më poshtë do argumentojmë nën kategorite specifike:

- IN1- Sip. rrugë kombëtare/ Sip. rrugë interurbane/ Sip. rrugë urbane parësore/ parkim publik. Zona e kësaj kategorie do të karakterizohet nga parkimet publike që parashikohen të rriten në pjesën e pedonale të Lungomares si dhe në të gjitha rrugët e rikonstruara nga Bashkia në bazë të një plani të ri parkimi. Infrastruktura rrugore kombëtare do të rritet veçanërisht nga efekti i Baypasit të Vlorës dhe lidhjeve të rrugës Transbalkanike me Unazën e Vlorës dhe Portin. Do të ketë rritje të rrugëve lidhëse ndërmjet fshatrave të Noveselës, Orikumit dhe Qendër. Rritje të rrugëve në zonat informale dhe përmiresim në zonat e reja. Rrjeti kryesor rrugor urban i Vlorës është përfshirë në këto kategori:
- IN2- Terminali i Autobusave është propozuar të vendoset në afërsi të stacionit hekurudhor të Vlorës dhe përballë vijës bregdetare.
- IN3- Karakterizohet nga elementi buferik i hekurudhës. këtu është parashikuar të mbetet sistemi ekzistues i hekurudhës.
- IN4- Porte/Marina. Përbëhet nga porti eksistues i Vlorës, porti energjetik i Petroliferës, Porti peshkimit të Nartës, Porti ushtarak në Karaburun dhe Sazan, Marina në Orikum dhe Marina e propozuar nga PPV në qytetin e Vlorës. Pjesa e krijuar për transport detar dhe porte peshkimi të vogla janë përfshirë në këtë kategori.
- IN5- Zona buferike e aeroportit e cila është menduar dhe parashikuar të ruhet vendi për një aeroport të ri potencial.
- IN6- Nënstacioni elektrik, zona buferike e linjës së tensionit të lartë.
- IN7- Ujësjellës-Kanalizime. Impianti trajtimit të ujërave të ndotura-depot e ujit. Këtu është përfshirë edhe impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në qytetin e Vlorës.

- IN8- Telekom [Antena buferike 30 m]
- IN9- Zona për përdorimin e pikave të karburantit me Gaz.
- IN10- Landfill / vend depositimi për zonën buferike. Në këtë kategori përfshihen edhe landfillet e propozuara të vendosura në Sherishtë.

Transporti publik në qytet do të përmirësohet duke krijuar qendra multimodale për lidhjen urbane me qendrat e njësive administrative. Transporti privat do të ketë tendencë rritje për të kompensuar mungesën e transportit publik në oraret e natës dhe vendet që aktualisht nuk mbulohen nga transporti publik.

#### **4. U - Ujëra**

Trupat ujqor formojnë një aset kryesor e madhor të peizazhit mjedisqor dhe rekreativ të Bashkisë, që kërkon mbrojtje nga aktivitetet e njeriut dhe zhvillim përmes përdorimit të tokës nëpërmjet kufizimeve të zonimit. Në rastin e zonave të vendbanimeve të zhvilluara në afersi me ujinq, ky rregull është korrigjuar sipas zonimit më të detajuar të zonës. Territoret që përfshihen në kategorinë ujëra përfaqësohen nga brigjet lumore dhe përrenjtë, sipas nënkategorisë. Në këto zona është rreptësisht i ndaluar çdo lloj zhvillimi.

- U1- Lumenjtë, liqenet, rezervuar artificialë. i referohet edhe rezervuarëve të Sherishtës, Babicës, Kërkovës, Bestrovës dhe Hoshtimës. Lumi i Vjosës dhe Shushicës janë pjesërisht të përfshirë brenda territorit të bashkisë. Lumi i Dukatit është vendosur pjesërisht brenda territorit të Bashkisë.
- U2- Akuakulturat e pranishme në Orikum.
- U3- Ujërat bregdetare (laguna, kripore, salinas). Trupat ujqore bregdetare formojnë një sasi të konsiderueshme të territorit të Bashkisë duke përfshirë sistemin e Lagunës së Nartës dhe Pasha Limanit.
- U4- Zona të Mbrojtura Ujqore. I referohen pjesës së trupave ujqore tokësor dhe bregdetare të cilat janë përfshirë brenda kufinjve të zonave të mbrojtura kombetare [Zona A.1, Peisazh i mbrojtur (K.V) Vjosa, Narta, Zona A2, Rezervat natyror i menaxhuar (K.IV) Llogara, Karaburun, Pasha Liman; Zona Qendrore, Zona efektive e manaxhuar, Park Kombëtar, Detar, Sazan, Karaburun (K.II)].
- U5- Park Detar Shplodhës. Zone rekreative ujqore e propozuar nga PINS Bregdeti ose planet e tjera kombëtare, p.sh. Zonë Rekreative, Park Kombëtar Detar Sazan Karaburun (K.II)].

Më në detaje:

*Trupat ujqore tokësor (U1)*

Aplikimi i rregullave të mësipërme është zgjeruar edhe duke ju referuar rezervuarëve ujore të mbetura të Bashkisë. Përveç këtyre, rregulli i përgjithshëm për rezervuarët e mbrojtur (100 metra nga vija e sipërme e nivelit të ujit) është aplikuar nga plani për të gjithë rezervuarët ujore. Në mënyrë të ngjashme rregulli i spostimit me 50 m nga bregu i lumit është aplikuar për vendodhjen e rezervuarëve me qëllim mbrojtjen e lumit dhe të rrjedhjes së ujit.

#### *Laguna e Nartës (U4)*

Ekzistojnë tashmë kufizime mjedisore për zonimin të përcaktuara nga VKM e miratuar, e cila parashikon rregulla për deponimin e mbeturinave, pylltarinë dhe bujqësinë dhe që kufizojë zhvillimin e infrastrukturës, aktiviteteteve të caktuara dhe ndërtimin në afërsi të ekosistemit lagunor, në mënyrë të veçantë (neni 10 i L. 8906/2002):

- a) Mbjellja e pyjeve me një lloj të vetëm pemësh;
- b) Neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve dhe pikave të caktuara;
- c) Shpërndarja e kafsheve dhe origjina e bimeve jo brenda vendit;
- d) Gjuetia me ushqime të helmuara;
- e) Ndërtimi i autostradave, kanaleve të lundrimit dhe zonave urbane;
- f) Qarkullimi me automjete jashtë rrugëve. Ky rregull nuk do të aplikohet për automjetet shtetërore dhe makinat bujqësore dhe pyjore, zjarrëfikset, ambulancat, dhe makineritë për menaxhimin e ujit dhe shërbimeve veterinarë;
- g) Organizimi i garave me automjete, motoçikleta dhe biçikleta.
- h) Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve dhe pesticideve, trajtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në ferma për zona më të mëdha se 2 hektarë dhe çdo aktivitetit tjetër që nuk është i ndaluar, siç është shprehur në paragrafin 2 të këtij neni, do të kryhet vetëm me marrjen e lejes mjedisore të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

#### **5. A - Banim**

Zonat rezidenciale përbëjnë dhe pjesën më të madhe të territorit të urbanizuar të Bashkisë Vlorë, duke përfshirë këtu zonat e shtëpive parësore dhe dytësore. Disa nga shërbimet ndihmëse për turizmin mund të përfshihen në këto zona, sigurisht sipas kushteve specifike për secilën prej tyre, sikurse edhe shërbime të tjera, që janë në perputhje me zonat rezidenciale. Zonat rezidenciale përfshijnë një shumëllojshmëri terriresh:

- i. Zonat ekzistuese urbane dhe ato rurale me kufijtë e përcaktuar nga orto fotot e vitit 2013 dhe 2015.

- ii. Zonat e zgjeruara të propozuara për qendra urbane nga Konsulenti, për të mundësuar mbulimin e nevojave në të ardhmen, duke u bazuar në projeksionet programatike.
- iii. Zonat e reja të zhvillimit për shtëpitë e dyta.
- iv. Fshatrat e trashëgimisë kulturore. Kategoritë e propozuara për zonat e zhvillimit rezidencial dhe shërbimet që i shoqërojnë ato janë përshkruar më poshtë:

Brenda kategorisë A-Banimit janë identifikuar 6 nën-kategoritë:

- A1- Qendra historike, vendbanime tradicionale të cilat i referohen qendrave historike të Vlorës (zona e mbrojtur nga Ministria e Kulturës) dhe gjithashtu të gjitha zonat përreth apo qendrat e vjetra të fshatrave që nga periudha e pushtimit Italian. Qendra e Nartës dhe Kaninës përfshihen gjithashtu në këtë kategori.
- A2- Zona banimi në qendrën e qytetit e cila përmban kryesisht qendrën e qytetit të Vlorës që zgjerohet ndërmjet dy bulevardeve (kryesor dhe Transballkanik) nga qendra historike drejt Lungomares. Kjo është një zonë me densitet të lartë dhe miks duke përfaqësuar në mënyrë tipike qendrën e qytetit me një game të gjërë shërbimesh.
- A3- Zona banimi të përdorimit miks i referohet zonave urbane të qytetit të Vlorës me përdorim miks (përdorim i kombinimit rezidencial me shërbime tregtare), qendrave lokale të fshatrave dhe zonave ekonomike gjate rrjetit të rrugëve interurbane.
- A4- Zona banimi i referohet zonave të zëna për banim me përqindje të ulët për shërbim lokal. Zona informale e qytetit të Vlorës po ashtu edhe zonat e vendbanimeve rurale i përkasin kësaj kategorie.
- A5- Zona me shtëpi të dyta. Kjo nënkategori i referohet zonave rezidenciale me destinacion kryesor të shtëpive të dyta kryesisht në zonën bregdetare të bashkisë së Vlorës. Ato janë përqëndruar në afërsi të Vlorës, Zvërnec, Rradhimë bregdet, Orikum bregdet.
- A6- Zona për strehim social. Shtëpitë sociale ekzistojnë dhe janë propozuar në njësitë administrative dhe në qytetin e Vlorës.

## **6. S - Shërbimet**

Janë të ndara në dy tipe kryesore: tregtare dhe turistike. Janë përcaktuar dy nënkategori për shërbimet tregtare:

- S1- Dyqane, shërbime personale, zyra biznesi.
- S4 - Bar, kafe, restorante, shërbime plazhi. Janë përqëndruar kryesisht në bregdetin Jonian të Vlorës.

Përdorimi i tokës dhe i strukturave në të për shërbime (S1) (S4), përfshin ato zhvillime të lejuara që bëhen për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave përkatëse, dhe ku sipas rastit jo më shumë se 10% e zonës dhe strukturave të saj shfrytëzohet për qëllime banimi, sipas sipërfaqes së ndërtimit.

Zonat e Zhvillimit Turistik, janë zonat e destinuara për zhvillimin e formave të ndryshme, të përgjithshme të një turizmi të interesit të veçantë, të cilat formojnë profilin e zonës, ashtu sikur janë identifikuar në fazën e mëparshme të studimit si pjesë e Vizionit dhe Strategjisë Territoriale.

Si rregull i përgjithshëm zonat e përcaktuara posaçërisht turistike, përjashtojnë aktivitete të tjera, të cilat nuk janë në përputhje me karakterin e zonës dhe zhvillimet rezidenciale, që nuk janë të lidhura me skemën e përgjithshme të zhvillimit. Kategoritë e propozuara të zonave të zhvillimit turistik, janë të përshkruara si më poshte:

- S2- Turizëm brenda zonave të vendbanimeve (hotele)
- S3- Turizëm jashtë zonave të vendbanimeve (resorte, vila)
- S5- Format speciale të turizmit (ekoturizëm dhe agroturizëm)
- S6- Infrastruktura speciale për turizëm, objekte (spa-golf etc).
- S7- Kamping

## **7. M - Trashëgimi dhe monumente kulture dhe historike**

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat historike. Përdorimet e kësaj kategorie përfshijnë ato zona të cilat kanë status të veçantë ligjor dhe që përfaqësojnë vlera historike dhe kulturore për Bashkinë Vlorë dhe më gjerë. Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

- M1- Zona Arkeologjike A (Qendra Historike e Vlorës)
- M2- Zone Arkeologjike B (buferike) (Qendra Historike Vlorës)
- M3- Kala / Monument Kulturor (Kanina, Triporti, Manastiri Zverneçit, etj)

## **8. IE - Ekonomi dhe industri**

Zonat ekonomike dhe industriale formojnë tipin e tretë të kategorisë së përgjithshme të përdorimit të tokës i cili përfshin të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike që nuk duhet të përzihen me zonat rezidenciale dhe atyre turistike. Në këtë kategori do të përfshijme po ashtu zonat me infrastrukturë të mirë dhe që të krijojë lehtësira të konsiderueshme dhe të mos kenë impakt në mjedis. Këto janë të ndara si më poshtë:



- IE1- Parku industrial, qendër logjistike 130 ha. Zona industriale me impakt të lartë mjedisor. Ato kane një aktivitet ekzistues jashtë zonave të banimit. Kjo është një zonë e vendosur në perendim të Vlorës ku ekzistojnë dy pole me industri mikse dhe mundësi infrastrukturore në një shkallë të gjerë dhe me karakter organizativ. Zona kryesore është në krah të ish-fabrikës së Sodës dhe ish-fabrikës së Llambave dhe Portit të ri të Petroliferës (mundësi Porti, Frabrika e Çimentos).
- IE 2 –Zonë ekonomike/ tregëtare/ Zonë industriale e organizuar me ndikim të ulët dhe të mesëm. Kjo zonë e madhe mund të përfshijë aktivitete që janë vendosur brenda zonave urbane të qytetit të Vlorës ose janë shpërndarë në pole të vogla në zonën rurale të territorit të Bashkisë e lidhur ngushtë edhe me ekonominë e fshatrave. Gjithashtu mund të përshtaten edhe një sërë aktivitete të tjera duke përfshirë një gamë të caktuar të objekteve industriale, mobileri ose dyqane elektroshtëpiake dhe supermerkatë. Përdorimet e veçanta për infrastrukturën e Bashkisë të tilla si fabrika e përpunimit të mbetjeve, parkimi i automjeteve të Bashkisë, therëtores si edhe vendosja e fabrikave energjitike.
- IE 3–Zona magazinimi dhe tregëtimi/ Industri agropërpunimi. Zona është me impakt të lartë të ngjashëm me zonën IE2.
- IE 4–Qendra rajonale agroekonomike (nuk është propozuar për Bashkinë Vlorë).
- IE 5–Nxjerrje dhe përpunim mineralesh (gurorret / fabrikat e cimentos)

## **9. IS- Institucione**

- IS.1- Institucionet publike vendore, institucionet publike qendrore (administrata, gjykatat, burgjet, mbrojtje civile, institucionet e mbrojtjes kombëtare, kompanitë e nevojshme, mirëqënia sociale)– janë përqëndruar kryesisht në qytetin e Vlorës.
- IS.2- Institucionet fetare

## **10. AR- Aktivitete Sociale dhe Rekreative**

Përdorimet për aktivitete AR-Sociale dhe Rekreative, përfshirë fusha të ndryshme si sociale, kulturore dhe rekreative sipas legjislacionit të posaçëm.

- AR.1- Aktivitete kulturore, përfshin të gjitha tipet e aktiviteteve kulturore sikurse është Muzeu Arkeologjik i Vlorës, Teatri Petro Nini dhe Pallati Kultures.

- AR.2- Zona Sportive, përfshin të gjitha tipet e objekteve sportive duke përfshirë kompleksin aktual atletik të qytetit të Vlorës dhe fushat sportive në vendbanimet rurale.
- AR.3-Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara. Në këtë kategori janë përfshirë të gjitha hapësirat publike të vogla dhe të mëdha brenda qytetit të Vlorës dhe zonave të vendabnimeve.
- AR.4- Parku/ Zona shplodhëse periurbane – në këtë kategori janë përfshirë hapësira të gjelbërta si Parku i fëmijëve në Vlorë / Parku i Sodës, ku është parashikuar zhvillimi i pyllit bregdetar të Sodës në një pyll estetik / Zona të gjelbërta, Kuz Baba

## 11. AS- Arsimi

Ky përdorim përfshin të gjitha trojet e rezervuara për institucionet arsimore apo institucionet ndihmëse në funksion të arsimit, ekzistuese dhe të propozuara. Propozimet, siç shpjegohen në kapitullin përkatës të këtij dokumenti, janë bërë duke u bazuar mbi analizën e gjendjes ekzistuese dhe evidentimin e nevojave për planifikimin e infrastruktures arsimore, bazuar në parashikimet ligjore të VKM-së nr.671 (Neni 83) dhe legjislacionin sektorial përkatës. Në shumë raste duhet patur parasysh që sipërfaqja e trojeve të rezervuara për institucionet arsimore është disa herë më e vogël sesa sipërfaqja minimale e njërive strukturore të cilat akomodojnë edhe përdorime të tjera toke si Banim (A), Shërbime (S), etj. Nënkatëgoritë e evidentuara për këto përdorime toke janë:

- AS.1- Arsim parashkollor
- AS.2- Arsim 9-vjeçar
- AS.3- Arsim i mesëm
- AS.4- Arsim profesional
- AS.5- Zonë universitare që i referohen zonave ekzistuese universitare në territorin e Vlorës.

## 12. SH- Shëndetësi

Ky përdorim përfshin të gjitha sipërfaqet territoriale të rezervuara për institucionet shëndetësore apo strukturat ndihmëse në funksion të tyre, të klasifikuara sipas dy nënkategorive kryesore:

- SH.1– Zonë Spitalore që i referohet spitaleve ekzistuese të qytetit të Vlorës.
- Sh.2– Qëndër shëndetësore/ Ambulancë

### 13. V –I Veçantë

- **V1- Varreza**

Strukturat dhe territoret që përfshihen në kategoritë e veçanta, janë zona e varrezave publike, e varrezave të dëshmorëve dhe varrezat e fshatrave, me kodin (V.1). Këto zona shoqërohen gjithmonë me zonën e mbrojtur buferike. Varrezat e qytetit janë parashikuar të zgjerohen në pjesën jugore të qytetit, aty ku ndodhen edhe varrezat ekzistuese.

### 14. ZU- Zona Ushtarake

I referohen hapësirave dhe objekteve të klasifikuara si të tilla në territor apo në legjislacionin e posaçëm.

**Tabela 2 Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë**

Kategoritë bazë te përdorimit te tokës	Sipërfaqe (ha)	Novosela	Shushice	Qender	Vlore	Orikum	Total
<b>A</b>	Ekzistuese	276.62	166.21	340.37	1114.40	223.13	<b>2120.73</b>
	E propozuar	301.47	187.67	442.80	954.63	284.16	<b>2170.73</b>
<b>IE</b>	Ekzistuese	35.38	0.00	21.84	189.71	31.10	<b>278.02</b>
	E propozuar	42.62	5.22	42.17	264.76	41.13	<b>395.90</b>
<b>B</b>	Ekzistuese	7310.14	2739.03	5200.55	928.35	3328.91	<b>19506.98</b>
	E propozuar	7266.44	2718.10	4736.96	772.61	3252.34	<b>18746.45</b>
<b>S</b>	Ekzistuese	0.00	0.00	0.00	0.03	2.28	<b>2.32</b>
	E propozuar	0.00	1.94	32.55	17.44	70.23	<b>122.17</b>
<b>V</b>	Ekzistuese	4.84	4.38	26.05	0.00	5.20	<b>40.47</b>
	E propozuar	4.84	4.41	26.05	0.00	5.18	<b>40.47</b>
<b>U</b>	Ekzistuese	5451.59	247.65	466.86	0.00	415.23	<b>6581.32</b>
	E propozuar	5425.23	247.65	560.82	3.06	417.24	<b>6654.01</b>
<b>N</b>	Ekzistuese	3120.50	858.63	1581.50	281.24	29438.58	<b>35280.45</b>
	E propozuar	3156.80	849.02	1734.32	281.06	29418.93	<b>35440.13</b>
<b>M</b>	Ekzistuese	0.00	0.00	153.90	4.15	44.10	<b>202.15</b>
	E propozuar	0.00	0.00	153.39	4.15	44.10	<b>201.64</b>
<b>ZU</b>	Ekzistuese	0.00	0.00	13.30	7.97	24.94	<b>46.21</b>
	E propozuar	0.00	0.00	13.39	0.98	21.10	<b>35.47</b>
<b>IS</b>	Ekzistuese	7.63	0.23	1.63	5.29	0.53	<b>15.30</b>
	E propozuar	7.63	0.36	1.42	8.63	0.36	<b>18.40</b>

Shërbim Konsulence, për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore, për Katër Bashki, Vlorë, Sarandë,  
Himarë, Konispol

<b>AR</b>	Ekzistuese	7.74	0.00	1.57	71.12	71.12	<b>151.56</b>
	E propozuar	8.73	0.25	58.77	137.60	20.93	<b>226.27</b>
<b>AS</b>	Ekzistuese	3.73	0.26	1.49	10.18	3.18	<b>18.85</b>
	E propozuar	4.48	1.28	2.54	22.04	3.30	<b>33.63</b>
<b>SH</b>	Ekzistuese	0.20	0.13	5.34	3.86	0.14	<b>9.66</b>
	E propozuar	0.20	0.36	0.31	10.97	0.14	<b>11.97</b>
<b>IN</b>	Ekzistuese	372.61	0.00	92.63	126.13	76.87	<b>668.24</b>
	E propozuar	372.17	0.07	101.65	264.91	86.18	<b>824.99</b>



### 1.3 Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi

Organizimi hapësinor i njësive dhe nënnjësive strukturore është një proces paralel me procesin e zonimit në përdorimin e tokës, i cili shërben si mjet themelor metodologjik për llogaritjen e standardeve të planifikimit në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe shpërndarjen e shërbimeve. Përcaktimi i njësive dhe nënnjësive është i lidhur direkt me popullsinë ekzistuese dhe atë të planifikuar, dendësinë e popullsisë, numrin e parashikuar të turistëve dhe të vizitorëve, si edhe shpërndarjen e shërbimeve sociale (arsimi, kujdesi shëndetësor, kultura, sporti dhe gjelbërimi).

Përcaktimi i njësive dhe nënnjësive strukturore zbatohet vetëm për pjesën e urbanizuar të territorit të parashikuar, duke marrë në konsideratë modelin ekzistues të vendbanimeve. Zonat janë njësi relativisht homogjene, ku përqendrohen një sërë karakteristikash të përbashkëta, si përdorimi i tokës, tipologjitë hapësinore, destinacioni i zhvillimit dhe profili social-ekonomik. Ata paraqesin midis njëra-tjetrës varësi funksionale të cilat janë të shprehura në formën e njësive të rendit të lartë hapësinor, të cilat janë formuar nga grupimet e vendbanimeve bredgetare dhe rurale, me funksionimin dhe lidhjet historike me njëri-tjetrin, në lidhje me plazhet, aktivitetet e tyre prodhuese, tokën dhe kultivimin e tyre.

Njësia strukturore përbën qelizën më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në njësinë strukturore përkatëse.

Numri i Njësive Strukturore është 1598 (dyqind e pesëdhjetë e pesë), të cilat janë përcaktuar duke ju referuar këtyre kritereve:

- a. kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elemente me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastit përfshijnë linja hekurudhore, vija ujore, lumenj, kanale të hapura, breza sanitare, dhe të tjera të kësaj natyre;
- b. ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit të cilët garantojnë në çdo njësi përbërëse të njësisë strukturore;
- c. ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njëri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane;
- d. bashkëekzistenca e përdorimeve të tokës dhe të strukturave në një njësi strukturore që janë të përputhshme dhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të, në të gjithë njësinë;

- e. garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë së tipologjise hapësinore ekzistuese ose të propozuar;
- f. ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
- g. ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të;
- h. kufizimin nga rrjeti rrugor, pavaresisht nga kategoritë e rrugëve, nga linja hekurudhore, kanale të hapura, breza sanitare, vija ujore, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre.


Nëndarja e territorit të Bashkise Vlorë në njësi dhe nën-njësi në raport me popullsinë ekzistuese dhe të planifikuar, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 3 Ndarja e Territorit në Njësi Zhvillimi**

Njësia Administrative	Vendbanim	Sipërfaqe (ha)	Zona	Njësi Strukture
Novosele	DELLINJE	14.68046475	NO.UB.1	6
	DELISUF	23.69120456	NO.UB.2	5
	PORO	39.08833585	NO.UB.3	6
	BISHAN	36.71717523	NO.UB.4	5
	FITORE	21.81835996	NO.UB.5	4
	NOVOSELA	50.06615489	NO.UB.6	9
	ALIBAN	19.45197962	NO.UB.7	4
	AKERNI	14.51834972	NO.UB.8	3
	SKROFOTINE	19.91490967	NO.UB.10	7
	CERKOVINE	43.44357228	NO.UB.11	12
	TREVLLAZER	41.80760855	NO.UB.12	5
		<b>Sub-Total</b>	<b>325.1981151</b>	
Shushice	BESHISHT	10.45960395	SH.UB.1	3
	MEKAT	25.25007305	SH.UB.2	6
	DRITHAS	21.41426823	SH.UB.3	9
	LLAKATUND	73.49590867	SH.UB.4	11
	BUNAVIA	25.18485658	SH.UB.5	5
	RISILI	44.36640779	SH.UB.6	4
		<b>Sub-Total</b>	<b>200.1711183</b>	
Qender	HOSHTIMA	27.72181748	QE.UB.1	6
	PANAJA	40.51476738	QE.UB.2	10
	KERKOVE	24.29885687	QE.UB.3	7
	BESTROVE	20.07253826	QE.UB.4	9

	BESTROVE E VOGEL	17.65369528	QE.UB.5	4
	BABICE E VOGEL	22.666219	QE.UB.6	4
	BABICE	80.78333323	QE.UB.7	16
	XHYHERINA	44.12445842	QE.UB.8	8
	SHERISHTA	90.62468184	QE.UB.9	13
	KANINA	69.97259579	QE.UB.10	17
	ZVERNEC	28.64865378	QE.UB.11	7
	ZVERNEC	27.14305981	QE.UB.12	7
	NARTE	113.5927213	QE.UB.13	26
	NARTE	27.87267785	QE.UB.14	6
	<b>Sub-Total</b>	<b>635.6900763</b>		<b>140</b>
<b>Vlore</b>	SHKALLA VLORE	85.31426723	VL.UB.1	25
	SHKALLA VLORE	35.19320922	VL.UB.2	20
	VLORE PLAZH	57.62915474	VL.UB.3	20
	VLORE Waterfront	56.96474287	VL.UB.4	30
	VLORE Waterfront	17.83681763	VL.UB.5	11
	VLORE Center	63.75121319	VL.UB.6	34
	VLORE Center	73.13425683	VL.UB.7	66
	VLORE East	87.62005443	VL.UB.8	28
	VLORE Center	25.19240698	VL.UB.9	35
	VLORE East	133.6642803	VL.UB.10	25
	VLORE North	59.26066757	VL.UB.11	23
	VLORE North	47.47855888	VL.UB.12	14
	VLORE Center	20.91814363	VL.UB.13	22
	VLORE West	264.4271405	VL.UB.14	68
	VLORE West	182.6213808	VL.UB.15	59
	VLORE West	257.4768074	VL.UB.16	12
	<b>Sub-Total</b>	<b>1468.483102</b>		<b>492</b>
<b>Orikum</b>	DUKAT FSHAT	24.48928816	OR.UB.1	9
	DUKAT	46.14304028	OR.UB.2	6
	TRAGJAS	124.5189719	OR.UB.3	19
	ORIKUM	141.7445502	OR.UB.4	38
	ORIKUM	36.38457212	OR.UB.5	8
	RRADHIME	34.64577907	OR.UB.6	12
	RRADHIME	19.41005183	OR.UB.7	5
	RRADHIME	79.50734728	OR.UB.8	22
	KANINA	19.73579353	OR.UB.9	3
	<b>Sub-Total</b>	<b>526.5793944</b>		<b>122</b>
	<b>TOTAL</b>	<b>3156.121806</b>		<b>858</b>





Harta 4-Njësitë Strukture

## 1.4 Pozicionimi i rrjeteve të infrastrukturës si edhe kushtet teknike për realizimin e tyre

### 1.4.1 Transporti ekzistues

*Transporti Ajror-* Shërbimi i transportit ajror në Jug të vendit, kryesisht për turistët ndërkombëtar, sigurohet në mënyrë indirekte së pari nëpërmjet aeroportit të Tiranës dhe së dyti nëpërmjet aeroportit të Korfuzit. Me negocimin e marrveshjes në fund të 2015 - fillim të 2016, qeveria shqiptare aktualisht është në gjendje të zhvillojë aeroportet e tjera të tipit "lavv cost", si në Vlorë dhe Sarandë, për të cilat janë konsideruar alternativat e operimit në vendet ekzistuese. Duke pasur parasysh faktin që një pjesë e konsiderueshme e fluksit turistik ndërkombëtar, mund të vijë nga distanca mjaft të largëta nga Shqipëria, ku fluturimet ajrore janë alternativa kryesore e udhëtimit, nevoja për një aeroport në afërsi të bregdetit, në jugperëndim të Shqipërisë, për të shërbyer kryesisht në mënyrë sezonale (me fluturime charter), është evidente

Vlora është aktualisht qyteti i tretë më i madh dhe i dytë më i pasur në aspektin e të ardhurave mesatare të popullsisë në Shqipëri. Në qytet vazhdojnë të bëhen shumë ndërtime dhe po ashtu shumë projekte tashmë janë miratuar duke pasur si objektiv transformimin e Vlorës në një destinacion tërheqës turistik dhe bregdetin e saj në qendër referimi të të gjithë vendit

*Transporti hekurudhor-* Vendi aktualisht është i aksesueshëm me tren vetëm në Novoselë dhe Vlorë dhe këto kanë stacionet të cilët operojnë në bazë të rrjetit hekurudhor shqiptar që i lidh ato me Durrësin (dhe Tiranën) dhe nëpërmjet transferimit me Librazhdin (dhe Pogradecin). Shpejtësia e vogël e lëvizjes së trenave, shërbimi i rralluar dhe jo optimal, i shoqëruar me problemet të cilat kanë shkaktuar ndërprerje në funksionimin e segmenteve të caktuara shpjegojnë rënien në numrin e udhëtarëve që përdorin këtë formë transporti.

*Transporti Detar-* Vlora ka 2 porte të hapur ndërkombëtar Petrolifera Italo-Shqiptare në Pyllin e Sodës për ngarkim shkarkimin e karburanteve dhe Porti Vlora sh.a. që është brenda qytetit. Ka po ashtu një port peshkimi të vendosur në veri të Pyllit të Sodës apo zona e njohur si Triporti. Në Orikum ka dhe një port turistik (Marine) për akomodimin dhe shërbimin e mjeteve turistike detare. Gjatë vitit 2015 numri total i pasagjereve ka qenë rreth 105.000 duke shënuar dhe numrin më të madh të viteve të fundit dhe me një rritje prej 30% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Porti i jahteve është i vetmi i këtij lloji në gjithë bregdetin Shqiptar.

## 1.4.2 Infrastruktura publike ekzistuese

### 1.4.2.1 Infrastruktura rrugore

**Rrjeti i rrugëve kryesore-** Vlorë është në një distance prej 140 km nga Tirana dhe është e lidhur me rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet rrugës kombëtare Levan-Vlorë Sh8 dhe në Jug, me rrugën e Bregut nëpërmjet Qafës së Llogarasë (Sh8). Rruga transballkanike me gjatësi 2.5 km, me status rrugë primare interurbane, e lidhur së fundmi me rrugën kombëtare Levan Vlorë jep mundësi për zhvillimin e potencialeve të portit dhe ka ulur efektin e mjeteve të rënda në trafikun e rrugëve të brendshme të qytetit. Po zhvillohet by-passi i Vlorës që lidh autostradën Levan - Vlorë Sh8 me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjatësia e këtij aksi është 29 km dhe fillon në rrethrotullimin në fund të rrugës Levan-Vlorë dhe shmang qytetin duke kaluar në Veri të tij duke përfunduar në Orikum.

**Rrjeti i rrugëve dytësore-**Vlorë ka rreth 193 rrugë dytësore në gjendje relativisht të mirë. Një pjesë e rrugëve dytësore sidomos ato që lidhen me bregun janë të rikonstruara dhe në gjendje të mirë ndërsa pjesa tjetër që lidhet me pjesën malore janë nën ndërtim me fond të FSHZH.

**Rrjeti rrugor-** është një pjesë integrale e rendesishme, pasi lidh zona të ndryshme duke filluar që nga bashkitë mes tyre, deri të qytet e fshatrat, duke lehtësuar lëvizjen mes njerezve, automjeteve dhe mallrave.

Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë, karakterin, llojin e shërbimeve që ajo ofron sipas zones ku ajo kalon, funksionin dhe qëllimin.

**Hierarkia rrugore:** Hierarkia rrugore e detajuar më poshtë është e bazuar në dispozitat e kuadrit ligjor shqipëtar, dhe i referohet projekteve ndërkombëtare dhe standarteve funksionale, me një qëllim të veçantë për t'u përshtatur me karakteristikat e veçanta të Bashkisë Vlorë. Kjo hierarki është projektuar për t'i shërbyer vëllimeve të ndryshme të trafikut, në përputhje me përdorimin. Një vëmendje e veçantë gjatë planifikimit të rrugëve i është kushtuar dhe shmangies së turbullimeve të ekosistemeve të lagunave dhe zonave të sensibilizuara të lartë mjedisor, si dhe kontrolli i flukseve të vizitoreve sipas parimeve ekologjike të planifikimit.

**Rrjeti interurban-** Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në të gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësitë e udhëtimeve, duke filluar nga autostradat në zinxhirët e rrugëve të vogla rajonale të qendrave të vogla urbane dhe fshatrat, duke ndikuar relativisht në kufijtë e moderuar të shpejtësisë. Në kuadër të Planit, rrugët interurbane mendohen të jenë:

Rruga kryesore interurbane është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime, autostrada me shpejtësi të lartë. Në këtë kategori përfshihet rruga e re nacionale Fier-Vlorë e cila përshton sektorin verior të territorit të njësisë në anën e lagunës që të çon për në qytetin e Vlorës. Kjo është një rrugë e gjerë e projektuar si autostradë e mbyllur me dy korsi në çdo drejtim. Vazhdimi i saj është në formën e një rruge unaze që kalon përgjate kodrave mbrapa qytetit të Vlorës me karakteristikat e një rruge të ngushtë (një korsi për çdo anë me një gjërësi për shpejtësi mesatare 70-80km/orë.

Rruga dytësore interurbane, rrugë me një ose dy kalime që përbejnë lidhjet primare të rrugës kombëtare me vendbanimet dhe plazhet. Në këtë kategori ka tre lidhje radiale që bashkojnë sektorë të ndryshëm të territorit të Bashkisë me sistemin nacional rrugor. Rruga e vjetër nacionale nga Fieri

krijon lidhjen e fshatrave veriore (Panaja, Bestrove etj) me rrugën e re kombetare (në dalje të Panajasë) dhe Novosela. Arteria e dytë është lidhja me rrugën e unazës në pozicionin nga Babica në Sherishte dhe nga aty në kufi me Bashkinë duke lidhur fshatrat me pjesen lindore të saj dhe me unazën e karakterizuar edhe nga përqëndrimi i aktiviteteve ekonomike. Rrugët janë me dy korsi me një gjerësi prej 7-9 m. Aksi i tretë është lidhja e re direkte nga rruga kombetare për tek plazhi i Zverneçit, në të cilën është propozuar edhe një dalje e re nga fshati i Nartes. Ky është projektuar me dy segmente të veçanta. Në zonën fushore kjo rrugë ka gjerësi 9 m, ndërsa në hyrje të Pyllit të Sodës, reduktohet në gjerësinë 7m.

Rruga terciare inter urbane janë rrugë të vetme, rrugë me një ose dy kalime me standarte më të ulëta të projektimit dhe të shpejtësive të trafikut, e cila lidh vendbanimet individuale me njera-tjetren dhe plazhet. Një rrjet i rrugëve terciare interurbane me karakteristika uniforme (gjerësi prej 5.75 m) është projektuar në formën e një rrugë piktoreske për vizitorët që të lidhë të gjitha fshatrat duke shmangur qytetin e Vlorës dhe rrugën nacionale.

Rrugët lokale janë të gjitha rrugët e tjera jashtë kufijve të vendbanimeve (të shtruara ose të pashtuara) të cilat nuk janë prioritet i Planit dhe nuk përbejnë një rrjet të caktuar.

### **Rrjeti Urban**

Rrugët urbane përbëjnë pjesë të rrjetit rrugor, që shtrihet brenda vendbanimeve të zonës. Ato ndryshojnë në madhësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga rrugët kryesore në rrugët vetëm për këmbësorë. Të gjitha rrugët urbane duhet të lehtësojnë qarkullimin e këmbësorëve, prandaj trotualet janë të nevojshme. Për më tepër, shumica e tyre kanë nevojë për të mbuluar nevojat e rastit për parkime në rrugë. Madhësitë e trotuareve dhe numri i vendeve të parkimit, duhet të përcaktohen mbi bazën rast pas rasti, sipas nevojave edhe tipareve hapësinore të çdo vendbanimi. Më konkretisht rrugët urbane përfshijnë:

Rrugët kryesore urbane janë rrugë me dy kalime, të projektuara për levizje të njëkohshme përmes trafikut nëpër qytet, dhe për të lidhur nyjet e mëdha ose rajonet. Rrugët kryesore urbane gjenden në qendrat e aktiviteteve kryesore të qytetit, duke përfshirë edhe qendrën e tij dhe qendrat e lagjeve. Duke marrë parasysh se Bashkia Vlorë ka një kombinim të karakterit urban dhe rural ka sens të krijimit të rrugëve kryesore urbane dhe rurale. Për këtë arsye në këtë kategori janë vendosur lidhjet midis vendbanimeve të fshatrave me qytetin e Vlorës, si p.sh. lidhja e Nartës, Babicës dhe Kanines. Këto rrugë që shtrihen brenda kufijve të rrugës së unazës ndahen midis zonës rurale dhe qytetit të Vlorës dhe kanë një karakter të përzier sepse disa pjesë janë urbane (me gjerësi 9 m) dhe të tjera në formë rrugë interurbane (me gjerësi 11 m)



Rrugët dytësore urbane janë orientuesit me dy kalime ose me një kalim të trafikut automobilistik në rrugët kryesore urbane, duke organizuar strukturën e qarkullimit të lagjeve të veçanta. Ato funksionojnë si plotësuese të rrugëve kryesore urbane dhe kanë standarte projektimi, në përgjithësi, më të ulëta se të parat. Në këtë kategori përfshihen rrugët kryesore në hyrje dhe në kurriz të vendbanimeve me një gjerësi prej 8.50-10 m.




Rrugët terciare urbane janë rrugët e mbetura me dy kalime ose me një kalim, që lidhen me rrugët dytësore dhe mundësojnë qasje të automjeteve në parcela të veçanta. Meqënëse këto rrugë janë të lidhura ngushtësisht me zonat e banuara, vëmendje e veçantë duhet të adresohet për të siguruar hapësira për lëvizjet e këmbësorëve dhe parkimin në anë të rrugës.





Rrugët vetëm për këmbësorë janë të mbyllura për trafik automjetesh ose në çdo kohë ose gjatë orarit të caktuar dhe nxisin qarkullimin e këmbësorëve dhe përdorimin e biçikletave. Ato duhet të krijojnë një rrjet rrugësh për këmbësorët dhe hapësira publike të hapura, duke përcaktuar


qarkullimin e këmbësorëve brenda dhe jashtë zonave të vendbanimit. Rrugët për këmbësorë ndahen në dy kategori: a) njeri tip i referohet rrugëve historike me gur dhe me kalldrem të cilat i përkasin pjesës tradicionale të vendbanimeve, (si në rastin e fshatit të Nartes) dhe b) tipi tjetër janë rrugët piktoreske të krijuara përgjate elementeve ujore (bregdeti, liqenet dhe lagunat) dhe lidhen me pamje vleresuese të peisazhit dhe me një vecanti të natyrës.

Dimensionet e sistemit të rrjetit rrugor janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:









**Tabela 4 Kategorite e Sistemit Rrugor**

Emertimet		Rrjeti Inter Urban					Rrjeti Urban				
		Rruge kryesore Interurbane Autostrada/A2	Rruge sekondare Interurbane A/B		Rruge terciare Interurbane		Rruge kryesore Urbane A/B	Rruge sekondare Urbane A/B		Lokale Urbane A/B	
1	Numri i Korsive	2+2	1+	1+1	1+	1	1+1	1+	1	1	1
2	Gjerësia e korsive (per drejtimin e trafikut)	3.75 x (2)	3.75	4.00	3.00	4.75	3.00	3.00	5.50	5.50	4.75
3	Gjerësia e krahu te rruges	2.00 x (2)	1.75	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Numri i trotuareve	0	0	0	0	0	2	2	2	2	2
5	Gjerësia e trotuareve	0	0	0	0	0	1.50	1.50	1.50	1.50	1.00
6	Numri i shenjave të pjesës anësore të rrugës	4	2	2	2	2	0	0	0	0	0
7	Gjerësia i shenjave të pjesës anësore të rrugës	0.50	0.50	0.50	0.50	0.50	0	0	0	0	0
8	Gjerësia mesatare e brezit ndarës qendror	3.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Numri i aneve me parkim	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
10	Gjerësia e korsise se	0	0	0	0	0	2	0	1.5	0	0



	parkimi								0		
11	Nr.i rrugeve per bicikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Gjeresia e rruges per bicikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Gjeresia totale e rruges	23.00	11.00	8.00	6.00	4.75	11.00	9.00	10.00	8.50	6.75
14	E drejte kalimi	24.00	12.00	9.00	7.00	5.75	12.00	10.00	11.00	9.50	7.75
* rruget me nje drejtim – minimumi i gjeresise se korsise se rruges me nje drejtim duhet te jete 3.00 metra											
** Kufizimet e parkimit te specifikohen rast pas rasti											

**Njësia administrative Qendër Vlorë** aktualisht ka një prezencë të pasur të rrjetit të infrastrukturës rrugore, (72,4 km gjatesi), por që fatkeqsisht, në pjesën më të madhe të saj është shumë e amortizuar, e demtuar dhe me parametra të ulët në dimensione, kanalizime, trotuare, ndricimin publik, kushte të tjera të shërbimit emergjent, etj. Këto kushte jo të mira fizike të infrastrukturës rrugore janë më tepër evidente në fshatrat e pjesës veri-lindore, lindore dhe jug-lindore të njësisë. Aty ku ndodhen edhe fshatrat më të thella në territorin e kësaj njësie administrative si në fshatrat: Kërkovë, Bestrovë, Hoshtimë, Sherishtë, etj.

Këto kushte vijnë, në një pjesë të tyre, si pasojë e mungesës së investimeve afatgjatë (jo domosdoshmeria për një akses të lartë në to, dhe në disa raste të tjera nga përdorimi i shpeshtë i tyre për aktivitete ekonomike të rënda si gurore, përpunimi i inerteve, dhe akses i makinave me tonazh të lartë), dhe si pasojë mos mirembajtjes apo rehabilitimit të tyre. Ndërsa në pjesën perëndimore të ish komunës, për shkak të faktorit turizëm dhe afërsisë me bregdetin dhe zonat me atraksion kulturor, edhe infrastruktura rrugore është më tepër e mirëmbajtur.

**Panaja:** Rruga kryesore e fshatit Panaja me një gjërësi 3,5-4 m, është e asfaltuar në disa segmente të saj, ndërsa në pjesët e tjera kjo rrugë është e shtruar vetëm me gurë të vegjel (zhavor).

**Hoshtime:** Rruga kryesore e fshatit Hoshtimë është e aksesueshme vetëm nga rruga kombëtare Tiranë -Vlorë. Ajo është një rrugë e ndërtuar përpara viteve 90', e shtruar me asfalt dhe e pajisur me kanalet anësore të shkarkimit të ujërave nga rreshjet etj, por që fatkeqsisht sot ajo ka një gjendje fizike shumë të demtuar, me shkaterime të shumta të shtresës së asfaltit, dhe mos mirembajtje në shumë segmente të saj.

**Bestrove:** Fshati është i aksesueshëm vetëm nga rruga kombëtare Tiranë - Vlorë. Ajo është një rrugë e ndërtuar përpara viteve 90', e shtruar me asfalt pjesërisht dhe e pajisur me kanalet anësore të shkarkimit të ujërave.

E njëjta situatë paraqitet edhe me Bestrovën e vogël, fshat i cili e ka aksesueshmerinë nga degëzimi i rrugës kryesore të fshatit të Bestrovës. Kjo është gjithashtu një rrugë e pashtuar.

**Kërkova** është një fshat aktualisht i arritshëm me rrugë të pa asfaltuar por thjesht të hapur dhe të shtruar me zhavor, e cila zhvillohet si degëzim i rrugës kryesore të fshatit Bestrovë. Ekziston edhe një lidhje e dytë e këtij fshati me fshatin e Hoshtimës, më në veri të saj, por që kjo e fundit, mund të kategorizohet si udhëkalim vetëm për kembësorë dhe kafshë.

**Nartë:** Rrugët e këtij fshati karakterizohen nga një strukturë fizike e mirë, për shkak sepse vitet e fundit ato janë riasfaltuar, apo rehabilituar në shumë segmente të saj. Ndërsa pjesa i perket parametrave gjeometrikë dhe askesorëve të tjerë sipas standarteve të (BE), ato ende nuk i plotësojnë.

**Zvernec:** Në fshatin e Zvernecit, ashtu sikurse dhe në fshatin e Nartës aksesimi është i dyfishtë; nga rruga kombëtare, nga autostrada, gjithashtu edhe nga një rrugë bregdetare, e cila përkrah gjithë zonën e pyllit të sodës, zonën bregdetare, dhe ish zonën industriale

**Babica** ka një infrastrukturë rrugore, me kushte dhe parametra të standarteve rrugore mjaft të mira. Te pajisura me ndriçues dhe trotuare për këmbësorët. Gjërësia e rrugëve kryesore të këtij fshati arrijnë deri në 8m dhe përbehet nga dy korsi. Ndërsa komplet rrjeti rrugor i një pjese të fshatit, dhe konkretisht i lagjes Aliko, është krejtësisht në gjendje shumë të keqe, i paasfaltuar, me rrugë shumë të ngushta (2,5-3m), të pjerrta, dhe shumë të veshtira në aksesueshmeri në rastet e emergjencës.

E njëjta situatë, pjesa i perket infrastrukturës rrugore, paraqitet edhe për fshatrat më të thellë të njësisë, Sherishtë dhe Xhyherinë

**Kaninë:** Fshati i Kaninës aksesohet me anë të rrugës kryesore të saj, që ka nismën nga unaza e madhe e qytetit të Vlorës. Ajo është një rrugë në gjendje të mirë fizike dhe me parametra që përmbushin standartet e një niveli të mesëm të ndërtimit të rrugëve. Në brendësi të fshatit, infrastruktura është shumë e dobët. Shumë segmente të rrugës kryesore të fshatit të Kaninës janë të dëmtuara në sipërfaqet e asfaltuara, pa trotuare, etj. Ndërsa ndricimi është prezent në të gjithë rrugën kryesore të saj.

**Njësi administrative Shushicë-** Njësi administrative e Shushicës shtrihet në 51 km<sup>2</sup> sipërfaqe nga të cilat 21km<sup>2</sup> janë fushore dhe 30km<sup>2</sup> janë kodrinore. Afërsisht 70% e popullsisë është e përqëndruar në fshatra çka do të thotë që popullsia rurale vendase është e koncentruar në qendrat rurale të urbanizuara. Rruga kryesore e qendrës administrative është e shtruar vetëm 5 km ndërsa rreth 95 % e saj është e pashtuar dhe në kushte të vështira. Transport urban publik brenda njësisë administrative Shushicë nuk ka, vetëm kompani me minibus të licensuar nga Bashkia operon nëpër fshatra.

**Shushicë** Bulevardi i fshatit me gjatësi 650 m, me gjerësi 9 m (6,0 m asfalt dhe

dy trotuare 2x1,5 m) është i asfaltuar por ka nevojë për rikonstruksion. Hyrja në Shushicë Qendër nga kthesa e Grabianit me gjatësi 600m e asfaltuar ka gjërësi 8,0m është në gjendje të mirë. Te dyja keto segmente përfshihen në totalin e gjatësisë prej 4,5 km. Gjithashtu edhe rruga Shushicë Llakatund me gjatësi totale 4,5 km me gjërësi 6m e asfaltuar ka nevojë për rikonstruksion.

Sistemi rrugor për fshatrat **Bunavi Beshisht Grabian** është i pa strukturuar. Kudo ka rrugë hyrëse të pashtruara. Edhe rrugët lidhëse janë të pashtruara

**Drithas** Rruga kryesore prej 1 km që lidh Drithasin me qendër Shushicë është e asfaltuar ndërsa pjesët e tjera të segmentit rrugor të fshatit drithas janë të paasfaltuara

**Mekat, Çeprat** Rrugët përkatësisht Çeprat me gjatësi totale 2 km dhe Mekat me gjatësi totale 2,2 km gjërësi 4 m janë të paasfaltuara, me cakëll, në gjendje shumë të keqe. Në gjendje të keqe është edhe rruga Kthesa Ceprat - Qender Ceprat 1.1 km

**Llakatund** Pjesa horizontale që lidh Llakatundin me Shushicen rreth 0.5 km, është e asfaltuar. Ndërsa rrugët e brendshme të fshatit janë të paasfaltuara

**Risili** Vetëm segmenti Risili-Shushicë është në gjendje të mirë në kondicionin e rrugëve rurale ndërsa pjesa që nga Qafa E Kociut - Risili - Llakatund 8.3 km është e paasfaltuar.

**Njësia administrative Novoselë-** Njësia administrative Novoselë klasifikohet në njësitë me rrjet rrugor të gjërë dhe me gjendje teknike relativisht të kënaqshme kryesisht në anën perëndimore. Të gjithë fshatrat e njësisë lidhen me qendrën e njësisë me rrugë automobilistike të asfaltuara. Por mungesa e një sistemi të efektshëm të mirëmbajtjes së rrugëve përkeqëson më shumë situatën aktuale. Volumi në rritje i trafikut në rrugë është burimi kryesor i trafikut të renduar duke shkaktuar probleme ekonomike dhe mjedisore. Volumi i trafikut në stinën e verës përkeqëson më tej situatën për shkak të vërshimit të turistëve. Ndër të metat e sistemit rrugor të njësisë Novoselë është fakti se rrugët që të çojnë në bregdet janë të pasistemuara dhe në gjendje të keqe, gati të pakalueshme sidomos në stinët me reshje. Rruga kryesore e njësisë Novoselë që kalon përgjatë fshatrave Aliban Fitore deri në Bishan, Delisufi, Dellinjë etj në tërësi 12 km ka mungesë të sistemit të ndriçimit ndërsa segmenti 7 Bunavi e Sipërme - Bestrovë 2.7 km është i paasfaltuar.

Mungon brenda njësise administrative transporti publik urban, vetem një kompani me minibus e licensuar nga Bashkia operon nëpër fshatra.

**Mifoli** Ka rrugë me gjërësi totale 6m ( 4 asfalt dhe bankinat 2 x1 m), ka qenë e shtruar me asfalt sot është në gjendje tërësisht të amortizuar, sa nuk shihet ekzistenca e asfaltit.

**Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë** të cilat janë në krahun lindor të njësisë Novoselë rrugët me gjërësi 5.0 m (3,5m asfalt +2 x 0,75 bankinat anesore) janë në gjendje krejtësisht të amortizuar, janë të pamirëmbajtura në hyrjet e tyre, ndërsa në

brendesi janë të paasfaltuara.

**Akërne** Rruga hyrëse në Akërne me gjërësi 5.0 m ( 3,5m asfalt +2 x 0,75 bankinat anësore) është në gjendje është e pamirëmbajtur dhe krejtësisht e amortizuar. Gjatesia e rruges nga Novosela -Akërne-Poro 9.0 km. Gjatesia e rruges Fitore - Bishan -Poro -Delisuf 10,5 km

**Njësia administrative Orikum** Për njësinë administrative Orikum mund të thuhet se sistemi rrugor nuk është edhe aq problematik. Të gjitha fshatrat lidhen me rrugën nacionale me rrugë automobilistike. Rruga nacionale që përshkon zonën e Njësisë Orikum nga Përroi i Vrizederit deri në Qafën e Llogarasë ka pësuar disa herë rikonstrukcion duke përmirësuar parametrat e saj. Gjithsesi, nevoja për rehabilitime ekziston, duke pasur parasysh edhe faktin që zona është turistike. Transport publik në këtë njësi mungon, megjithëse është teper i domosdoshem gjatë sezonit turistik. Transporti publik realizohet në fshatra me kompani të licensuara nga Bashkia për shërbim transporti por në orar të kufizuar. Ky problem është teper i mprehtë gjatë periudhës së verës ku pushuesit nuk kanë shërbim me kohë të gjatë për transport.

**Orikumi qendër** Rruga me dy korsi 7m dhe 8 m, korsi ndarëse 1m në mes dhe dy trotuare me gjerësi që varion deri në 2m pra me një total trupi të rrugës me gjerësi 20m është në gjendje të mire, ka infrastrukturë shumë të mire.

Rruga Dukat Fshat 2.5 km me gjërësi 6 m (4,5 asfalt +2 x 1,5 m) dhe Dukat i Ri me bulevardin 10,5 m asfalt dhe trotuaret në të dy krahet me gjerësi 3m rrugë kryesore janë në gjendje të mirë. Shetitoret nga Bashkia në drejtim të bregdetit me gjerësi totale 14,1 m, ka të gjithë elementët e saj në gjendje të mirë (rrugën 8.5 m të asfaltuar, lulishten 0,6m dhe shetitoren 5m të gjërë)

**Tragjas** Rruga kryesore që të çon në fashtin Tragjas është në gjendje të mirë ndërsa në Tragjasin e vjetër rruga nuk është në kushte të mira dhe e paasfaltuar.

**Radhimë** Rruga për në fshatin e vjetër të Radhimës është shumë e mirë, ndërsa në pjesën e poshtme, pra pjesa e rrugës nacionale ka nevojë mirëmbajtje dhe përmirësimi kondicionesh.

#### 1.4.2.2 Furnizimi me ujë

**Qyteti Vlorë** Rrjeti i shpërndarjes së ujit të pijshëm është shumë i amortizuar. Njëpërmjet investimit hollandez me një vlerë prej 24 milion Euro është mundësuar depo e madhe e ujit me kapacitet 6000m<sup>3</sup> së bashku me rrjetin shpërndarës nga stacioni i pompimit në Ujin e Ftohtë tek depo mbi Bishtin e Kalldrëmit.

#### Njësia administrative Qendër Vlorë

**Bestrovë:** Situata e ujit të pijshëm në Bestrovë ashtu sikurse edhe në fshatrat e

tjerë të kësaj njësie paraqitet mjaft e rënduar. Në majën e kodrës që ndodhet në pjesën lindore të Bestrovës është vendosur një depo uji me kapacitet  $V=80m^3$ , e cila merr ujin nga Novosela dhe e shpërndan atë me një sistem të dobët dhe shumë të amortizuar në të gjithë fshatin. Sistemi i shpërndarjes është po ashtu tërësisht i amortizuar dhe uji ka shije hekuri si pasojë e tubacioneve të dëmtuara rëndë.

**Kërkovë:** Fshati lidhet po ashtu me rrjetin nga tubi kryesor i Novoselës, por tubi ka një diametër më të madh se dy fshatrat e mësipërm me një  $\Phi=120mm$  dhe me një gjatësi rreth  $L=2500m$ . Uji shtyhet përmes një sistemi pompimi me prurje  $Q=15m^3/orë$  për në depozitën e fshatit me kapacitet  $V=100m^3$ . Rrjeti shpërndarës ekzistues është tërësisht i amortizuar dhe vende-vende vërehen tubacione plastike të reja me  $\Phi=30 \times 2$ . Uji i rrjetit nuk përdoret për tu pirë.

**Panajaja:**Paraqet një infrastrukturë të amortizuar të sistemit të ujit të pijshëm (1,9 km) me ujin që vjen nga Novosela përmes një tubacioni kryesor të ujit të pijshëm që ka një diametër me madhësi  $\Phi=315mm$ . Fshati furnizohet me ujë të pijshëm përmes këtij tubi kryesor ku në pikën hyrëse është instaluar një pompë me prurje  $Q=15m^3/orë$  e cila lidhet me tubi kryesor që furnizon fshatin e Panajasë, me dimension  $\Phi=100mm$  nëpërmjet të cilit ujë dërgohet në depozitën e ujit me kapacitet  $V=50m^3$  në majë të kodrës që ndodhet në pjesën jug-perëndimore të fshatit, që prej 20 vjetësh nuk është treguar asnjë kujdes nga organet përgjegjëse. Ujë shpërndahet më rënie të lirë në rrjetin e sistemit të ujit të pijshëm, i cili është me tubacione të amortizuara dhe nuk mund të përdoret për t'u pirë.

**Hoshtimë:**është një ndër fshatrat e Njesisë Qendër me rreth 150 familje. Rrjeti i ujit të pijshëm lidhet me tubin kryesor që vjen nga Novosela. Tubacioni ka një gjatësi prej  $L=2300m$  dhe ka një diametër me  $\Phi=100mm$ . Sasia e ujit pompohet me prurje  $Q=15m^3/orë$  për tu depozituar në depozitën e ujit të fshatit, e cila ndodhet në majë të kodrës së Hoshtimës, me një kapacitet prej  $V=100m^3$ . Rrjeti shpërndarës është me tubacione dhe është i amortizuar e për pasojë uji nuk është i pijshëm. Fshati siguron rreth 1 orë uji në ditë.

**Babicë:** Fshati Babicë ka një rrjet të ujit të pijshëm të amortizuar (Babicë e madhe 5,4 km dhe Babicë e vogël 3,4 km). Uji që vjen përmes rrjetit nuk përdoret për të pirë nga banorët megjithëse në disa zona janë vendosur tubacione të reja plastike. Depoja e ujit me kapacitet  $V=400m^3$  që furnizohet nga Vlora gjendet në anën jugore të fshatit.

**Xhyherinë:** Fshati Xhyherinë ka rreth 60 familje. Rrjeti i ujit të pijshëm është pothuajse i amortizuar dhe uji që vjen në të nuk përdoret për ujë të pijshëm nga banorët. Rrjeti ka një gjatësi prej 3,7 km dhe në disa pjesë të tij është zëvendësuar me tubacione të reja plastike. Depoja e ujit me kapacitet  $V=100m^3$  e cila ndodhet në kodrën në anën perëndimore të fshatit siguron rreth 2 orë në ditë uji dhe furnizohet nga pusët e thelle  $h=30m$ .

**Sherishte:** Fshati Sherishte që ka rreth 70 familje ka një situatë po aq problematike sikurse edhe fshatrat e tjerë të rrjetit të ujit të pijshëm me një gjatësi afro 2 km. Uji që vjen përmes rrjetit nuk përdoret për tu pirë nga banorët pasi si depoja që ndodhet në jug-lindje të fshatit ashtu edhe tubacionet janë plotësisht të amortizuara. Uji vjen në depon e ujit nga pusi në afërsi të lumit Shushica nga ku merret dhe pompohet me  $Q=10-12m^3/orë$  përmes një tubi me dimensione  $\Phi=120mm$  për ne depozitën me kapacitet  $V=150m^3$ .

**Kanina:** që gjendet në jug-lindje të qytetit të Vlorës, në shpatin e malit Shashicë, ka rreth 5 km rrjet për ujin e pijshëm i cili është i amortizuar dhe banorët nuk e përdorin ujin e rrjetit për të pirë. Ky fshat e merr ujin nga rrjeti kryesor i qytetit të Vlorës që ky i fundit e merr nga nenstacioni i ujit të ftohtë. Më pas nga tubacioni kryesor me  $\Phi=120mm$  nëpërmjet një degezimi uji grumbullohet në depon që ndodhet në rreze të malit, dhe më pas ngjitet sipër në depon e fshatit të Kaninës me kapacitet  $V=150m^3$ , e cila ndodhet brenda fortifikimeve të kalasë së saj. Disa shtëpi kanë shtruar në mënyrë private tubacione të reja plastike por që kjo nuk e përmirëson cilësinë e ujit që vjen nga depoja e vendosur në Kalanë e Kaninës dhe që furnizohet nga Vlora nga 1 deri 2 orë në ditë.

**Zvërnec:** Furnizohet me ujë të pijshëm nëpërmjet lidhjes me qytetin e Vlorës nga një pikë tjetër nga ajo që furnizon Nartën. Lidhja behet në pjesën perëndimore të qytetit të Vlorës, në stacionin pranë ish zonës industriale. Nga këtu lidhet një tub me dimension  $\Phi=100mm$  dhe depoziton ujin në depon e fshatit në maje të kodrës me kapacitet  $80m^3$ . Në Zvërnec gjendja e infrastrukturës së rrjetit (8 km) të ujit të pijshëm është mjaft e amortizuar kjo bën që uji që vjen përmes tubacioneve nuk mund të pihet. Në disa shtëpi janë shtruar tubacione të reja plastike. Depoja e ujit që gjendet në majë të kodrës, që ndan fshatin në dy pjesë, është po ashtu e amortizuar

**Nartë:** Fshati i Nartës ka një infrastrukturë të rrjetit të ujit të pijshëm mjaft të amortizuar dhe nuk përdoret për t'u pirë nga banorët. Uji i këtij fshati, vjen nga rrjeti i qytetit të Vlores nëpërmjet tubit me dimension  $\Phi=200 mm$ . Për të plotësuar nevojat me ujë të pijshëm, banoret e fshatit duhet ta sigurojnë atë duke e blerë.

### **Pasuritë ujore në Njesinë Qendër Vlorë**

**Ujërat nëntokësore** në zonën e Nartë-Vjosë janë të rrezikuara nga mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza. Investime në krijimin e rrjeteve të reja dhe ristrukturimi e mirëmbajtja e tyre do të sillnin një përmirësim të pastërtisë së tyre. Kjo është shumë e rëndësishme pasi një pjesë e mirë e fshatrave e sigurojnë nga pusët në thellësi të ndryshme. Ujërat në këtë zonë janë të cekta dhe gjenden kryesisht në thellësi nga 1m deri në 10 m. Në pjesën tjetër të Njesisë ujërat nëntokësore gjenden edhe më thellë dhe janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të fshatrave, pasi uji i rrjetit është mjaft i ndotur si pasojë e amortizimit shumëvjeçar të tij dhe si

pasojë e mungesës së investimeve të rehabilitimit. Pjesa më e madhe e shtëpive në këto fshatra e nxjerrin ujin e pijshëm nga pusët. Tendenca e rrjedhjes së këtyre ujërave është drejt perëndimit në detin Adriatik.

*Ujërat sipërfaqësore në Njësinë Qendër Vlorë përfaqësohen kryesisht nga lumi i Vjosës, i cili derdhet në detin Adriatik, në veri të lagunës së Nartës. Kjo pasuri e madhe ujore sot po degradon sidomos në pjesën e saj që gjarpëron në këtë Njësi administrative si pasojë e aktivitetit të kompanive të inerteve por edhe si pasojë e ndotjeve (ujërave të zeza etj) që vijnë nga vendbanimet dhe fshatrat (rreth 40 të tilla) përreth luginës së tij. Ndotja ka ndryshuar ekosistemin duke sjellë si pasojë më të dukshme, shfarosjen e rrapit lumor. Megjithëse Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë gjobitur disa Njësi administrative që derdhin mbeturinat e tyre në lumë, kjo nuk po e ndryshon cilësinë e ujërave. Përveç ndotjes, përgjatë gjithë luginës së Vjosës po ndodh edhe shpyllëzimi masiv, tharja e rrapit lumor dhe gjuetia e paligjshme po çon drejt degradimit një prej pasurive më të rëndësishme ujore të Shqipërisë.*

Lumi tjetër i rëndësishëm në këtë komunë është edhe ai *Shushicës* apo siç njihet ndryshe lumi i *Vlorës*, i cili është një tributar i lumit Vjosa. Në pjesën e poshtme të rrjedhjes së këtij lumi, gërryerjet në shtratin e këtij lumi janë bërë një rrezik real për banorët që jetojnë në brigjet e tij. Kjo sjell pasoja kur bien reshje të shumta, lumi del nga shtrati duke përmbytur rrugën, por edhe shtëpitë pranë, duke prishur edhe tokat bujqësore me inertet që bart gjatë përmbytjeve. Gjithashtu të dy këta lumenj me ndotjen e tyre ndikojnë negativisht në pastërtinë e ujërave të detit në grykëderdhje. Kjo ndotje mund të sjellë pasoja negative edhe në ndotjen e ujërave të lagunave pranë. I njëjti numër dhe natyrë masash janë të nevojshme për të ruajtur ekosistemin e këtij lumi të rëndësishëm për zonën e Vlorës, si në rastin e lumit Vjosë.

**Rezervuarët e ujërave** (7 rezervuarë) të ëmbla që gjenden në fshatrat e Njesisë Qendër Vlorë (në Hoshtime, Bestrovë, Zvërnec dhe Babicë) kanë një rëndësi të dyfishtë për zonën. Së pari shërbejnë si i vetmi burim uji i ëmbël për faunën dhe së dyti edhe si burim uji për ujitje për tokat. Këtu duhet theksua edhe dëmtimi i madh që ka pësuar sistemi ujitë dhe drenazhues i zonës si pasojë e dëmtimit nga ana e njerëzve por edhe nga amortizimi dhjetëra vjeçar i tyre. Masa urgjente janë të nevojshme të ndërmerren pasi situata do të përkeqësohet edhe më tej duke e dëmtuar edhe më tej ekonominë bujqësore të zonës si dhe zhdukjen e llojeve të lidhura me këto habitate.



**Figura 1 Rezervuarët me ujë të ëmbël**

*Burimi:* foto nga eksperti

**Lagunat** janë një tjetër trup ujour i rëndësishëm i zonës në studim dhe përfshin lagunat e Nartës dhe atë të Kallëngës. Të dyja këto Laguna janë mjaft të rëndësishme për zonën si nga pikëpamja turistike ashtu edhe ajo biologjike. Shumëllojshmëria biologjike e këtyre lagunave si dhe funksioni i tyre për folëzim të shpendëve i japin atyre një rëndësi të veçantë dhe mbrojtja e tyre bëhet një domosdoshmëri. Laguna e Nartës plotëson kushtet e një Ramsar-i dhe merr edhe një rëndësi edhe më të madhe për Shqipërinë, e cila deri më sot ka vetëm dy zona Ramsar.

Të dyja këto laguna janë të rrezikuara si nga faktorë natyrorë por edhe nga ato njerëzorë që lidhen kryesisht me presionet që vinë në zonë nga turizmi dhe aktivitetet që lidhen me të dhe nga prania e industrisë së rëndë në afërsi të tyre. Mungesa e ujërave të ëmbël, mbushja e kanaleve lidhëse me detin, marrja e ujit nga kriporja, ndotja urbane dhe industriale si dhe gjuetia e vazhdueshme dhe pa kritere shkencore janë disa nga faktorët që duhen adresuar shpejt dhe në kohë nga autoritetet përgjegjëse për të shmangur katastrofën ekologjike.

**Njësia administrative Shushice** Rrjeti i ujësjesit është tepër i amortizuar për gjithë njësinë Shushicë pavarësisht se ka burime shumë të mira ujore me cilësi të lartë dhe pa gelqerore. Nga stacioni i pompave tek ish serrat (Shushicë) me një pompë centrifugale me kapacitet me  $Q=18$  lit/sek (dhe me një pus rezerve pa elektropompë), nëpërmjet tubacionit me diametër 250mm me gjatësi 2 km, kalon në stacionin ndërmjetës (prane zyrave) ku gjendet një rezervuar 18 m<sup>3</sup> dhe një pompe centrifugale me kapacitet me  $Q=25$  lit/sek. Nga stacioni ndërmjetës uji dërgohet në depon e ujit të



fshatit Drithas me kapacitet 480m<sup>3</sup>. Nga depua e drithasit dalin 4 degezime që furnizojnë me uje depot e ujit të fshatrave:

**Shushicë** me kapacitet 80 m<sup>3</sup> nëpërmjet linjes 1 km me diametër 110 mm,

**Llakatund** me kapacitet 280 m<sup>3</sup> nepermjet linjes 1,8 km me diam 150 mm,

**Mekat** me kapacitet 40 m<sup>3</sup>, nepermjet linjes 1 km me diameter 100 mm si dhe lagjia Mehalle me nje gjatesi prej 0,5 km

**Grabian** Depua e ujit me kapacitet 200 m<sup>3</sup> furnizohet nga stacioni i ndërmjetëm Shushicë nëpërmjet linjës 1,5 km me diametër 100 mm

**Fshati Bunavi** nuk ka rrjet shpernarje të ujit te pijshëm. Furnizimi bëhet me pus.

**Risili** Nga stacioni i pompave me anën e një pompe zhytese me kapacitet Q=13 l/sek ( me pus) dërgohet në depon e ujit me kapacitet 300 m<sup>3</sup>, nëpërmjet linjës 2,5 km me diametër 150 mm HDPE. Nga depoja e Risilisë me vetërrjedhje shkon në Depon e Çepratit me kapacitet 40 m<sup>3</sup> nëpërmjet linjës 0.5 km me diametër 90 mm

**Drithas** Ka depo të madhe uji me kapacitet 480 m<sup>3</sup>/s dhe sipas sistemit të shpërndarjes në fshatrat përreth kjo është depoja furnizuese e tyre.

**Beshisht** S'ka as depo as rrjet shpernarje te ujit te pijshem

**Njesia administrative Novosele** Njësia administrative Novoselë identifikohet si një zonë ujëmbajtëse me kapacitet të lartë të mundësive të prodhimit të ujit të pijshëm jo vetem për nevojat e popullatës por edhe me mundësi të furnizimit të fshatrave të komunës Qendër si dhe të qytetit të Vlorës. Në vitet 60 është ndërtuar ujësjellësi i Novoselës, me kapacitet 400 l/s i cili në vite ka furnizuar gjithë fshatrat e zonës dhe qytetin e Vlorës. Në Novoselë janë instaluar 4 pompa centrifugale, 2 pompa me fuqi N=250Kë dhe kapacitet Q=360 m<sup>3</sup>/ore lidhur ne paralel dhe 2 pompa me fuqi N=160Kë, me kapacitet Q=360 m<sup>3</sup>/ore, lidhur në paralel. Uji nëpërmjet 6 puseve që ndodhen në Novoselë (realisht janë 7, por njëri është jashtë funksionit) në të cilët janë të instaluar nga dy pompa të lidhura paralel me prurje q=27 l/sek ose 100 m<sup>3</sup>/orë, dërgohet nëpërmjet tubacionve prej celiku me diametër 200mm në depon e ujit me kapacitet 300m<sup>3</sup> që ndodhet pranë stacionit kryesor të pompave. Nga depoja uji shpërndahet nëpërmjet tubacionit me diameter 250mm në drejtim të Poros dhe drejtimi tjetër është ai i Panajasë ku merr furnizim dhe Aliban dhe Akërnj. Novosela e merr furnizimin direkt nga rrjeti. Po kështu fshatrat Çerkovinë, Skrofotinë e Mifol e marrin nga daljet që janë lenë në linjën e dërgimit të Panajase nëpërmjet tubit me diameter 315mm. Trevllazeri furnizohet nga depoja qe e merr ujin nga stacioni i pompave ne Skrofotine.

Në kushtet aktuale prodhimi i ujit ka rënë si për shkak të amortizimit dhe dëmtimit të tubacioneve kryesore edhe për shkakun se nga koha e gjatë e gjatë e

shërbimit, puset e marrje së ujit janë mbathur dhe lind nevoja e çpimit të puseve të reja.

**Njësia administrative Orikum** Ujësjellesi i ri furnizon me ujë 24 Orë Orikumin qendër, Radhimë, Dukatr e Ri, Tragjas pjesërisht. Biznese të vendosura buzë detit pergjatë Orikunit e marrin ujin nga Pashë Aliman. Stacioni i pompimit të ujit pranë repartit ushtarak për bonifikimin e tokës është modern por nuk funksionojnë dhe kanë bërë qe të të ulet cilësia e pjelloria e tokës.



### 1.4.2.3 Rrjeti i kanalizimeve

- **Qyteti i Vlorës** Qyteti ka rrjetin ekzistues të kanalizimeve nga uji i ftohtë deri tek impianti i përpunimit.

#### **Sistemi i kullimit**

Zona ka stacione pompimi dhe disa kanale me rrjedhje të lirë. Hidrostacioni i Vlorës gjendet në jug të kufijve të kompleksit lagunor. Ai kullon një sipërfaqe prej 1 000 ha. Kapaciteti pompues është afërsisht 16 000l/s. Uji shkarkohet në det. Gjate 15 viteve të fundit investimet në sektorin e ujrave janë shumë të pakta dhe kanë çuar në mbushjen e kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë. Si rezultat kapaciteti kullues është reduktuar dukshëm.

#### **Njësia administrative Qendër Vlorë**

**Bestrovë:** Gjendja e kanalizimeve të ujërave të zeza është në një situatë katastrofike. Ato pothuajse nuk ekzistojnë dhe derdhen në mënyrë të pakontrolluar duke rrezikuar seriozisht shëndetin e njerëzve si dhe të ujërave nëntokësore.

**Kërkovë:** Gjendja paraqitet e rëndë edhe për kanalizimet e ujërave të zeza pasi sistemi mungon pothuajse fare me përjashtim të disa gropave të zeza të ndërtuara jashtë standardeve.

**Panajaja:** Sistemit i kanalizimeve të ujërave të zeza është inegzistent dhe ato shpërndahen në gjendje të lirë, prane kanleve, apo në gropa septike të ndërtuara jashtë standardit.

**Hoshtimë:** Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza sikurse edhe në shumë fshatrat e tjera të Komunës Qendër nuk ekziston dhe derdhja bëhet në gropa septike, kanal etj.

**Babicë:** Rrjeti i ujërave të zeza (B.vogël 340 m). nuk ekziston në këtë fshat, por janë të gjitha të shpërndara në terrene të lira, pranë kanaleve, rezervuarve, etj vetëm një zonë shumë e vogël e fshatit ka rrjetin e ujërave të zeza.

**Xhyherinë:** Po ashtu rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza përfaqësohet vetëm nga gropa septike apo në disa raste ato përfundojnë në natyrë, duke rrezikuar kështu seriozisht cilësinë e ujit të puseve.

**Sherishte:** Gropat septike janë të vetmet struktura të vërteta për sistemimin e ujërave të zeza dhe një pjesë i derdhen ato në natyrë pranë kanaleve apo rezervuarit.

**Kanina:** është një nga fshatrat të cilët nuk kanë as rrjet të ujërave të zeza dhe për pasojë uji i puseve është i rrezikuar nga ndotja.

**Zvërnec:** Zona kodrinore e Zvërnecit ndodhet në veri-perëndim të Vlorës. Shigjeta e vjetër ranore e formuar nga aluvionet e lumit Vjosa që ka derdhur në det, ndan pjesën veriore të lagunës së Zvërnecit. Zhvendosja e grykëderdhjes së Vjosës gjatë shekullit të 20 ka krijuar probleme serioze të erozionit në këtë sektor të gjithë të

Vlorës. Ngarkesa e ngurtë që derdh në det lumi Vjosa, si dhe materiali i vjetër nga grykëderdhja e vjetër e lumit synojnë të depozitohen në drejtim kryesisht jugor.

**Nartë:** Gjendje shumë e dobët paraqitet për sistemin e kanalizimeve të ujrave të zeza. Ato nuk ekzistojnë në këtë fshat, por derdhen të gjitha të shpërndara në terrene të lira, pranë kanaleve, rezervuarëve, apo dhe në vetë oborret e shtëpive, apo në gropa septike.

#### **Sistemi i ujitjes**

*Ujitja* në zonë është bazuar në ujërat e lumit Vjosa si dhe në rezervuarët e zonës. Infrastruktura ujitëse konsiston në stacionin e pompimit në afërsi të urës së Mifolit më një kapacitet prej *4000l/sek*. Toka nën ujë në Njesine qender Qendër është rreth *300ha* ndërkohë që kapaciteti është edhe më i madh. Gjithashtu një pjesë tjetër e tokave bujqësore në afërsi të fshatit Panaja mbulohen me ujë nga rezervuari artificial i Panajasë (*1.4 milion m<sup>3</sup>*). Kapacitet ujitëse janë mjaft më të mëdha se sa ujiten aktualisht dhe kjo për arsye se për më shumë 15 vjet nuk ka as investime të reja dhe as mirëmbajtje të sistemit ujitës.

#### **Sistemi i kullimit**

Sistemi përbëhet nga disa pompa që mbulojnë të gjithë territorin e zonës përfshi, këtu edhe ato fqinje, stacioni i pompave të Gorricës gjendet në afërsi të lagunës së Nartës dhe kullon një sipërfaqe rreth *1000ha* me një kapacitet *16.000 l/sek*. Ujërat e këtij stacioni pompimi sëbashku me atë të Akerni përfundojnë në lagunë e Nartës. Ky sistem po ashtu është i amortizuar prej vitesh nga mungesa e mirëmbajtjes dhe investimeve duke ia ulur kapacitet kulluese dhe drenazhues.

#### **Njesia administrative Shushice**

Ish zona e pallateve tek bulevardi Shushicë si dhe zgjatimi deri në Llakatund kanë kanale të sistemuara të ujrave të zeza që nga 1980 por rrjeti është i amortizuar si dhe derdhja e tyre bëhet pranë lumit. Resti i fshatrave mbulohet me gropa septike.

#### **Sistemi i ujitjes**

Sot ujiten 450 ha tokë bujqësore, nga të cilat 350 ha në fshatrat Risili, Çeprat, Grabian Shushicë e Llakatund me veprën ujitëse: "Kanali i Penkovës" me një gjatësi prej 9 km me rrjedhje të lirë. Fshati Bunavi ujit rreth 100 ha tokë nga rezervuari pranë këtij fshati nëpërmjet kanaleve me gjatësi 7 km. Vepra e marrjes së ujit nga lumi Shushicë deri tek kanalet e treta ujitëse janë në varesi të Bordit të Kullimit. Kanalet e treta të ujitjes dhe kullimit në ngarkim të fermerëve dhe Bashkisë, kanë një gjatësi 12 km.

### **Sistemi i kullimit**

Kanalet kryesore kullues të Llakatundit, ku futen kolektorët dhe kanalet e para e të dyta kulluese janë në varësi të Bordit të Kullimit, kurse kanalet e treta kulluese, rreth 6 km janë në ngarkim të fermereve dhe Bashkisë.

### **Njësia administrative Novoselë**

Rrjeti kryesor i kanalizimeve kalon vetëm në fshatin Novoselë dhe në Ibën e Poshtme në dy lagje. Në këtë njësi fshatrat Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Trevllazër, Çarkovinë, Skrofotinë, Akërnë funksionojnë me gropa septike (në total 836 të tilla), sidomos në Akërnë situata është me e rëndë. Sistemi i kanalizimeve funksionon më mirë në fshatrat Novoselë, Fitore, Aliban por me përjashtim të Novoselës rrjeti është i amortizuar. Nga rrjeti KUZ përfitojnë 41% e popullsisë që ka dendësinë më të madhe në këto tre fshatra. Rrjeti i ujrave të bardha në këtë njësi nuk ekziston. Në disa vende ku gjendet ai bashkohet me KUZ

### **Sistemi kullues**

Hidrostationi i Akërnisë ka një kapacitet pompimi prej 11 000l/s dhe kullon 6 500 ha. Gjendet në pjesën veriperëndimore të kompleksit lagunor. Pjesa kryesore e ujit hidhet në det dhe një pjesë e vogël hyn në pjesën lindore të Nartës.

### **Sistemi i ujitjes**

Kanalet vaditese të pa mirëmbajtur për 25 vjet dhe vetëm sivjet filluan të pastrohen.

### **Njësia administrative Orikum**

Kanalizimet e ujrave te zeza janë të amortizuara ne Orikumin e vjetër, pjesa tjetër e fshatrave ka gropa septike.

Për fshatrat **Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë** përdoren gropa septike.

#### *1.4.2.4 Furnizimi me energji dhe telekomunikacioni*

### **Qyteti Vlore**

Qyteti aktualisht mbulon nevojat për energji nga:

- Nenstacioni Vlora 1 110/35/20/6kv;
- Nenstacioni Vlora 2 110/20kv;
- Nenstacioni Uji i Ftohte 35/6kv;
- Nenstacioni Skele 35/6kv;

Po kështu për gjithë Bashkine janë edhe nenstacionet Smokthine 35.10kv; dhe nenstacioni Gorisht 35/6kv.

Termocentrali i Vlorës i ndërtuar ne vitin 2009 me një fond prej 96.6mln Euro me financim te BE, BERZH dhe BEI është në pronësi të KESH-it. Për momentin nuk është në punë pas një defekti në zonën e ftohjes.

TEC-i është ndertuar prej një blloku 98 me cikël të kombinuar të energjisë elektrike dhe perbehet nga turbina me gaz 68MVV dhe turbina me avull 30MVV dhe gjeneratori i avullit të tejnxehur. Ky TEC ka mundësi zgjerimi për dy blloqe të tjera të të njetes fuqi duke arritur nje fuqi totale të instaluar deri 291MVV.

**Qendër Vlorë** - Njësia ka problematikë lidhur si me rrjetin shpërndarës ashtu edhe me parametrat që ofrojnë linjat e elektrikut. Në të gjithë zonën situata e rrjetit elektrik gjithashtu është në gjendje jo të mirë sidomos vitet e fundit për arsye të shtimit të rrjetit në drejtim të ndërtimeve informale si shtëpi, ndërtesa industriale etj.

**Bestrovë:** Bestrova furnizohet me energji elektrike nëpërmjet rrjetit që lidhet drejtpërdrejtë nga Njësia e Novoseles dhe shoqërohet me problematikën që shoqëron zonën në tërësi. Linjat më parë kalojnë nga **Panaja**, që është fshati i parë nga ku shpërndahet elektriciteti edhe në dy fshatrat e tjerë Bestrovë dhe **Kërkove**. **Hoshtima** po ashtu furnizohet me energji elektrike nga rrjeti kryesor që vjen nga Njësia e Novoseles.

**Babicë:** Ky fshat furnizohet me energji elektrike nga qyteti i Vlorës, nëpërmjet një stacioni elektrik që ndodhet në pjesën e brendshme të luginës, aty ku kalon rruga që lidh fshatin e Babicës, me atë të Sherishtës. Stacioni elektrik i Babicës, është i madh dhe me një kapacitet të konsiderueshëm për të mbuluar me energji elektrike katër fshatrat, Babicën, **Xhyherinë**, **Babicën e vogël** dhe **Sherishtë**.

Nga stacioni elektrik i Vlorës furnizohet me energji elektrike edhe **Kanina**, **Zvërneci** e **Narta**

**Njësia administrative Shushicë** Rrjeti ekzistues 35/10 i energjisë elektrike është i dobët dhe me probleme pritet të zbatohet projekti i OSHE për rrjetin e ri 6 Kvv me qendër në Xhyherinë.

**Njësia administrative Novosele** Njësia aktualisht furnizohet me energji nga rrjeti 35/10kv në Mifol

**Njësia administrative Oriku** Njësia furnizohet me energji elektrike nëpërmjet nënstacioneve:

Nënstacioni Radhime 35/10kv;

Nënstacioni Oriku 35/6kv;

### **Telekomunikacioni**

Aktualisht ka një mbulim nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të Bashkisë. Përdorimi i kablove optike për Internet dhe

shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen edhe nga operatorë të fuqishëm mobile si T Mobile, Vodafone dhe Plus.

### **Operatorët e rrjeteve fiks dhe mobile në qytetin Vlorë**

Të dhënat e siguruar nga regjistri elektronik-ATLASI për operatorët e rrjetit fiks të shtrirë në qytetin Vlorë ALBtelecom, Abcom, NISATEL, ASC

Në tabelën e mëposhtme jepet informacioni mbi radio antenat e operatorve celular në qytetin Vlorë. GSM Telekom Albania, Vodafone Albania, Vodafone Albania, Plus Communication: LTE Telekom Albania, Vodafone Albania

#### *1.4.2.5 Menaxhimi aktual i mbetjeve urbane*

**Mbetjet urbane** Vlorë gjenerohen më shumë se 40000T/vit mbetje urbane dhe po aq afërsisht edhe mbetje inerte me një mesatare prej rreth 1.9kg mbetje/ditë/banor. Sot fusha e aviacionit mban afërsisht rreth 250 000m<sup>3</sup> mbetje. Pavarësisht studimeve të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve gjendja mbetet problematike. Afërsia e pikës së grumbullimit të mbetjeve me qytetin e Vlorës është një problem akut që lidhet ngushtë me cilësinë e ajrit në zonë, me shëndetin e popullatës dhe zhvillimin. Një zonë të nxehtë përbëjnë edhe mbetjet dhe ndotjet kimike në zonën e plazhit pranë ish Uzina e Sodë-PVC, (vlerësimi i merkurit dhe metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit

#### **Qendër Vlorë**

**Panajaja:** Gjendja e mbetjeve urbane edhe në këtë fshat është kaotike dhe mungon një infrastrukturë minimale. Mungesa e konteneirave për këto mbetje, e rëndon edhe më tej këtë gjendje. Ndërtimi i autostradës e ka lehtësuar zonën nga ndotja akustike dhe ambientale e automjeteve

#### **Shushice**

Sasi mesatare e mbetjeve që prodhon Shushica është 8 ton/ditë. Për të gjithë fshatrat **Bunavi Beshisht Grabian Drithas Mekat Llakatund Çeprat Risili** depozitimet shkojnë përgjatë bregut të lumit.

**Novosele** Grumbullimi i plehrave për gjithë fshatrat e njësisë Novoselë depozitohet afër Lumit Vjosë. Novosela prodhon mbetje 15 ton /ditë. Problem shqetësues janë edhe mbetjet ndërtimore. Për momentin pjesa e dherave të nxjerrë nga gërmimet është zgjidhur nga vetë firmat e ndërimit. Mbetjet industriale në këtë njësi janë të pakta.

**Orikum** Mbetjet grumbullohen në Dukat. Sasia e mbetjeve të prodhuara është 9 ton në ditë. Të gjithë fshatrat e njësisë administrative Orikum depozitojnë mbetjet në Dukat



#### 1.4.2.6. Hapësirat e gjelbërta dhe publike

*AR- Hapësirat e Gjelbra-* Më të rëndësishme në planifikimin e zonave të gjelbra, janë ato aspekte cilësore në krahasim me sasioret, të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin strukturor të hapësirave të gjelbra. Këto të fundit janë thelbësore për të ruajtur cilësitë natyrore dhe vlerën e peisazhit dhe për të përfshirë brezat e gjelbër duke e ndarë zhvillimin e vazhdueshëm urban nga korridoret, për të siguruar vazhdimësinë vizuale dhe ekologjike midis hapësirave publike të zonave të vendbanimit dhe objekteve natyrore dhe mjedisore rrethuese. Referenca në këtë proces është bërë edhe tek kapitulli i zonimit në seksionin në vijim. Hapësira të gjelbërta publike në qytetin e Vlorës janë Kuz Bab-ja, lulishte Pavarësia dhe lulishtja e bulevardit. Në veçanti zona perëndimore e qytetit në perëndim të rrugës Transballkanike, është një territor i madh që karakterizohet nga shkalla e lartë të varfërisë, mungesë totale të infrastrukturës, shërbimeve dhe hapësirave të gjelbra. Nëpërmjet planit propozohet krijimi i një parku të madh urban, me vendodhje në ish-zonën e aeroportit të vjetër, që do të ketë ndikim në shkallë qyteti dhe do të krijojë një qendër dhe pikë referimi të re për zonë. Ky park do të ketë në fokus fëmijët dhe aktivitetet për fëmijët dhe do të quhet: Parku Kreativ Mesdhetar ‘Fëmijet e Gezuar’. Parku do të formohet nga një sistem rrugësh që do të krijohen në fazë të parë duke bërë të mundur aksesin për këmbësorët dhe biçikletat.

Zonat e gjelbra i referohen kategorive të mëposhtme:

- Hapësira të hapura në vendbanime (sheshe)
- Zonat publike të shëtitoreve buze bregdetit (plazhi i Nartës Zvernec, fronti ujor i Lagunës së Nartës).
- Zonat rekreative të Komunitetit (zona me aktivitete dhe objekte sociale për komunitetin, zonat të mbuluara nga dielli, sheshe lojrash, aktivitete në mjedis të hapur).
- Zonat e gjelbra buferike (gjelbërim së bashku me rrugët, bulevardet, ndërtimin e komplekseve dhe brigjet ujore).

Për kategorinë e sipërfaqeve të gjelbra është konsideruar standardi i përgjithshëm, 7 m<sup>2</sup> për çdo banor të popullsisë. Standardet e planifikimit për pjesen e orientuar nga deti: Pjesa e orientuar nga deti e zonës së planifikimit është një burim veçanërisht i ndjeshëm, i një rëndësie thelbësore për destinacionin e turizmit dhe zhvillimin e Bashkisë. Ajo luan një rol ekologjik dhe mjedisor të rëndësishëm së lartë, duke pasur habitate dhe ekosisteme unike, ndërkohë që rëndësia e saj ekonomike është gjithashtu thelbësore, si pasuri e madhe e zonës për zhvillimin e turizmit.

Zhvillimi i pritshëm nga pjesa e orientuar nga deti ka nevojë për të lidhur në parimet e mëposhtme:

1. Shmangia përmes trafikut automobilistik që shkëput frontin ujor nga zona urbane;

2. Ofrimin e vendeve të parkimit të përshtatshme;
3. Sigurimin e shërbimeve publike përgjatë vijës bregdetare dhe akseve;
4. Ruajtjen e karakterit natyror të pjesës së orientuar nga deti dhe ndalimi i zhvillimeve të mëtejshme në zonat e vjetra dhe eksplorative;
5. Mbjajtjen e distancës së duhur të ndërtimeve nga bregdeti në rastet e zhvillimit të frontit ujor;
6. Sigurimi i një strukture të qartë për ndërtime të përkohshme.

**Shetitorja e Vlores-** është një projekt ambicioz qellimi i të cilit është shndërrimi i Vlorës në një nga destinacionet kryesore turistike të Mesdheut. Projekti parashikon zgjerimin e plazhit ekzistues dhe një vijë ecjeje në trajtën e shëtitorës tradicionale mesdhetare dhe Shqiptare. Përgjatë gjatësisë së saj prej 7 km ajo është konceptuar të ketë shumë funksione rekreative, si parqe, zona sportive, park-ujor, port jahtesh, etj. Ajo gjithashtu është konceptuar në një tërësi ndërhyrjesh të tjera urbane madhore për qytetin Vlorëes, që lehtësojnë mirëfunksionimin e organizmit të tij gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në sezonin e verës kur Vlora dyfishohet si qytet nga ardhja e turistëve vendas dhe të huaj. Rruga ekzistuese e ujit të ftohtë kthehet në një rrugë fleksibel, por kryesisht në funksion të shërbimeve përgjatë shëtitorës dhe në orët e darkës ajo mund të mbyllet për t'i lenë mundësinë e funksionimit të hapësirës së saj vetëm këmbësorëve dhe turistëve, duke u konsideruar hapësirë unike me vetë shëtitorën.



**Figura 2 Shetitorja e Vlorës**  
*Burimi: AKPT*


**Sheshi Pavarësia-** ndodhet në qendër të qytetit të Vlorës. Ky shesh, i cili është ndër hapësirat publike dhe të gjelbra më të rëndësishme të qytetit, shfrytëzohet vazhdimisht për aktivitete të ndryshme Bashkiake si koncerte, shfaqje, aktivitete të

kompanive të ndryshme, etj. zona përreth tij ka një sërë ambientesh rekreative për qytetarët dhe turistët.



**Figura 3 Sheshi Pavarësia**

*Burimi: google images*



Harta 6- Hapësirat publike, rrugët e biçikletave dhe këmbësore të propozuara

## **1.5 Zonat e rëndësisë kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet, shoqëruar me propozimet për zgjerrimin e tyre**

Territori i Gjirit të Vlorës ku bën pjesë vet qyteti, prezanton një nga zonat më të pasura me monumente e site arkeologjike të Shqipërisë. Ndarja e re administrative ashtu si për njësitë e tjera, ka zgjeruar shumë territorin e Bashkisë së Vlorës duke e shtrirë atë në gjithë Gjirin e Vlorës. Brenda territorit që mbulon, Bashkia e Vlorës është administruese e të gjithë vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe artistike. Rrënojat historike janë të shpërndara brënda dhe jashtë qendrës së qytetit të Vlorës, në fshatrat përkatëse të kësaj bashkie. Këto zona të cilat mbartin një rëndësi të veçantë për vetë rrethin e Vlorës, duke marrë parasysh të gjitha vlerat dhe historikun e tyre, janë shpallur zona të mbrojtura. Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat historike dhe ato natyrore. Në veçanti:

- Zonat e mbrojtura historike dhe kulturore janë rregulluar në bazë të rregulloreve specifike: Monumentet e trashëgimisë kulturore me vlerë të jashtëzakonshme rregullohen me anë të një zonimi të veçantë hapësinor dhe udhëzimesh shoqëruese, të nxjerra sipas Ligjit 9048/2003. Zona tampon e ruajtjes së peisazhit prej 250 m, është për të siguruar ekzistencën e monumenteve të regjistruara si të tilla, duke iu referuar ligjit 9048/2003.

Në qendër të Vlorës janë shpallur monumente kulture të ndryshme. Duke filluar me Ansamblin Historik përgjatë qendrës së Vlorës, me objektet e kultit, fortifikimet e banesat tradicionale Xhamia e Muradies mbetet një nga monumentet kulturore më të vecanta në Shqipëri.

Një kategori tjetër janë banesat tradicionale të cilat kanë vlera estetike të mëdha duke shpalosur artin e ndërtimit tradicional.

Monumentet e kulturës janë prezente dhe në fshatra të ndryshëm të Bashkisë së Vlorës. Disa nga këto fshatra janë shpallur zona të mbrojtura duke marrë parasysh vlerat që ato mbartin, si dhe disa të tjera duhet të konsiderohen si mundësi për tu mbrojtur. Në territorin e këtyre fshatrave ndodhen ndërtime të cilat janë shpallur monumente kulture. Të ezauruara janë dy fshatra, bashkë me monumentet përkatëse të tyre.

Zona të mbrojtura janë :

- Zvërneci,
- Manastiri i Zverneçit,
- Kisha e Manastirit të Zvërnecit

Monumentet e mbrojtura kulturore ndodhen brenda zonave të mbrojtura Zvërnec, të cilat janë përqendruar brenda ishullit si një tërësi zone e mbrojtur, ku spikat natyra e gjelbër, ndërtimet në brëndësi, si dhe qasja e këtij ishulli me ujë. Zverneci ka një monument të rëndësishëm historik dhe kulturor si Manastirin e Zvernecit.

Një kategori tjetër janë vendbanimet e lashta që janë shfaqur në qendrat e fortifikuara të gjirit të Vlorës. Në njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së Vlorës janë të shpallura monumente kultura: objekte të ndryshme kulti, banesa tradicionale, ndërtime inxhinierike, qytete antike të cilat i përkasin periudhave të ndryshme historike. Ato mbartin në vete vlera të mëdha estetike, historike dhe kulturore. Të ezauruara janë tre objekte kulti, xhami, kishë, teqë.



**Figura 4 Harta e shpërndarjes së Monumenteve të kulturës në Vlorë**

*Burimi: Bashkia Vlore*

### **Zonat e mbrojtura natyrore**

Në territorin e Vlorës ndodhen dy zona të rëndësishme kombëtare të mbrojtura: Peisazhi i mbrojtur i sistemit ligator i Vjosë-Nartës dhe Parku Kombëtar i Karaburun-Llogarasë (Llogara-Rrëza e malit-Dukat- Orikum- Tragjas- Karaburun-Radhimë). Për çdo zonë ekziston një plan Menaxhimi.

Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, duhet të përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji; kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen

nga Ligji 8093/1996. Në veçanti laguna e Nartës, e caktuar si peizazh i mbrojtur sipas klasifikimit të L.8906/2002, është e rregulluar edhe me VKM Nr.680 22.10.2004 e cila jep kufizimet mjedisore për zonimin.

Pjesa tokësore e zonave të mbrojtura rregullohet me VKM Nr. 680 e 22.10.2004 “Për shpalljen e sistemit ligatinor Vjosë-Nartë "Peisazh Ujor/Tokesor i Mbrojtur”. Sistemi ligatinor realizon një ndarje të zonës mjedisore në 4 kategori të mbrojtura: (A, B, C, D) me nën-ndarjet (A1, A2, B1, B2). Në secilën kategori, veprimtaritë e lejuara dhe ato që nuk plotësojnë kriteret janë të përcaktuara në skemen e menaxhimit të paraqitur në VKM. Duke folur në përgjithësi kategoritë A përfaqësojnë zonën qendrore të ruajtjes së biodiversitetit, ku lejohen kryesisht vetëm aktivitete të vogla çlodhjeje, kategoritë B i referohen tokave bujqësore tradicionale, kategoritë C përfshijnë llojet e vendbanimeve, por përjashtojnë zhvillimin e veprimtarive me ndikim të madh mjedisor dhe D përfaqësojnë zonat e zhvillimit të turizmit.

Si zona kryesore janë përcaktuar territoret bregdetare të Adriatikut nga Narta deri në Vjosë, mali i Llogarasë dhe një pjesë të Karaburunit dhe Pasha Limanit. Zona të gjera me vendbanime përkatësisht në kodrat e Panajasë, fshatrat e Novoselës dhe luginës së Orikumit janë përcaktuar si zona e zhvillimit të qëndrueshëm, ku vendbanimet ekzistuese mund të zgjerohen. Në total përcaktohen katër zona të zhvillimit turistik, fshati Zvërnec, Rradhime, bregdeti i gadishullit të Karaburunit përballë Vlorës dhe Dukati i Ri. Mes Llogarasë dhe Karaburunit është rezervuar një zonë të vogël, ku turizmi është i lejuar. Ish zone Ushtrake e Karaburunit në fund të gjirit është përcaktuar si zonë urbane, për urbanizimin. Pjesa detare e zonave të mbrojtura rregullohet me Vendim nr. 289, datë 28.04.2010 “Përshpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror detar pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit”. Plani i Menaxhimit i aprovuar së fundmi përmban një propozim të zonimit për pjesën detare dhe ishullin e Sazanit ku dallohen katër kategori të mbrojtjes: zona qendrore (e mbrojtjes absolute); zona e menaxhimit efektiv; zona çlodhjeje; dhe zona e zhvillimit të qëndrueshëm (*kategoria N2,N3*)

### **Konsiderata Mjedisore**


Një parim themelor për zonimin e përdorimit të tokës është zbutja e rreziqeve mjedisore dhe faktorët që kanë një ndikim negativ në cilësinë e jetës së banorëve dhe të shëndetit publik, si edhe të cilësisë së burimeve në zone. Rekomandimet e mëposhtme janë bërë sipas parimeve të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore bregdetare, të cilat janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit duke iu referuar Planit të Menaxhimit:

- Cilësia e ujit të bregdetit duhet të mbrohet nëpërmjet kufizimeve të rrepta ndaj zhvillimit në zonat ekologjikisht të ndjeshme (së bashku me zonat e larta me vlera të konsiderueshme të peisazhit, si dhe plazhet) ndër të tjera, i) ndërtimi i infrastrukturës për trajtimin e ujërave

të zeza në varësi të dendësisë, dhe ii) zbatimin e rregulloreve të tilla, që kërkohen për të siguruar lidhjen me sistemet qendrore, ashtu edhe mirëmbajtjen e sistemeve individuale.

- Rekomandimet e mësipërme zbatohen gjithashtu ndaj ujit bregdetar të lagunes. Në mënyrë që të reduktohet eutrofikimi dhe ndotja, është e nevojshme gjithashtu për të rritur rrjedhjen e ujit të embel duke përmirësuar kanalet e komunikimit me detin.
- Sisteme efikente të largimit të mbetjeve të ngurta, duhet të jenë funksionale (rregulloret, mbledhja, grumbullimi, transportimi dhe hedhja e tyre), si një parakusht për çdo zhvillim bregdetar.
- Shndërrimi i tokës ekonomike produktive për përdorime urbane duhet të minimizohet (të tilla si toka bujqësore, pemëtari dhe pyjet, etj), për të ruajtur vlerën e aseteve turistike (peisazhin kulturor dhe vlerat e tij si burim turizmi) si potencial për të diversifikuar ekonominë lokale.
- Masat e veçanta janë të nevojshme për të menaxhuar bregdetin e brendshëm të lagunes dhe ripërdorimin e tokës së kripur nëpërmjet: i) riparimit dhe riaktivizimit të sistemeve bregdetare të kullimit me qëllim për të parandaluar kripesimin e mëtejshëm të tokës ii) zbatimin e politikave të rehabilitimit të tokës dhe të natyrës dhe përmirësimit të peizazhit në zonat e prekura.
- Zhvillimi duhet të kufizohet ose të ndalohe në zona, të cilat janë të rrezikshme për shkak të gjeologjisë, gjeomorfologjisë apo përmbajtjeve.
- Disa përdorime ekonomike, kryesisht materiale inerte, magazina dhe aktivitetet e blektorisë (dhe disa objekte të infrastrukturës, si antenat) duhet të jenë të ndara nga zonat e banuara, objekteve publike, të cilat shoqërohen me grumbullime publike dhe tregti. Prandaj zonat ekonomike duhet të dallohen në bazë të efekteve të jashtme mjedisore.
- Gjendja e dobët e infrastrukturës rrugore edhe për emergjencat, në pjesën e vjetër të fshatit Zverec. Ndërsa, në pjesën e re të fshatit, në pjesën perendimore, infrastruktura është re dhe mjaft e mirë.
- Gjendje shumë e dobët për sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza. Ato nuk ekzistojnë në këtë fshat, por janë të gjitha të shpërndara në terrene të lirë, pranë kanaleve, rezervuareve apo dhe në vetë baçeve të shtëpive, apo gropa septike.





Harta 7- Harta e zonave e objekteve historike të propozuar

## 1.6 Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban

Zonat ekonomike janë të përqëndruara në qytettine Vlorës dhe rreth tij. Territori i Bashkisë Vlorë ka mundësi dhe potenciale të jashtëzakonshme në drejtim të zhvillimit ekonomik, në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Bregdeti jugor i Shqipërisë nga Adriatiku në Jon është një burim i madh ekonomik dhe mjedisor që ka vendi, për përdorimin në menyre strategjike dhe promovimin e zhvillimit ekonomik, por në përputhje me parimet e qendrueshmerisë.

Drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik janë:

1. Zona e petroliferes dhe strategjite energjitike.
2. Zona industrialo ekonomike
3. Porti i Vlorës
4. Zhvillimi i turizmit

Këto janë zona me karakter tipik turistik por edhe të orientuara drejt prodhimeve lokale bujqësore. Niveli relativisht i lartë i prodhimeve bujqësore (kryesisht në frutikulture) ka sjellë nevojën e ngritjes së punishteve apo edhe fabrikave të përpunimit. Në këto njësi administrative janë ngritur disa fabrika të përpunimit të ullirit, prodhimit të vajit të ullirit, fabrika e prodhimit të lengjeve të frutave e cila edhe pse tani për tani punon me lëndë të parë të importuar, është një garanci për mbështetjen e zgjerimit të prodhimit të frutikulturës. Po ashtu mund të përmendim shumë aktivitete prodhuese edhe të karakterit artizanal për prodhimin e lengjeve freskues të cilat kanë perspektiven të kthehen në aktivitete të mirefillta industriale. Përpunimi i rrushit për prodhim e verës dhe rakisë ngelet ende në fazë artizanale dhe familjare. Në funksion të rritjes së prodhimit bujqësor dhe në mbështetje të tij, janë hedhur hapa në zhvillimin e agro-industrisë. Industria e përpunimit të produkteve bujqësore perfaqesohet nga fabrika të prodhimit të vajit të ullirit, ku deri tani janë tre të tilla, me teknologji dhe tregues bashkekohore.


### **Zona Ekonomike**

Në kontekstin rajonal, pozicioni gjeografik i Bashkisë Vlorë merr një rëndësi të veçantë në raport me rrugët e transportit ndërkombëtar dhe të tranzitimit të naftës dhe gazit nepermjet projekti AMBO. Në territorin e Bashkisë ndodhet pika fundore e Korridorit të VIII-te, e cila vlerësohet si një nga daljet më të rëndësishme të burimeve lindore të naftës dhe gazit për furnizimin e Evropës dhe të vendit.

Bashkia Vlorë është faktor i rëndësishëm zhvillimi në rajonin ekonomik të gjirit të Vlorës. Në territorin e kësaj Bashkie po përqendrohen burime të rëndësishme të prodhimit të energjisë. Aktualisht është instaluar një TEC me fuqi të instaluar 90 MGW i cili do të balancojë prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë në pjesën jugore të vendit përfshirë gjithë rajonin e bashkisë. Zhvillimi i turizmit është ndër burimet më të rëndësishme për

zhvillimin ekonomik të rajonit. Në vizionin afatgjatë, qarku Vlorë do të ketë krijuar bazat për një turizëm energjik dhe të integruar me mirë përdorimin e burimeve të pasurive të rajonit, që gjeneron të ardhura, krijon punë, ofron zgjedhje dhe që njerezit të jetojnë me mirë, krahas ruatjes së vlerave të vecanta të mjedisit dhe historisë.

Vendndodhja e zonës ekonomike në Bashkinë Vlorë karakterizohet nga akses shumë i mirë pasi ajo është e vendosur në zonën e zhvilluar bregdetare të jugut të Shqipërisë, në afërsi të akseve kryesore të transportit dhe infrastrukturës kombëtare dhe në afërsi të qytetit të Vlorës, i cili është qyteti i tretë më i madh i vendit pas Tiranës dhe Durrësi, dhe është porti i dytë tregtar dhe turistik si dhe një shtyllë kryesore për atraksionin e vizitorëve në muajt e verës. Qyteti dhe porti i saj mundësojnë zhvillimin e të gjitha llojeve të sistemit të transportit - rrugorë, detarë, hekurudhorë dhe transporti ajror indirekte pasi zona është e vendosur jo më shumë se 140 km nga Tirana. Zhvillimi i zonës ekonomike si dhe shërbimeve të transportit logjistik është reflektuar edhe në numrin e bizneseve të transportit dhe është vizion i të ardhmes si dhe do të shërbejë për të mbështetur aktivitetet ekonomike lokale që mund të përfitojnë nga kjo afërsi, si treg për prodhimet vendore, dhe ofrues të shërbimeve të ndryshme. Prodhimet vendore si vaj ulliri, verë, fruta të thata etj, prodhime blegtorale dhe nënproduktet e tyre bio.



Harta 8-Zonat, polet, korridoret ekonomik të propozuar

## 1.7 Tipologjitë e propozuara hapësinore dhe metodat e ndërhyrjes në territor

Në fazën e analizës territoriale janë identifikuar tipologjitë e zonave urbane për Bashkinë Vlorë sipas situatës ekzistuese të zhvillimit. Kjo analizë është ndërmarrë për të gjithë sistemin urban për të gjitha bashkitë .

Për qytetin e Vlorës analiza e tipologjive ka ndjekur faza të ndryshe të zhvillimit historik të qytetit, të cilat i korrespondojnë shtresave të ndryshme të trashëgimisë arkitekturore, kryesisht që nga periudha para viteve 1990 janë identifikuar tipe si mëposhtë:

**PB1: Përdorimi Banim Qendra Historike e Vlorës.** Qytet otoman i shekullit të XIX. Qendra e qytetit karakterizohet nga arkitekturë civile e mesit të luftës gjatë periudhës së pushtimit italian. Lejohen vetëm ndërhyrjet e rehabilitimit të stokut të ndërtesave historike për ripërdorim, rikualifikimit të hapësirave publike, përmirësimit të infrastrukturës dhe përdorime tregtare për rivitalizimin ekonomik.

Ndërtimi sipas VKM nr.729 dt. 01.09.2010 “Për shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Vlorës dhe miratimin e rregullores së administrimit”

**PB2: Përdorimi Banim miks, në qendren e qytetit.** Pas vitit 1945 plani i qytetit për zgjerim gjatë periudhës së komunizmit me ndërtimet e vjetra dhe të reja u shtrih nga qendra historike deri në bregdet. Karakterizohet nga blloqe banimi me densitet të lartë dhe të mesëm në të lartë. Përdorim miks i tokës dhe funksione në nivel qyteti. Lejohen ndërhyrjet e rigjenerimit urban, ripërtëritje dhe modernizim i stokut të ndërtesave duke ruajtur nivelet ekzistuese të densitetit. Kufizimi i lartësisë ndërtimit të lejuar është deri në 6 kate. Ripërtëritje e infrastrukturës sociale dhe urbane.

**PB3: Përdorimi Banim miks, në balinën ujore urbane.** Zgjerim urban në pjesën jugore përgjatë bregdetit pas vitit 1990. Blloqe banimi me rritje të lartë përgjatë bregdetit. Përdorimi miks i tokës me shtëpi të para, të dyta dhe turistike. Funksione rekreative në katin përdhe. Kufizime për ndërtimet e reja për të përmirësuar qarkullimin e automjeteve duke krijuar hapësira parkimi. Aplikimi i instrumenteve të detyrueshme për blerjen e tokës për rrugë dytësore dhe hapësirë publike duke ruajtur nivelet ekzistuese të densitetit. Ripërtëritje e infrastrukturës sociale dhe urbane.

**PB4: Rizhvillimi i zonave industriale të braktisura.** Tokë vakante dhe/ose objekte të braktisura në pronësi shtetërore ose private. Aktivitete me karakter ekonomik, shërbime tregtare ose përdorim miks i tokës.

**PB5: Përdorimi Banim dendesi e lartë në zonën urbane.** Blloqe banimi me densitet të lartë të vendosura brenda zonës urbane të qytetit të Vlorës, të vjetra dhe ndërtime të reja. Përdorimi i tokës kryesisht banim me disa shërbime dhe biznese. Përmirësimi i stokut ekzistues të ndërtimeve duke ruajtur nivelet ekzistuese të densitetit, duke kufizuar lartësinë e lejuar të ndërtimit deri në 5 kate dhe duke ripërtërirë infrastrukturën sociale dhe urbane.

**PB6: Përdorimi Banim urban dendësia e ulët në zonën fushore.** Shtëpi të shkëputura me densitet të ulët të vendosura brenda zonës urbane të qytetit të Vlorës, kryesisht duke iu referuar zonave informale të ndërtuara pas vitit 1990 në periferi të zonës kryesore urbane. Përdorimi i tokës kryesisht banim me disa shërbime dhe biznese. Konsolidim i zhvillimit urban, ristrukturim i rrjetit rrugor nëpërmjet planifikimit të detajuar, duke krijuar infrastrukturë sociale dhe urbane që mungon. Lartësia e lejuar e ndërtimit është 3-4 kate.


**PB7: Përdorimi Banim urban dendësi e ulët në zonën kodrinore.** Vila të shkëputura me densitet të ulët të vendosura në shpatin kodrinor në zonën urbane dhe periurbane të Vlorës, kryesisht duke iu referuar zonave informale të ndërtuara pas vitit 1990 në periferi të zonës kryesore urbane përgjatë bregdetit të detit Jon. Ka mungesë të shërbimeve dhe nivel i dobët i infrastrukturës. Përdorimi i tokës kryesisht banim për shtëpi të para dhe të dyta me disa shërbime. Konsolidim i zhvillimit urban në zona të caktuara, strukturimin i rrjetit rrugor dytësor përmes planifikimit të detajuar dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale dhe urbane. Lartësia e lejuar e ndërtimit është 2-3 kate.

**PB8: Shtëpi të dyta vila dhe turizëm.** Zona me densitet të ulët për shtëpi të dyta të ndërtuara pas vitit 1990, të vendosura përgjatë bregdetit të Jonian në tokë të pjerrët me pamje nga deti. Ndërtimet e reja ekzistuese dhe të propozuara do t'i nënshtrohen zonimit të PPV. Funkcioni i shtëpive të dyta do të jetë në kombinim me njësitë e turizmit. Konsolidim i zhvillimit urban në zona të caktuara dhe racionalizim i rrjetit rrugor nëpërmjet planifikimit të detajuar duke siguruar standardet e cilësisë për mbrojtjen e peizazhit. Lartësia e lejuar e ndërtimit është 2-3 kate për vila, dhe 5 kate për hotele.

**PB9: Përdorimi Banim në vendbanimet rurale fushore.** Zona me densitet të ulët për shtëpi banimi. Përdorimi kryesor i tokës është banim rural me disa shërbime dhe funksione agroekonomike. Mbushja e zonave të pandërtuara me ndërtime të reja, duke respektuar rregullat e ndërtimit dhe strukturimin të rrjetit rrugor dytësor. Lartësia e lejuar e ndërtimit është 1-3 kate.

**PB10: Përdorimi Banim në vendbanimet rurale kodrinore-malore.** Shtëpi të shkëputura me densitet të ulët të përshtatura në morfologjinë e relievit. Përdorimi kryesor i tokës është banim rural me disa shërbime dhe funksione agroekonomike. Mbushja e zonave të

pandërtuara me ndërtimet e reja, duke respektuar rregullat e ndërtimit dhe strukturimin të rrjetit rrugor dytësor. Lartësia e lejuar e ndërtimit është 2 kate me çati.



Harta 9-Harta e tipologjisë së ndërtimeve



**Dendësim/Mbushje urbane e tokës: Kodi [DENDES]** – Ky është procesi i densifikimit të një njësie të sistemit urban pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të të njëjtit karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet. Kjo mënyrë ndërhyrjeje synon përdorimin e sa më eficient të tokës truall si dhe rrjeteve të infrastrukturave publike.

Ky lloj ndërhyrjeje vlen vetëm për zonat urbane ekzistuese dhe duke iu referuar zonave relativisht të vogla të tokës vakante në mes të territoreve të urbanizuara ose pjesërisht të urbanizuara. Ata zakonisht nuk kërkojnë një PDV.

Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizotërojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësitimit. Kjo lloj ndërhyrjeje nuk ndryshon në asnjë rast karakterin dhe tipologjinë e ndërtimit. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

Për Bashkinë e Vlorës kjo lloj ndërhyrjeje i referohet tipeve të ndërhyrjeve si mëposhtë:

- Tokë e lirë Brenda qytetit të Vlorës (A3) dhe ish zonat industrial (IE).
- Zona të pambushura me ndërtime përgjatë Rivierës së bregdetit të Vlorës me shërbime(S2) dhe shtëpitë e dyta(A5)

**Konservimi Urban Historik / Konservimi Natyror: Kodi: [KONSERV]-** është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar, në formën e tij ekzistuese origjinale. Konservimi është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga Bashkia apo çdo person juridik ose fizik, të cilat synojnë ruajtjen e një përdorimi, strukture dhe territori urban, të veshur me vlera ekonomike, sociale, historike e kulturore dhe mjedisore në kohë, dhe të raporteve që ajo krijon me mjedisin natyror apo të ndërtuar që e rrethon, për të realizuar zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi. Konservimi ka dy aplikime të ndryshme duke ju referuar urbanizimit dhe territorit natyror.

Konservimi urban nënkupton ruajtjen e karakterit, tipologjive dhe përdorimit ekzistues të zonave të caktuara të qytetit dhe fshtrave. Shkalla e ndërhyrjeve në lidhje me rritjen e intensitetit dhe strukturat e ndërtimit është minimale, ndaj treguesit e propozuar përputhen ose janë përafërsisht të barabartë me ato të gjendjes ekzistuese. qytet dhe qendrat e fshtrave ndërhyrjet nënkuptojnë rehabilitimin e infrastrukturave, shërbimeve publike, banesave, elementëve të dizajnit urban. Këto ndërhyrje aplikohen në zonat e komplekseve të banimit me koncepte hapësinore të qarta të ndërtuara para viteve '90.

Për Bashkinë e Vlorës Konservimi Urban i referohet:

- Zonave arkeologjike A,B.(M1,M2)/ qendra Historike të Vlorës(A1)
- Zona qendrore të vendbanimeve tradicionale të Nartës dhe Kaninës(A1)

- Trashëgimia e monumenteve të kulturorës.(M3)

Konservimi Natyror i referohet territoreve brenda Sistemit Natyror dhe sistemit të ujit, të cilat formojnë burime të vlefshme natyrore të bashkisë që meritojnë të jenë të mbrojtura nga zhvillimi. Janë të përfshira në këtë kategori kombëtare zona të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi (N1, N2, N3 dhe U1, U3, U4) dhe zonat e mbrojtura të propozuaranga PPV duke ju referuar kategorive të zonimit(N5, N6)

Koncepti i Konservimit është aplikuar edhe në zona të tjera të cilat nuk i përkasin sistemit natyror dhe ujor, por janë të mbrojtura nga zhvillimi me anë të zonimit të tyre të caktuar nga PPV, përkatësisht:

- toka bujqësore e kategorive (B1, B2) nën Konservimi Bujqësor me kuptimin e mbrojtjes së përdorimit të tokës për qëllime bujqësore.
- Sipërfaqet e gjelbra dhe hapësirat publike, pyjet përreth janë kthyer streha (AR3, AR4)

Në Vlorë fushat kryesore të destinuar për Konservimin Natyror janë:

- Peisazhi Kombëtar i mbrojtur Vjosa, Nartës;
- Parku Kombëtar i Llogarasë, Karaburun;
- Parku Detar i Karaburunit, Sazan;
- Shpatet malore në zonat bregdetare të Bashkisë
- Zonat e trupave ujorë tampon;
- Plazhet me rërë (N8) dhe pjesët natyrore të bregdetit;
- Pylli periurbane i sodës, Kuz Baba dhe parqet kryesore të qytetit dhe hapësirave publike;
- Zonat e Peisazheve të mbrojtura.

**Ristrukturim,Kodi: [RISTRUK]** është një veprim në procesin e planifikimit, i cili ka për qëllim të rivlerësojë infrastrukturën e shërbimeve në zonë/njësi dhe të hapësirave publike duke përfshirë edhe punime në strukturat ekzistuese, të cilat nuk ndryshojnë planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin me ato ekzistuese në njësi.

Koncepti i Ristrukturimit i referohet përmirësimit të kushteve në pjesë të zhvilluar tashmë në zonave urbane kryesisht në pjesët qendrore, të cilat kanë ndërtime të dendura dhe të banuara, por paraqesin probleme funksionale që lidhen me qarkullimin e automjeteve dhe mungese të hapësirave të parkimit, degradimi të ndërtimit eksistues, që kanë nevojë për njëinfrastrukturë të re urbane dhe probleme të tjera. Pra, ristrukturimi i referohet si përmirësimit të hapësirave publike, qarkullimit, infrastrukturës sociale dhe stimujve për rinovimin e ndërtimit të vjetër ndërtimit..

Në Vlorë zonat kryesore të destinuar për Ristrukturimi janë:

- shumica e zonave brenda zonës qendrore urbane të Vlorës (A1), (A2), (A3)

**Konsolidim Urban Kodi: [KONSOL]**– është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Konsolidimi Urban korrespondon me kuptimin e zhvillimit kompakt urban. Kjo do të thotë zhvillimin e zonave të urbanizuara me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe shfrytëzimin eficient të infrastrukturave publike. Prosesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të densitetit si në nivel zone ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave, dhe ndërtimi i infrastrukturave të shërbimit. Nënkuptohe gjithashtu rikualifikimin dhe përforcimin e strukturës urbane të atyre zonave të cilat kanë një skelet hapësinor, ose fillesa të tij të mirëpërcaktuara, por për arsye të ndryshme në zona kanë ndodhur shumë ndryshime.

- Konsolidim Urban vlen për pjesën më të madhe të zonave ekzistuese urbane të qyteteve shqiptare duke iu referuar kryesisht zhvillimit pas viteve 1990 përmes proceseve të ndërtimit informal apo të zhvillimit me densitet të ulët shpërndarës që të çon në përdorimin jo efikas të tokës.

- Një (përkufizim) kuptim i dytë i konsolidimit Urban i referohet përqendrimit të aktiviteteve ekonomike në zona të specializuara për komunitet të caktuar nëpërmjet planit. Duke pasur parasysh se aktivitetet ekonomike kanë ndjekur si model një zgjerim zhvillimi të ngjashëm dhe zhvillim spontan, ekziston nevoja për përqendrimin e tyre në mënyrë që mund të minimizohet ndikimi negativ për përdorime të tjera dhe për të rritur efektin e mundshëm pozitiv në klaster.

Për Bashkinë e Vlorës fushat kryesore të destinuar për Konsolidim Urban janë:

- të gjitha zonat e vendbanimeve rurale banim (e A4)
- zonat urbane informale, banim (A4)
- Zonat shtëpitë e dyta (A5)
- Zonat e organizuara / te perfituesve te aktiviteteve ekonomike (IE1,2,3)

**Rigjenerim/Rikualifikimi: Kodi [RIGJEN]** Nënkuptohe ringjallja, rikthimi i funksioneve të mëparshme, ose rehabilitimi, rikthimi i vetive natyrore peisazhistike i zonave të degraduara të cilat në gjendjen aktuale e kanë humbur atë. Shkalla e ndërhyrjeve në këto zona varion që ngandërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemimet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet peisazhistike për të rritur vlerat estetike të qytetit dhe fshtrave. Rikualifikimi ekonomik zbatohet në zona ekonomike të cilat kanë degraduar por nga pozicioni i tyre në qytet, mbeten përsëri të rëndësishme për të funksionuar si të tilla. Rikualifikimi ambjental peisazhistik zbatohet në territore të lira të cilat për efekte ambientale apo peisazhistike propozohen të kthehen në breza të gjelbër sanitar dhe rekreativ.

Koncepti i rikualifikimit i referohet kontekstit të sistemeve natyrore dhe bujqësore.

- Rikualifikimi në sistemin urban synon të realizojë përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke u fokusuar kryesisht në hapësirat dhe burimet publike;
- Rikualifikimi në sistemin natyror i referohet konceptit të rehabilitimit tepeisazhit dhe natyrës në rastet e zonave me dëmtime mjedisore ose zona të degraduara;
- Rikualifikimi në sistemin e bujqësisë i referohet rastit të tokës së papunuar si dhe tokes pa frut;

Për Bashkinë e Vlorës fushat kryesore të destinuara për Rigjenerim/ Rikualifikim janë:

- Akupunture Urbane (AR3, AR4), në qendrën historike të Vlorës (Sheshi Flamurit- Monumenti Dëshmorëve - Bulevardi, stacioni Hekurudhor qendror dhe stacioni autobusëve)

- Toka bujqësore të kripëzuara- Laguna Nartes / Pasha Limanit (B6)
- Zonat e rigjenerimit natyror (N2, N3, N6) - Laguna Nartes/ Pylli i Sodes/ Kuz

Baba

- Agroturizëm dhe zonat e ekoturizmit të caktuara (B5, N4)

**Rizhvillim: Kodi [RIZHVIL]-** është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një zonë, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore. Rizhvillimi është një veprim në procesin e planifikimit, në njësitë me dendësi të mesme deri të lartë banimi dhe përdorimi, i cili ka për qëllim të rivlerësojë treguesit e zhvillimit të njësisë. Ajo kryhet në zona të zhvilluara më parë, duke ndryshuar tërësisht strukturën e ndërtimeve ekzistuese, funksionet e tyre dhe/ose treguesit e zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp). Zonat e dedikuara për rizhvillim janë gjithmonë subjekt i PDV-së.

Për Bashkinë e Vlorës fushat kryesore të destinuara për Rizhvillim janë:

Ish zonat industriale (Broënfields) brenda qytetit të Vlores, Soda dhe fabrika e braktisur e Llampave (IE1).

Zona trekëndësh prapa Lungomare (Pelivan Leskaj-Zenel Murra-Rruga Cameria-Murat Terbaci) (A3)

**Rikonceptimi, Kodi: [RICONC]-** Nënkupton ndryshimin nga pikëpamja e kompozimit hapësinor ose funksional ose të të dyjave bashkë, që zbatohet në zona strategjike të qytetit dhe përgjatë rrugëve kryesore, si pjesë e fashave strukturore. Nëpërmjet kësaj tipologjie rritet intensiteti i zhvillimit në “pika” ose “korridore strategjike” të qytetit. Gjithashtu rikonceptimi i nënshtrohen edhe territoret të cilat propozohen të kthehen nga territore të ndërtuara në territore të pandërtuara, si dhe territore të lira ose pjesërisht të lira kur funksioni i tyre ndryshon ose krijohet nga e para, p.sh. krijimi i parqeve periferike apo funksione të tjera.


**Për Bashkinë Vlorë zonat kryesore që janë projektuar për Rikonceptim**

- Rikonceptim i Lungomares Vlorë
- Rruge turistike në Rivierën e Vlorës;
- Parku ri i propozuar “Femijëte e Lumtur” në ishfaqen e aviacionit Vlorë.(AR3)  
Propozimi për rimodelimin e Pallatit të Kulturës në zonën mbrapa Portit(AR1)  
Propozim për ripërteritje urbane në qendrën historike (krijimi i rruges për artistet Justin Gordan dhe Merkata tradicionale si dhe Sahati)  
Rikrijimi i lagunës me uje në fshatin Nartë me ishujt artificial(projekti pilot i propozuar nga plani). Zona të propozuara me interes për zhvillimin e turizmit(S5), (N4), (B5)

Tipologjia Hapësinore Vlorë:

1. SH.B:Shërbime Bregdetare
2. Z.B.GJ:Zona Bregdetare e Gjelber
3. B.B.B. Blloqe Banimi të lartë Bregdetare (8-10kate)
4. T.B Turizem Bregdetar (2-4 kate)
5. T.B.ZH. Turizem bregdetar në Zhvillim (2-4 kate)
- 6.V. B. Vila Bregdetare (2-3 kate)
7. B.B.L. Ballina Ujore/ Blloqe Banimi të Lartë(8-10 kate)
8. Z.B.SH.I. Zona Banimi e Shkeputur Informale (2-3 kate)
9. Z.P.D. Zona e ngritur me pamje nga Deti
10. B. ZH.E. Blloqe banimi të zhvilluara në zonat Ekonomike(8-10 kate)
11. B. B.ZH. Blloqe të lartë Banimi në Zhvillim (6-10 kate)
12. B.SHK.F. Banim i shkeputur në fshat (1-3 fshat)
13. Z.GJ.P.Zona e gjelbert/Hapësira Publike
14. B.B.P. Blloqe të Lartë Banimi me Përdorim të Përzier(6-10 kate)
15. Z. B.F.K.Zona e Banuar Fshat Kodrinor(2-3 kate)
16. V.B.K Vila bregdetare kodrinore (2-3 kate)
17. Z.B.K.I. Zona banimi Kodrinore informale(2-4 kate)
18. Q.H. Qendër Historike (2-4 kate)
19. Z.B.H. Zona Bufferike e Qendres Historike(2-4kate)
20. A.E.I. Aktivitete ekonomike Industriale (1-2 kate)
21. I. Institucione (2-4 kate)
22. Z.GJ.Inst. Zonat e Gjelberta Institucionale
23. Q.L. Qendra Lokale
24. Z.B.F.M. Zona e banuar Fshat Malor(2-3 kate)
- 25.Q.L.F. Qendra Lokale e Fshatrave(2-3 kate)
- 26.B.R.B. Blloqe rezidenciale banimi(3-5 kate)
- 27.B.B.L.Blloqe Banimi Linear(3-4 kate)
- 28.B.S.P. Banim Social për Pushim(4-5 kate)

- 29.Z.T.F. Zona tradicionale e Fshatit (1-3 kate)
- 30.V.P.D. Vila me Pamje nga Deti(2-3 kate)
- 31. F.S. Fushe Sporti
- 32.T.Z.Toke e zbrazet(e braktisur/ e paperdorur)




Harta 10-Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar

## 1.8 Përcaktimi i njësive që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-ve sipas ligjit

Zonat dhe njësitë strukturore, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-ve janë të përcaktuara sipas tipologjive kryesore të zonave si edhe mbi bazën e detyrime ligjore për ato njësi që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së. Klasifikimet e njësive vijnë si më poshtë:

- a. Zonat e propozuara për format e organizuara të investimeve turistike (resorte-vila). Nënkatëgoritë S3 (ose/dhe S2).
- b. Zonat e zgjerimeve rezidenciale me sipërfaqe më shumë se 5 ha, sidomos në zonat bregdetare turistike. Nënkatëgoritë A4, A5.
- c. Zonat e propozuara të aktiviteteve të organizuara ekonomike me sipërfaqe më shumë se 5 ha ose me ndikim të mesëm ambjental. Nënkatëgoritë IE1-4.
- d. Zonat me prioritet zhvillimi, të projektuara nëpërmjet zonimeve të PPV për rihvillim, ristrukturim ose rikonceptim.
- e. Zonat e ndërtimeve informale.  
Tipologjitë kryesore të zonave, ku nuk ka detyrim për hartim të PDV janë:
  - a. Qendrat historike të qytetit dhe qendrat e vendbanimeve tradicionale, ku leja e zhvillimit është shqyrtuar rast pas rasti sipas kriterëve morfologjike. Nënkatëgoritë A1, M1, M2.
  - b. Zonat ekzistuese urbanistike të qyteteve (të periudhës së pas luftës), ku është zbatuar më parë një plan rregullator dhe ku ekziston një rrjet rrugësh dhe vija ndërtimi. Nënkatëgoritë A2, A3, A4.
  - c. Qendrat ekzistuese të vendbanimeve rurale (të periudhës së pas luftës), duke përfshirë zgjerimet e vogla deri në 25% e që nuk ndodhen në zonën bregdetare, duke ju referuar kryesisht vendbanimeve primare të popullsisë lokale. Nënkatëgoritë A3, A4.
  - d. Zona për përdorim publik, për përdorime të vecanta dhe infrastrukturë. Kategoritë SH, AS, IS, ZU, IN, V.





Harta 11-Zonat me prioritet zhvillimi dhe zonat subject i PDV

## 1.9 Shpërndarja e popullsisë dhe parashikimet demografike

Bazuar në Rregulloren e Planifikimit të Territorit, Neni 81 pika 2, përcakton se “Standardet e Planifikimit ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territore urbane dhe kategorizohen sipas rastit për grupe popullsie: a) deri ne 10,000 banorë, b) mbi 10,000 banorë”.

Në këtë kontekst, numri i banorëve, verifikimi i tyre, inventari sa me i saktë i nr. të popullsisë ose atyre personave që parashihet t’iu shërbejë, është kusht paraprak për çdo investim projekti dhe procesi vendimmarrjeje. Duke vlerësuar pasaktësitë për përcaktimin e numrit të saktë të popullatës në diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt të planifikimit të përdoret burimi i Gjendjes Civile, ndërsa për projektim të përdoren burime alternative informacioni me shkallë më të ulët gabimi.

Projeksioni i popullsisë për periudhën e ardhshme është një domosdoshmeri për planifikimin e zhvillimit social-ekonomik të Bashkisë. Në vijim, do të paraqitet projeksi i popullsisë për 15 vitet e ardhshme i bazuar në parametrat që parashikon INSTAT.

Sipas studimit të INSTAT, në nivel kombëtar, popullsia e Shqipërisë është përfshirë, në këto 25 vite, në lëvizje të brendshme dhe ndërkombëtare në shkallë të gjerë dhe gjithashtu është reduktuar në mënyrë të konsiderueshme numri i lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të rinjve, përshpejtuat ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vëhet re në pothuajse të gjitha bashkitë.

### *Projeksionet e popullsisë*


Projeksionet e popullsisë në Bashkinë Vlorë deri në vitin 2031, janë bazuar në metodologjinë dhe modelin e përdorur nga INSTAT-i mbi bazën e së cilës janë kryer parashikimet e popullsisë për gjithë Shqipërinë dhe në veçanëti për Qarqet. Në rastin konkret, projeksionet për Qarkun e Vlorës janë përdorur për të kryer projeksionet e popullsisë për Bashkinë Vlorë dhe njësitë administrative përbërëse të kësaj Bashkie.

**Tabela 5 Projeksionet e popullsisë 2011-2031 Bashkia Vlorë**

Njesia administrative	2011	2016	2021	2026	2031
Vlorë	79513	82598	83420	82807	<b>81859</b>
Orikum	5503	5717	5773	5731	<b>5665</b>
Qendër	7621	7917	7995	7937	<b>7846</b>
Novoselë	8209	8528	8612	8549	<b>8451</b>
Shushicë	3981	4135	4177	4146	<b>4098</b>

<b>Bashkia Vlorë</b>	104827	108894	109978	109170	<b>107920</b>
	<b>100</b>	<b>103.9</b>	<b>104.9</b>	<b>104.1</b>	<b>103.0</b>

Burimi: INSTAT 2011, vlerësimet e konsulentit



Grafiku i ProjekSIONeve të Popullsisë për Bashkinë Vlorë

Burimi: Punuar nga Ekspertët

Siç shihet në tabelën dhe figurën e mësipërme të bazuar në projeksionet e INSTAT-it, popullsia rezidente e Bashkisë Vlorë në vitin 2031 parashikohet të shkojë në 107,920 me një rritje prej vetëm 3% në krahasim me vitin bazë të marrë në këto projeksione 2011. Nivelin më të lartë të popullsisë Bashkia Vlore parashikohet ta arrijë në vitin 2021 me 109,978 banorë, me një rritje prej 4.9% më shumë se në vitin 2011. Rritja e popullsisë është një nga treguesit themelor të progresit të çdo shoqërie. Kjo pasi një rritje e qëndrueshme e saj jo vetëm flet për një popullsi të shëndetshme nga pikëpamja e moshës mesatare të saj dhe evitimit të tendencës së "plakjes" së popullsisë, por gjithashtu një rritje me baza të qëndrueshme krijonë premisa për përthithjen në tregun e punës të një numri më të madh të forcës punëtore në mënyrë që të garantohet një rritje e qëndrueshme ekonomike

## 1.10 Plani i strehimit social

Nisur nga regjistrimi i popullsisë për vitin 2011, Bashkia Vlorë ka në përbërjen e saj 29,953 familje, duke ju referuar kesaj shifre do të vleresojmë situatën aktuale të strehimit në Bashki si dhe shpërndarjen ndertimeve sipas njësive administrative. Tabela. 26 e cila i referohet statusit të banesave, vë në dukje një shifër prej 51,775 banesa të shpërndara nëpër të gjithë Bashkinë Vlorë

**Tabela 6 Statusi i banimit të banesës**

Gjithsej Total	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
<b>Bashkia</b>			
<b>Orikum</b>	4074	1581	1189
<b>Novosele</b>	3477	2333	156
<b>Qender</b>	3505	2120	326
<b>Shushice</b>	2099	1100	68
<b>Vlore</b>	38620	22351	5825
<b>Total</b>	51775	29485	7564

Burimi: INSTAT, Sipas Censurit 2011

Nga tabela vihet re se për njësinë bashkiake Orikum ka një shifër të lartë banesash të pabanuara si dhe banesash të përdorura për qëllime dytësore. Këto shifra evidentojnë, nga njëra anë faktin se, në këtë njësi administrative ka një largim të popullsisë, që ka çuar në abandonimin e banesave ekzistuese, si rezultat i emigrimit jashtë vendit, nga ana tjetër Orikumi karakterizohet dhe nga një vlerë e lartë e banesave të reja të ndertuara gjatë viteve 2000 të destinuara për qëllime dytësore të cilat përbëjnë 30% të totalit të banesave në këtë njësi. Këto dy rezultate evidentojnë një tendencë karakteristike zhvillimi në njesine administrative Orikum e cila po shndërrohet/orientohet gjithnjë e më shumë në drejtimin për qëllime turistike.

Klasifikimi i përdorur në tabelën. 34, sipas Census 2011, përfshin ndërtesat tradicionale dhe fillesat e stilit komunist deri në vitin 1960, periudhën e thellë të prodhimit komunist nga viti 1961 deri në 1990 dhe shtëpitë e reja në vitet 1991 deri në 2011. Siç vihet re nga tabela Vlorë ka një shtim të vazhdueshëm të numrit të ndërtimeve duke arritur kulmin përgjatë periudhës së viteve 1991-2000 ndërtime më

shifrën 6165 ndërtime. Në këtë periudhë Bashkia Vlorë rezulton me një vlerë me më shumë se 4500 banesa më shumë se në vitin 1960 që evidenton faktin e një fluksi të madh emigrator në këtë zonë gjatë periudhës së viteve 1991-2000. Periudha pas viteve 2000 karakterizohet kryheshisht nga një rënie në numrin e ndërtimit të banesave, me një evidencë më të madhe për qytetin e Vlorës, duke shënuar një rënie të fluksit migrator në qytet dhe në njësi të ndryshme administrative. Në Bashkinë Vlorë numërohen mbi 5,000 apartamente stok. Ndërsa, popullsia në nevojë në Bashinë e Vlores është mbi 1200 familje.

Procesi më i rëndësishëm në një Bashki, është përcaktimi i trojeve publike dhe regjistrimi i tyre në pronësi, për të pasur mundësinë për të aplikuar për kreditë ndryshme ose projekte që financojnë strehimin social sipas politikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale. Pronësia e truallit, është kusht i domosdoshëm për çdo vendimmarrje në lidhje me strehimin social. Forma të tjera të zhvillimit për strehimin social në të ardhën mund të perdoren instrumenta financiar si: marrje me qera nga bashkia e godinave nga stoku i banesave.

Një alternativë tjetër për Bashkinë Vlorë është evidentimi i saktë i stokut të banesave dhe mundësia për tu perdorur nëpërmjet instrumentave financiar apo patneriteteve të ndryshme që bashkia mund të krijojë nga detyrimet fiskale që shumë pronarë të stokut të apartamenteve mund të konvertojnë në apartamente për detyrimet financiare që i kanë bashkë. Në këtë rast Bashkia vendos një raport tjetër kontraktimi me familjet në nevojë për tu ardhur në ndihmë nëpërmjet këtij procesi. Bashkia ka planifikuar dy parcela për ndertime për strehim social. Bashkia në bashkëpunim me entitetin e banesave, në një truall afër “ ish-frigoriferit”, po shikojnë mundësojnë negociimin për ndërtimin e një kompleksi banimi për shtëpi sociale ku mendohet të ndërtohen rreth 150 apartamente.

## 2. Plani i Mbrojtjes së Mjedisit

### Vlerësimi për Planin

*Vlerësim i përgjithshëm-* Turizmi, peshkimi, bujqësia përbëjnë sot bazën e aktiviteteve ekonomike në Bashkinë e Vlorës. Kriza globale dhe zhvillimet e fundit kanë sjellë një situatë e cila kërkon vëmendjen dhe analizë të thelluar për të patur një zhvillim të që ndryshëm ekonomik ndër vite. Plani i Përgjithshëm Vendor synon të vendosë disa parime bazë në këtë territor ku do të parashikohet zhvillimi i Bashkisë si dhe do të tentojë të krijojë një situatë të favorshme për zhvillimin e zonës në një atraksion turistik me një mjedis të qëndrueshëm dhe duke mbrojtur atë. Krahas përgatitjes së PPV-së është përgatitur dhe VSM-ja ku janë vendosur të gjithë treguesit që duhen resktuar për të patur një mjedis të ballancuar edhe mbas zhvillimeve në këtë zonë.

Nivelet e monitorimit të mjedisit deri më sot në këtë Bashki kanë qenë në nivele të pakënaqshme gjë e cila lidhet me shumë faktorë. Duke qenë se sot tendenca e turizmit ecën në drejtim të rritjes së kërkesave lind nevoja për një monitorim të vazhdueshëm të mjedisit. Mungesa e kapaciteteve monitoruese si për nga teknologjia ashtu edhe ai njerëzor e vështirëson monitorimin, për këtë arsye ekspertët kanë përpunuar një sistem monitorues të thjeshtë i cili aplikohet në një staf aktual që bashkia ka. Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për integrim në të ardhmen që mund të lindin si rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që mund të lidhë qeveria shqiptare.

Sistemi i përdorur për monitorimin e VSM-së është bazuar kryesisht në të dhëna që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar si dhe në kërkimet e bëra për realizimin e **Planit të Përgjithshëm Vendor**. Ekspertët u munduan të optimizojnë midis kërkesës dhe realitetit për realizimin e matjeve të mundshme për realizimin e monitorimeve.

Disa nga gjetjet më kryesore si kombinime të masave mjedisore që duhen marrë gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor do të grupohen në nënçështjet më të rëndësishme si më poshtë:

*Laguna dhe Biodiversiteti-* Plani i Bashkisë përfshin trajtimin e zonave të mbrojtura përmes VKM-së që do të zhvillohen sipas një plan menaxhimi të miratuar. Kjo përbën një element të rëndësishëm të objektivave të VSM. Parku i Llogarasë, ZMD Karaburun Sazan, Laguna e Nartës, e Orikumit janë zonat me rëndësi të madhe për Bashkinë dhe për vendin. Laguna përbën ekosistemin më të spikatur në zonën në studim dhe në nivel kombëtar. Plani respekton objektivat

kombëtare (B1,B3) dhe ato ndërkombëtare (RAMSAR, 2000/60/EC etj). Gjithashtu në Plan shqyrtohen mënyrat e zhvillimit të qëndrueshëm duke respektuar habitatet dhe sidomos ato të specieve me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Objektivat e VSM duhet të përputhen me menaxhimin e basenit lumor, nxjerrje të ujit dhe zbutjen e ndotjes dhe ku është e aplikueshme me zona të mbrojtura dhe llojeve të masave.

*Menaxhimi i Burimeve Ujore-* Burimet ujore në Bashki Vlorë janë një objektiv kryesor i VSM. Në Planin e paraqitur është trajtuar gjerësisht problematika *së pari*, vihet re mungesa e menaxhimit të burimeve ujore, *së dyti*, për rëndësinë e madhe që ka zhvillimi i industrisë së turizmit në Bashki dhe *së treti* për rëndësinë e ujit në shëndetin publik. Të gjitha masat e Objektiveve Kombëtare të zbatuara për rastin e Bashkisë (projekte përparësore në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, të programit të investimeve, reduktimi i ndotjes së burimeve ujore sipërfaqësore, mbrojtjen e ujërave nëntokësore etj) duhet të pasqyrohen në VSM-ne e kësaj Bashkie.

*Mbrojtja e Tokës-* Mbrojtja e tokës përbën një nga objektivat kryesore të planit të Bashkisë duke marrë në mbrojtje fondin e tokës (Novoselë, Panaja, Sherishtë, etj) dhe në mënyrë të veçantë atë bujqësore, nëpërmjet parimeve dhe udhëzuesit e tjerë. Gjithashtu një vend të veçantë zë riaftësimi i tokave të kripëzuara, tokave në rrezik përmbajtje përmes rigjenerimit të sistemit të drenazimit apo atij kullues ekzistues, ujitjen, hedhjen e pakontrolluar e mbeturinave etj, pra praktikisht të gjitha objektivat kombëtare zbatohen për rastin e kësaj bashkie. Mbrojtja e tokës përbën edhe një nga objektivat kryesore të VSM të Bashkisë.

*Cilësia e Ajrit-* Bashkia karakterizohet nga një cilësi ajri e pastër (sipas raportit mjedisor 2015) por një numër presionesh vijnë nga zhvillimi industrial i saj (TEC, Petrolifera, ndërtimi etj), trafiku i rënduar sidomos në periudhën e verës, të cilët cenojnë këtë pastërti ajri. VSM-ja i ka identifikuar presionet mjedisore që lidhen me nevojën rishikimit të pranisë së këtyre industrive, kontrollit mbi to lidhur me emetimet në ajër, shkarkimeve të ujërave etj, për të zvogëluar ndotjen nga trafiku, nevoja për të kontrolluar emetimet e pluhurave gjatë ndërtimit të godinave të nevojshme, si dhe për të reduktuar emetimet nga vendgrumbullimi i mbetjeve. Objektivat e VSM do të vendosen në përputhje me çështjet e mësipërme të ngritura dhe objektivat përkatëse kombëtare.

*Ndryshimet Klimatike-* Objektivat lidhur me ndryshimet klimaterike janë të lidhura ngushtësisht dhe në varësi të iniciativave dhe planeve kombëtare, sidoqoftë vendosja dhe zbatimi i niveleve të emetimeve që lëshojnë apo do të lëshojnë aktivitetet industriale në afërsi të territorit të Bashkisë do të përbënin një ndër objektivat e VSM. Kjo do të ndikonte në ndërgjegjësimin e popullatës për të kontribuar në nivel kombëtar, në përdorimin me efikasitet të energjisë dhe në

përdorimin e energjive të rinovueshme që mund të zhvillohen në nivel lokal. Në mënyrë specifike prania e TEC në brendësinë gjeografike të territorit të Bashkisë e bën edhe më aktual këtë objektiv të VSM.

*Menaxhimi i Mbetjeve-* Menaxhimi i mbetjeve është një ndër presionet mjedisore të Bashkisë i cili gjen zgjidhje në Planin e saj, në mënyrë të veçantë problemin e vend-hedhjes së tyre dhe atë të përpunimit. VSM 3 merr parasysh këtë zgjidhje por do të kërkojë edhe planin e menaxhimit të plotë të mbeturinave, listën e projekteve prioritare lehtësuese si për reduktimin dhe eliminimin e aktiviteteve ekzistuese të pakontrolluara të depozitimit të mbetjeve ashtu dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve për të ardhmen e Bashkisë. VSM merr në konsideratë mjediset (ish-fusha e aviacionit, etj) që janë në territorin e Bashkisë që me praninë e tyre ndikojnë në ekosistemin e saj siç është rasti për mbetjet e rrezikshme, mjekësore apo industriale apo edhe ato të rrezikshme.

*Ndotja nga Zhurmat-* Ndotja nga zhurmat nuk është një presion i konsiderueshëm mjedisor në Bashki, sidoqoftë prania e parkut energjetik e porteve dhe e trafikut të rënduar në sezonin e verës krijon premisa për një ndotje të tillë, po ashtu edhe shtimi i aktiviteteve të shërbimit. Kjo do ketë të bëjë me monitorimin dhe me zbatimin e ligjeve të zhvillimi në përputhje me ato të kombëtare dhe ato të BE.

#### *Sistemi i monitorimit*

Më qëllim që VSM të ketë një përdorim praktik për administratën e bashkisë dhe për shtresat e interesuara, do të ishte e nevojshme vendosja e një numri indikatorësh dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do tu mundësojë grupeve të interesit:


- a. Monitorimin e progresit drejt objektivave të VSM
- b. Monitorimin e efekteve mjedisore që vijnë nga zbatimi i PPV
- c. Identifikim e efekteve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stadi të hershme
- d. Mundësim për veprime korigjuese të përshtatshme

Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme. Një proces rishikimi dhe monitorimi është përgatitur për tu përfshirë në një raport vjetor, që do të hartohet nga sektori i mjedisit në administratën e bashkisë (me ndihmën e eksperteve kur është e nevojshme) dhe që do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak. Po kështu është propozuar që informacioni i mjedisit të përditësohet çdo 6 muaj me qëllim për të siguruar një paralajmërim të në kohë të përshtatshme në rastet e një dëmtimi serioz mjedisor, pavarësisht që raporti i monitorimit të VSM është vjetor. Sistemi i monitorimit do tu



mundësojë grupeve të interesit të bashkisë të vlerësojnë nga pikëpamja mjedisore, strategji dhe programe të tjera që mund të zbatohen në të ardhmen, duke ndjekur iniciativat e Këshillit Bashkiak dhe mundësi apo programe të BE.

Procesi i monitorimit të VSM duhet të ecë që sot e tutje paralelisht me zbatimin e PPV duke u bërë pjesë integrale e tij. Të gjithë qëllimet dhe të dhënat janë të bazuara në objektivat e PPV dhe standardet kombëtare. Në rrugën e zbatimit mundet që Shqipëria të përshtatë edhe më tej standardet e saja me ato të BE-se apo nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja (si dhe arritje të tjera të rëndësishme). Poshtë janë siguruar disa të dhëna bazë ekzistuese lidhur me gjendjen aktuale si dhe disa vlera normale për parametra të ndryshëm.



Harta 12-Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore

## 2.1 Parashikimet për mbrojtjen e peizazhit natyror dhe kulturor

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së, ofron mekanizmat për mbrojtjen e zonave peisazhistike dhe peisazheve të veçanta që dallojnë edhe në nivel rajonal si dhe për krijimin e një peisazhi të një cilësie të lartë.

Masat për mbrojtjen e peisazhit parashtrohen si më poshtë:

*1. Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i peisazhit urban dhe pamor, i monumenteve kulturore dhe i trashëgimisë arkitekturore:*

- Të gjitha masat e lidhura me promovimin e vlerave turistike në territoret rurale dhe malore si dhe me objektivin e zhvillimit të turizmit të interesit të veçantë, kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM. Ruajtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror dhe trashëgimisë kulturore është një parakusht themelor për të promovuar reputacionin e zonës si destinacion të shquar turistik. Propozimet për ripërdorimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore (Kalaja e Kaninës dhe Manastirin e Zvernecit, Kisha Marmiroit , qyteti antik i Amantia si dhe qendern Historike te qytetit Vlore etj) për qëllime të turizmit do të shqyrtohet dhe miratohet nga drejtoria përgjegjëse e Ministrise se Kulturës. Ndër kushtet e veçanta të vendosura përmendim:
  - Manastiri i Zvernecit, i cili është rehabilituar dhe ri-aktivizuar si objekt kulti, do të shërbejë si monument i trashëgimise duke u koordinuar me autoritetet perkatese fetare.
  - Restaurimet dhe ristrukturimet e nevojshme ne Kalane e Kanines do te planifikohen duke respektur ruajtjen e identitetit dhe funksionimit tradicional te objektit.
  - Promovimi i vlerave turistike në territoret rurale dhe malore do të bëjë të mundur ripërdorimin e qëndrave arkeologjike për turizmin për qëllime sociale dhe kulturore duke patur një efekt pozitiv anësor në tërheqjen e fondeve për restaurimin dhe rehabilitimin e tyre.

Masat për promovimin e konsolidimit dhe integrimin hapësinor mund të kenë një kontribut sinergjik potencialisht pozitiv në objektivat e VSM. Integrimi hapësinor është një parakusht i domosdoshëm për të promovuar vizionin e zhvillimit të turizmit ne te gjithe Bashkine Vlore, çeshtje e cila bazohet në zhvillimin e marrëdhënieve plotësuese midis pjesëve bregdetare dhe në brendësi të Bashkisë. Gjithashtu integrimi hapësinor është i rëndësishëm për të nxitur përhapjen e përfitimeve nga zhvillimi i turizmit në të gjitha pjesët e bashkise duke perfituar ne menyre te ndersjellte territori i bashkise.

Promovimi i konsolidimit hapësinor të zonave ekzistuese të vendbanimeve do të ketë një efekt pozitiv sinergjik mbi lehtësimin e zhvillimit efikas të sistemeve te shërbimit dhe ofrimin e shërbimeve lokale. Gjithashtu kjo do të çojë drejt planifikimit të kontrolluar të zhvillimit urban nga ana e Njesive Administrative si

edhe në ndalimin e ndërtimeve urbane dhe aktiviteteve ekonomike në zonat pranë parkut industrial dhe vend-depozitimit të mbetjeve urbane.

Zonat e konservimit përfshijnë zonat karakteristike gjeonatyrore me vlerë të lartë peisazhike, mjedisore e turistike të qytetit. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat çënojnë identitetin e zonës. Objektet e mundshme ekzistuese të zonës mund të restaurohen, duke mos çënuar elementët arkitektonikë të veçantë të tyre. Si e tillë mund të klasifikohet zona e terreneve sportive, golf, hipizëm, etj. Ndër funksionet e lejuara përmendim: parqet dhe sheshet (vëndet e çlodhjes, duke ruajtur e kultivuar gjelbërimin); peisazhet e mbrojtura, mjediset me karakter rekreativ (varka, kanoe, peshkim e kamping me shërbimet përkatëse), shatrivane e pasqyra ujore, skulptura e monumente, lulishte, kopshte zoologjike, objekte të përkohshme shërbimi (vetëm me leje të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të bashkisë), vënde për parkime për pronarët dhe përdoruesit e objekteve të kësaj zone (vetëm me leje të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të bashkisë)

Ndër funksionet e lejuara për ndërtimet në zonën industriale përmendim: furra buke dhe ndërmarrje të përpunimit të ushqimit, magazina dhe mjediset e tjera për tregëtimin e frutave dhe perimeve, parkime automjeteve ose stacione shërbimi, ndërmarrje të prodhimit të veshjeve, ndërmarrje të prodhimit të mobiljeve, ndërmarrje të prodhimit të makinerive dhe instrumentave, ndërmarrje të prodhimit të instrumentave muzikorë, ndërmarrje të prodhimit të mjeteve elektronike, ndërmarrje të prodhimit të lodrave për fëmijë, ndërmarrje të prodhimeve të galanterisë, ndërmarrje të prodhimit të ambalazhimit të pijeve.

Zona industriale do të zhvillohet me leje të posaçme e me supervizion të vazhdueshëm të seksionit për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionit të urbanistikës për zbatimin e parametrave të lejes së dhënë.

Shumë nga masat për uljen e periferialitetit të zonave rurale dhe malore do të kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM, ndërsa pjesa tjetër kanë një efekt neutral. Nxitja e zhvillimit të infrastrukturës dytesore në zonat e vendbanimeve, siç janë rrugët e fshatrave, hapësirave publike dhe shërbimet publike) do të ketë një ndikim pozitiv në radhë të parë mbi kushtet e jetesës së popullatës lokale veçanërisht në pjesët rurale dhe malore të Bashkisë Vlorë duke ulur periferialitetin e zonave të thella. Në një nivel dytesor do të kontribuojnë pozitivisht për synimin e promovimit të formave të veçanta të interesit të turizmit duke përmirësuar atraktivitetin e këtyre zonave për vizitorët, veçanërisht në Kaninë, Tragjas, Dukat, Nartë etj. Zhvillimi i infrastrukturës dytesore do të ketë një efekt pozitiv anësor në përmirësimin e zhvillimit të integruar të bashkisë nepermjet uljes së periferialitetit dhe rritjes së komunikimit ndërmjet ish njësive administrative. Po kështu është i

nevojshem monitorimi i zbatimit të dispozitave të PPV për zonat e vendbanimeve në të cilat do të ketë zhvillime urbane.

Masat që do të ndërmerren për reduktimin e periferialitetit brenda zonave rurale do të kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM në menyre të drejtperdrejte. Nxitja e zhvillimit të infrastrukturës dytesore në zonat e vendbanimeve dhe vecanerisht në pjesën informale të Bashkisë do të ketë një ndikim pozitiv në radhë të parë mbi kushtet e jetesës së popullatës lokale dhe përmiresimit të zonave informale dhe të pazhvilluara urbane në Vlorë, duke ulur periferialitetin e tyre si dhe zonave të paaksesueshme. Në një nivel dytësor do të kontribuojnë pozitivisht për synimin e promovimit të aktiviteteve të vecanta që do të organizohen në hapësirat publike dhe të gjelbra. Zhvillimi i zonës urbane do të ndikojë në rrijen e aseteve në të. Rekomandohet zbatimi i standarteve të parashikuara për legalizim nga ALUIZNI-t, numri i kateve, ndertimeve dhe efektet në infrastrukture. Duhet të merren masat zbutese të lidhura me monitorimin nga Bashkia të situatës në zonat informale për sa i përket respektimit të kushteve për hapësira të gjelbra, parkimi dhe tipeve ndotjeve.

## 2.2 Parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore

Plani i Përgjithshëm Vendor, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së duhet të ketë parasysh:

*1. Mbrojtjen e trupave ujore, kthimin e përrenjve dhe lumenjve në korridore të gjelbërta natyrore, përcaktimin e vijës blu me parashikimet e masave të mëposhtme:*

- Deti përbën burimin kryesor të të ardhurave direkte dhe indirekte të Bashkisë Vlorë dhe për këtë arsye ai është një element shumë i rëndësishëm për këtë bashki dhe duhet monitoruar për të përcaktuar zonat e ndotura dhe ato të pastra. Ndërkombëtarizimi i përbërjes së turistëve vitet e fundi e bën të detyrueshme krahasimin e parametrave të ujit me ato të standardeve europiane.

Bashkia ka detyrimin ligjor dhe është përgjegjëse për marrjen e kampioneve të ujit në zonat e plazheve duke e identifikuar atë. Bashkia duhet të kryejë të paktën pesë (5) monitorime nëpërmjet kampioneve të ujit të marra në plazhet e identifikuar për çdo sezon plazhi, duke filluar nga një kampion për sezonin para fillimit të sezonit veror dhe katër të tjera gjatë sezonit veror. Si sezon plazhi të konsiderohet nga 1 Qershori deri në 1 Shtator dhe para-sezon nga 15 Maji deri në 31 Maj.

**Tabela 7 Kërkesat Cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE**

<b>Direktiva e KE për cilësinë e ujërave të plazheve (76/160/EEC)</b>			
<b>Parametra</b>	<b>Udhëzim</b>	<b>I detyrueshëm</b>	
<b>Mikrobiologjike</b>			
<b>Totali i coliform (Numri/100ml)</b>	$\leq 500$ <sup>1</sup>	$\leq 10,000$ <sup>3</sup>	
<b>Foecal coliform (Numri/100ml)</b>	$\leq 100$ <sup>1</sup>	$\leq 2,000$ <sup>3</sup>	
<b>Fiziko-kimike</b>			
<b>Vajra minerale (mg/l)</b>	$\leq 0.3$ <sup>2</sup>	Jo film dukshme në sipërfaqen e ujit dhe pa erë <sup>3</sup>	
<b>Substanca me sipërfaqe aktive (mg/l)</b>	$\leq 0.3$ <sup>2</sup>	Jo shkume të qëndrueshme <sup>3</sup>	
<b>Fenol (mg/l as C<sub>4</sub>H<sub>3</sub>OH)</b>	$\leq 0.005$ <sup>2</sup>	Nuk ka ere specifike $\leq 0.05$ <sup>3</sup>	

*Shënim 1:  $\geq 80\%$  të mostrave - Shënim 2:  $\geq 90\%$  të mostrave - Shënim 3:  $\geq 95\%$  të mostrave*

Po kështu është shumë e rëndësishme për Bashkinë që të mund të kryejë këtë monitorim të këtyre parametrave brenda vitit **2017**. Rezultatet e monitorimit duhet edhe të shërbejnë si bazë për masat e nevojshme që duhen marrë. Rezultatet duhen të bëhen të njohura me mënyra të ndryshme për publikun si dhe përmes faqes së internetit të Bashkisë. Bashkia në bazë të rezultateve mund të hartojë një hartë me cilësinë e ujërave dhe plazheve.

- Zhvillimi i transportit detar në Bashkinë Vlorë pergjithesisht bie ndesh me objektivat e mjedisit në pikën e ndotjes së ujit detar duke sjell një risk të cili rrjedh nga aktiviteti i renduar. Gjithashtu edhe zhvillimi i turizmit (formes Kroçera) dhe rritja e numrit të vizitorëve në këtë zonë mund të ketë një efekt negativ kumulativ afatgjatë në rritjen e nivelit të ndotjes në det apo mbetjeve ndaj në këtë formë duhen marrë masa të rrepta në këto drejtim. Është e nevojshme të merren masa për largimin e mbeturinave nga anijet e ndryshme në vend depozitimet e caktuara. Gjithashtu janë të nevojshme: zbatimi i konventes për ujrat territoriale, monitorimi i cilësisë së ujit të detit në pikat ku zhvillohet transporti detar, ndalimi i ankorimit të tyre pranë zonave lagunore por në vendodhje të veçanta të percaktuara nga Bashkia, masa zbutëse për kontrollin gjatë zhvillimit të intinerareve të Korçerave.

*2. Mbrojtja e burimeve ujore dhe përmirësimi i rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm do të realizohet me masat e mëposhtme:*

- Masat që do të ndërmerren për furnizimin me ujë të në Bashkinë Vlorë nuk kanë ndonjë ndikim negativ në objektivat e VSM, përkundrazi disa kontribuojnë pozitivisht në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së popullatës

lokale dhe kontrollin e përdorimit të burimeve natyrore, si dhe zhvillimit me standarde të turizmit. Sigurimi i ujit për vaditje do të shërbejë për të kursyer ujin e pishem. Ndër efektet anësore negative të mundshme do të përmendim ndikimet që lidhen me sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore nëntokësore. Është i nevojshëm monitorimi i cilësisë së ujit në pikat e prodhimit të tij, në daljet e depove dhe në pikat fundore të konsumit. Gjithashtu duhet të bëhet monitorimi periodik i vetive fiziko - kimike të ujit të pijshëm dhe i treguesve mikrobiologjik si edhe është i nevojshëm vendosja e rrjetit të kullimit për vaditje dhe eliminimi i ujit të pijshëm për vaditje.

*3. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, trajtimit të ujrave të zeza dhe të ndotura:*

- Masat që lidhen me menaxhimin e mbetjeve kanë një kontribut pozitiv në objektivat e VSM nga momenti që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave është një politikë kritike për mbrojtjen e cilësisë së tokës, ujit nëntokësor dhe të ruajtjen e cilësisë së peizazhit. Ajo mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në kushtet e jetesës së popullsisë lokale dhe standardet e turizmit. Rekomandohet promovimi i programeve vullnetare për pastrimin e zonave të ndotura; miratimi i politikës të reduktimit të mbeturinave, riciklimi dhe ripërdorimi në planifikimin e objekteve të organizuara turistike; programimi i riciklimit të mbetjeve dhe ndarja e tyre.

Ndër masat që lidhen me menaxhimin e mbetjeve përmendim:

1. Rregullat e veçanta të vendosura për deponimin / trajtimin e mbeturinave të kafshëve Në respekt të:

- Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”

- Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

- Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendor”

2. Rregulla të veçanta që duhen të respektohen në lidhje me deponimin e bizneseve turistike (vaj i restoranteve)

3. Perputhshmëri me kerkesat e Ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Ligjit “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” që gjejnë pasqyrim në Planin e Menaxhimit dhe Monitorimit të mbetjeve të ngurta të hartuar nga komuna.

4. Kushte të veçanta / rekomandim për menaxhimin e mbeturinave të zonës së plazheve të Bashkisë Vlorë.

5. Kushte të veçanta për administrimin e mbeturinave në zonën e mbrojtur

6. Kushte të veçanta në lidhje me depozitimin e mbetjeve të ndërtimit

7. Monitorimi i cilësisë së ajrit - Ndikimi i depozitimeve në hapsirë së

Bashkisë së Vlorës:

- Monitorimi i cilesise se ajrit dhe ujrave ne zonen e landfillit të Vlorës
- Mbulimi me dhe, dhe ngjeshje;
- Hapja e kanaleve të veçanta për ujërat e kullimit;
- Mbrojtjes nga zjarret;
- Ndalimi i hyrjes për personat e paautorizuar; gjelbërimi i pjesës së fushës, ku nuk depozitohen mbetje.

- Të gjitha masat që lidhen me përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve do të kenë një efekt pozitiv në objektivat e VSM. Parandalimi i shkarkimeve të ujrave të patrajuara nga zonat industriale, turistike dhe banimi është një parametër kyç për mbrojtjen e detit dhe cilësinë e ujit te lagunave te Nartes dhe Orikumit i cili ka një rëndësi thelbësore për mbijetesën e specieve endemike dhe habitateve. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së popullatës lokale dhe është një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit. Një efekt tjetër pozitiv do të vihet re dhe në promovimin e reputacionin të zonës si destinacion i veçantë për turizëm cilësor dhe ekoturizmit. Faza ndertimore e infrastruktures te kanalizimeve shoqerohet nga efekte negative në levizjen e dherave, depozitimn e mbetjeve te ndertimit, cilesine e ajrit (ndotje nga pluhuri) dhe demtimin e flores ne gjurmen e ndertimit. Evitimi i ndotjes së ajrit.

- Po kështu është i nevojshem një studimi i veçantë fizibilitetiti për infrastrukturen lidhur me qellimin e ndërtimit të veçantë të impiantit të trajtimit të ujrave të zeza për zonën bregdetare të Narte, Zvërnec dhe Radhime.

Ndër masat që lidhen me trajtimin e ujërave të zeza në zonat turistike:

1. Projektimi i sistemit të menaxhim te mbetjeve te ngurta dhe të lëngshme te objekteve turistike, do të bazohet në parimet e reduktimit të mbeturinave, riciklimin dhe ripërdorimin.

2. Çdo njësi hoteli me kapacitet mbi 100 dhoma ka për të ndërtuar një impiant individual të trajtimit të ujit.

3. Vendodhja për pozicionimin e impiantit te trajtimit të ujrave për plazhet me kryesore do të specifikohen nga studimi i veçantë i infrastrukturës.

4. Nuk do të jepet leje për objektin e turizmit pa sigurimin e lidhjes së rrjetit të kanalizimit të specifikuar nga PDV përkatëse për zonën bregdetare.

5. Nuk duhet të jepet leje ndertimi për infrastrukturen e kanalizimeve dhe përpunimin e ujrave te zeza pa specifikimin e detyrimeve per hartimin dhe zbatimin e planeve te monitorimit dhe manaxhimit: te kontrollit te pluhurave, te mbetjeve te ngurta, per rehabilitimin e siperfaqes ne gjurmen e ndertimit, per rehabilitimin dhe kompensimin e flores te demtuar nga ndertimi

6. Parandalimi i shkarkimeve të ujrave të patrajuara nga zonat industriale, turistike dhe banimi është një parametër kyç për mbrojtjen e detit dhe cilësi të ujit të



lagunave të Nartes dhe Orikumit i cili ka një rëndësi thelbësore për mbijetesën e specieve endemike dhe habitateve. Zhvillimi i rrjetit të kanalizimit kontribuon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së popullatës lokale dhe është një parakusht themelor për zhvillimin e turizmit

## **2.3 Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapsirave të gjelbra dhe mbrojtja e biodiversitetit**

Plani i Përgjithshëm Vendor, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së ka parasysh:

*1. Shtimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura natyrore, peisazhit natyror, biodiversitetit dhe pyjeve:*

- Shumica e masave që lidhen me mbrojtjen e zonave të mbrojtura natyrore, peisazheve, pyjeve dhe biodiversitetin kontribuojnë pozitivisht në objektivat e VSM. Rehabilitimi i tokës përgjatë bregdetit lindor të brendshëm të lagunës së Nartes do të kthehet përsëri bashkë si një burim i rëndësishëm, aktualisht i papërdorur, që mund të gjenerojë vlera të shumta, ekonomike, rekreative dhe mjedisore. Pyllëzimi dhe krijimi i natyrës së re mund të sigurojë kushtet për rigjenerimin e habitateve. Rehabilitimi i tokës për bujqësi përgjate pjesës veri perendimore të Bashkisë Vlorë, Nartë, Novosele si dhe zona Orikumit afër lagunës mund të ketë ndikim pozitiv ekonomik për të ardhurat e popullatës lokale.

-Efektet potenciale negative anësore vihen re në lidhje me aktivitetet bujqësore në cilësinë e ujit të lagunave, modifikimin e bregdetit të lagunës së Nartës dhe krijimin e ishujve artificiale në ekosistemit lagunor. Ndërkohë, rehabilitimi i tokës bujqësore do të ketë një efekt pozitiv anësor mbi të ardhurat e komunitetit si dhe shtimi i vlerave të aseteve të tyre.

- Projektet e propozuara për ripyllëzimin dhe krijimin e ishujve artificiale do të ketë një efekt pozitiv sinergjik në rigjenerimin e habitateve dhe biodiversitetit në pjesën lindore të lagunës.

- Gjithashtu vlerësohet një efekt pozitiv sinergjik i lidhur me zhvillimin e formave të veçanta të interesit të turizmit (ekoturizmit, turizmit rekreativ, agroturizmi, turizmi natyror).

- Vlerësohet një efekt i mundshëm pozitiv sinergjik me Planin e Menaxhimit në promovimin e projekteve të përbashkëta pilote të ndërgjegjësimit mjedisor në lidhje me zonat për rekuperimin e peizazhit.

Faktorë që do të ndikojnë në shtimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura natyrore, peisazhit natyror, biodiversitetit dhe pyjeve lidhen me masat zbutëse për bujqësi:

1. Nxitja e kultivimit të produkteve organike dhe vetëm produkte të cilësisë lokale.
2. Parandalimi i përdorimit të pesticideve dhe kimikateve në tokë në afërsi me lagunën.
3. Masat zbutëse për krijimin e ishujve artificiale dhe bregdetit:
  - ndalimi i ndertimit të objekteve rekreative apo të aktivitetit publik në ishujt artificiale (me perjashtim të ndonjë kulle vrojtimi);
  - rehabilitimi i sipërfaqes së ishujve artificiale dhe kultivimi mbi to i bimeve tipike të lagunes;
  - krijimi i kushteve dhe rehabilitimi i flores dhe faunes tipike të lagunes me synim vijueshmerine e ekosistemit (eliminimin e fragmentarizimit të shkaktuar nga ishujt);
  - Mbjellja e shkurretave tipike lagunore dhe krijimi i kushteve natyrore për folezimin e shpendeve të rezikuara të lagunës
4. Monitorimi i biodiversitetit
5. Hartim i plan veprimit dhe manaxhimit të formave të turizmit me interes të veçantë në zonen breg-lagunore dhe atë të ishujve artificiale

## **2.4 Parashikimi i varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar përsa u përket hotspotëve**

Në Bashkinë Vlorë ndër hotspotet kryesore të cilat paraqesin problematika evidente që kërkojnë zgjidhje janë centrali TEC, portin petrolifer si edhe portin e peshkimit por, nuk duhet të harojmë që zona rrezikohet edhe nga prezenca e guroreve.

Në territorin e Bashkisë Vlorë gjenden disa gurore monitorimi i të cilave është e një rëndësie të veçantë megjithëse aktualisht ato nuk përbëjnë një shqetësim. Riliçensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisit, ligj për Vlerësim e Thelluar Mjedisor. Në mënyrë të veçantë për guroret është e rëndësishme aplikimi i udhëzimit në pikat e nenit 14 (a, b, c, d). Hapja e guroreve të reja duhet të bëhet në zonat e sugjeruara nga Plani ose duke u bazuar në sugjerimet e specialistëve dhe të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

**Tabela 8 Monitorimi i gurove dhe rehabilitimi**

Parime	Objekti va	Ng a viti
<b>Parandalimi i rinovimit te licencës për guroret pa vlerësimin paraprak mjedisor nga Agjencia e Vlerësi mit Rajonale të Mjedisit</b>	100%	2017
<b>Rehabilitimi i guroveve ekzistuese sipas Direktives 3, Maj 2006 MoEFËA</b>	100%	2018

## 2.5 Parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Në analizën e gjendjes aktuale në Bashkinë Vlorë, vlerësimi i cilësisë së ajrit është monitoruar nga institucionet përkatëse. Nga rezultatet ai nuk rezulton shqetësues, por duke marrë parasysh zhvillimin e zonës Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së ajrit të mbeten të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit". Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë të rregullt gjatë gjithë vitit dhe duhet shtuar numri i stacioneve sidomos gjatë sezonit veror. Në varësi të monitorimeve Bashkia duhet edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si: (i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NO<sub>x</sub> - 40 µg/m<sup>3</sup>, për PM<sub>10</sub> - 40 µg/m<sup>3</sup>, për PM<sub>2,5-25</sub> µg/m<sup>3</sup> dhe 20 µg/m<sup>3</sup> dhe SO<sub>2</sub>-125 µg/m<sup>3</sup> per 24 orë ose 20 µg/m<sup>3</sup> në vit.

**Tabela 9 Vlerat e kufi të ndotësve (burimi ISHP)**

Periudha e Monitorimit			Objektiva nga 2016	
Ndotësit (µg/m <sup>3</sup> )	Metoda	Vlera e periudhës mesatare	Standarde AL (µg/m <sup>3</sup> )	Standarde e BE (µg/m <sup>3</sup> )
<b>Pluhuri total</b>	gravm		140	80
<b>PM<sub>10</sub></b>	ads		40	40
<b>O<sub>3</sub></b>	ads		120	110
<b>NO<sub>2</sub></b>	ads		50	40

**Tabela 10 Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t`u monitoruar**

<b>Ndotësit</b>	<b>Përqendrimi</b>	<b>Periudha Mesatare</b>	<b>Te monitorohet dhe zvogëlohet nga viti</b>
<b>Grimcat e Imëta (PM2.5)</b>	25 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
<b>Dyoksidi i Squfurit (SO<sub>2</sub>)</b>	350 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	125 µg/m <sup>3</sup>	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
<b>Dyoksid Azoti (NO<sub>2</sub>)</b>	200 µg/m <sup>3</sup>	1 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 1.1.2014
<b>PM<sub>10</sub></b>	50 µg/m <sup>3</sup>	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
	40 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
<b>PLUMB (Pb)</b>	0.5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
<b>Monoksid Karbon (CO)</b>	10 mg/m <sup>3</sup>	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
<b>Benzen</b>	5 µg/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
<b>Ozon</b>	120 µg/m <sup>3</sup>	Maksimalja ditore 8 ore mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
<b>Arsenik (As)</b>	6 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
<b>Cadmium (Cd)</b>	5 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
<b>Nikel (Ni)</b>	20 ng/m <sup>3</sup>	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
<b>Hidrokarbure Aromatike Policiklike</b>	1 ng/m <sup>3</sup> (i shprehur si përqendrim i benzenit (a)pirene)	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
<b>PM<sub>2.5</sub> Përqendrim i ekspozuar i detyruar</b>	20 µg/m <sup>3</sup> TME (Treguesi Mesatar i Ekspozimit)	Bazuar ne Mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2018

Bashkia duhet gjithashtu të përgatisë një plan apo program për të siguruar përputhshmërinë e vlerave me standardet përpara hyrjes në fuqi të datës limit të synuar sikurëse tregohet në tabelat e mësipërme. Gjithashtu Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

## 2.6 Zhurmat dhe ndotja akustike

Të dhënat mbi ndotjen akustike në Bashkinë e Vlorës mbeten brenda intervaleve të lejuara. Një bazë të dhënash lidhur me nivelin e zhurmave në zonë sigurisht që do të ndihmonte shumë në përcaktimin e saktë të masave që duheshin marrë në zonat më të ndjeshme për të siguruar një zonë turistike të shëndetshme dhe relaksuese. Shqetësuese në këtë Bashki për biodiversitetin ujor është ndotja akustike e ujit të detit si pasojë e pranisë së një numri relativisht të madh anijesh tregtare, peshkimi e tragetesh.

Në përgjithësi vlera e synuar për zhurmat nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej Lmax-56 dB gjatë ditës dhe 45 dB gjatë natës në të gjitha zonat e Bashkisë. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

## 2.7 Parashikime për menaxhimin e mbetjeve

Bashkia e Vlorës gjeneron në tërësi rreth 125,000 t mbetje në vit. Problematika e mbetjeve në këtë Bashki kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për një zgjidhje të shpejtë dhe afatgjatë. Plani sugjeron ndërhyrje me projekte dhe investime. Në plan parashikohet ndërtimi i një impianti me teknologji moderne që të diferencojë mbetjet dhe të djegë ato që nuk mund të trajtohen më tej, duke shfrytëzuar të gjitha cilësitë e këtyre mbetjeve, i vendosur në zonën industriale gjendet në rrugën për në fshatin Sherishte. Zhvillimi i një sistemi transporti për mbetjet, vendosjen e kontenerëve me një dendësi më të madhe si dhe një program për ndërgjegjësimin e komunitetit të Bashkisë Vlorë.

Këto veprime do të mundësohen përmes respektimit të një numri të madh ligjesh dhe VKM (*Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”; Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”; Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 “Për lëndfillet e mbetjeve”; Vendim nr.*

765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; Vendim nr.957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; Vendim nr.117, datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 “Për disa ndryshime ne vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; Vendim nr.371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”; Vendim nr.418, datë 25.06.2014 ” Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; Vendim nr.608, datë 17.09.2014 ”Për përcaktimin e masave të nevojshme për nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 “Per miratimin e rregullave per eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit te mbetjeve jo te rrezikshme e të mbetjeve inerte” dhe ligjin përimportin e mbetjeve 2016) parimet e strategjise kombëtare dhe ligjit mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar tre parimet të BE lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve: 1. Parandalimi të krijimit të mbetjeve; 2. Duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim; 3. Duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve dhe duke monitoruar. Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në të ardhmen.

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve:** Ky është një faktor kyç në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.
2. **Ndihmë për industrinë e riciklimit:** Organizimi nga ana Bashkisë i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.
3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi:** Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve** det, në shtretërit e përrrenjve dhe lumenjve, buzë rruës apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i

menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa objektiva dhe synime kohore lidhur me qasjen e përmendur me sipër.

**Tabela 11 Objektivat për reduktimin e mbetjeve**

Parimi	Objektiva	Nga viti
<b>Asgjësimi i mbetjeve që shkojnë në landfill</b>	Reduktimi në masen 45%;	2020
<b>Riciklimi dhe ripërdorimi</b>	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve nga 35%	2020
<b>Përmirësimi i asgjësimit përfundimtar dhe monitorimi</b>	Të gjitha mbetjet e mbledhura me 100%	2017
<b>Shmangia e asgjësimit në shtretër të lumenjve dhe rrugëve anësore</b>	Të gjitha mbetjet 100%	2017
<b>Asgjësimi në landfille në mënyrë të kontrolluar</b>	Në masën 75%	2017
<b>Monitorimi i mbetjeve të industrisë së peshkut dhe akuakulturës</b>	Shmangia e rritjes së peshkut në gjire të mbyllura nga 100%	2017
<b>Portet e reja dhe ekzistuese (marina)</b>	Shmangia e derdhjes së naftës dhe mbeturinave të tjera në det	2017

## 2.8 Parashikime për mbrojtjen e Tokës

Bashkia Vlorë ka një fond të konsiderueshëm të tokës bujqësore e cila vitet e fundit është çenuar nga presionet e zhvillimit dhe kryesisht ndërtimit. Monitorimi i saj është mjaft i rëndësishëm sidomos në kushtet kur presioni i zhvillimit po e redukton atë në mënyrë konstante. Grupi i ekspertëve ka vendosur dy objektiva lidhur me gjendjen aktuale të tokës bujqësore me qëllim përmirësimin e gjendjes së saj pas aprovimit të Planit.

**Tabela 12 Monitorimi i tokës bujqësore**

Parime	Objektiva	Viti
<b>Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore nën ujë</b>	Me 20%	2019

<b>Rritja e sipërfaqes së tokës me bonitetit të lartë</b>	Me 15%	2020
---	--------	------

## 2.9 Veprimi mbi asetet e Bashkisë Vlorë/ kohezioni social

Bashkia Vlorë është e pasur me një sërë asetesh dhe burimesh të konsiderueshme natyrore ndër të cilat do të përmendim, Gjirin e Vlorës, lagunën e Nartës, Zvërnecin, lagunën e Orikut si dhe Parkun Kombëtar të Karaburun-Sazanit.

Kjo Bashki ka gjithashtu edhe një të madhe monumnetsh ekologjike dhe historike. Në tabelën e mëposhtme paraqiten monumentet e natyrës sipas Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

**Tabela 13 Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në Bashkinë Vlorë**

Nr.	Qytet ose fshat	Emërtimi
1	Dukat	Rrapi i Dukatit (III)
2	Dukat	Mbihipja e Çikës (III)
3	Dukat	Mbihipja aktive e Dukatit (III)
4	Tragjas	Rrapi i Tragjasit të Vjetër (III)
5	Mifol	Rrapi i Çesmës (III)
6	Nartë	Dunat e Nartës (III)
7	Sazan	Barriera Koralore e grykës së Djallit (III)
8	Sazan	Falezat e Sazanit(III)
9	Vlorë	Rrepet e Izvorit (III)
10	Vlorë	Rrapi i Xhamisë(III)
11	Vlorë	Shpella e Haxhi Alisë (III)
12	Vlorë	Terraca detare e Kusbabait(III)
13	Vlorë	Terraca detare e ish-shtëpisë së pushimit të punëtorëve (III)
14	Vlorë	Rrapi i shkollës nr 1 (III)
15	Vlorë	Peisazhi i mbrojtur Vjosë-Nartë (V)
16	Vlorë	Rezerva natyrore e menaxhuar Karaburun (IV)
17	Vlorë	Parku Kombëtar Llogara (II)
18	Vlorë	Parku kombëtar detar Karaburun-Sazan (II)

*Burimi:* Ministria e Mjedisit





**Figura 5 Shpella e Haxhi Alisë (majtas); Shpella e Shëngjergjit (Bletës) (djathtas)**

*Burimi: Foto te Eksperteve*

Këto monumente duhet të mbrohen me çdo kusht si një pasuri e madhe e zonës por edhe kombëtare si dhe duhet të pasurohen me zona të reja të mbrojtura në bazë të ligjeve në fuqi.

Të gjitha këto asete të rëndësishme natyrore dhe kulturore, nëse do të shiheshin nga pikëpamja e atraksionit dhe zhvillimeve turistike do të përktheheshin në një fuqizim të rëndësishëm ekonomik për Bashkinë e Vlorë. Një aset i rëndësishëm është gjithashtu dhe popullësia vendanse e cila domosdoshmërisht duhet të integrohet dhe të kualifikohet me qëllim që t'i përgjigjet standarteve të punesimit dhe shërbimit të qytetit/zonës turistike të Bashkisë. Duke analizuar asetet dhe pasuritë e zonës vërehet sa më poshtë:

-Zona në studim dhe pikërisht sistemi ligatinor Nartë-Vjosë me VKM Nr.680, datë 22.10.2004 është shpallur peisazh ujor/tokësor i mbrojtur, ndërsa ishulli i Sazanit përfaqëson një pjesë të Parkut Kombëtar tokë/det. Rreth 1260 ha janë të mbuluara me ullinj, agrume dhe rrush si dhe nga bimë bujqësor si patate, fasule etj. Po ashtu pyjet me sipërfaqe rreth 1170 ha përbëjnë një pjesë të rëndësishme të zonës. Të gjitha këto pasuri janë të rrezikuara nga faktorë që lidhen me bizneset, njeriun dhe faktorët natyrorë.

-Biznesi në zonë përfshin një numër jo të madh dhe më kryesorët biznese shërbimesh tregtare, por ndër to dallohen disa njësi prodhuese të vajit të ullirit, përpunuese të mbetjeve të ullirit, të pijeve alkolike dhe të kultivimit të peshkut. Problemet kryesore në këtë drejtim lidhen me ruajtjen nga ndotja e detit dhe dëmtime të tjera të këtyre burimeve për shkaqe natyrore si zhdukje të habitateve, erozionit të origjinave të ndryshme, prishje të kanaleve komunikuese të lagunës me ujin e embël dhe atë të detit, nga ardhja e llojeve të huaja nga ardhja e anijeve të shumta në gjirin e Vlorës etj.

-Një tjetër rrezik vjen nga veprimtaria e bizneseve dhe ajo e njeriut. Ky aktivitet gjeneron mbetje të llojeve të ndryshme që nuk menaxhohen siç duhet si pasojë e mungesës së infrastrukturës, përdorimi i pesticideve si pasojë e rritjes së aktivitetit bujqësor, prerja e papërgjegjshme e pyjeve për qëllime personale apo djegia e tyre (rasti i djegies së plantacioneve të ullirit), gjuetia dhe peshkimi ilegal dhe që kryhet me metoda jo tradicionale, eutrofikimi i lagunës.

- Një rrezik është edhe zhvillimi i ndërtimeve informale të pakontrolluara të cilat krahas ndotjes së mjedisit ujqor shkaktojnë dhe dëm të konsiderueshme në humbjen e vlerës së tokës, marrjen e rërës duke dëmtur habitate si dhe burimeve të tjera.

-Zhvillimi i industrisë që lidhet kryesisht me praninë e Petroliferës, TEC-i i Vlorës dhe ndërtimin e digave kërkon një vëmendje të veçantë. Tashmë që ato janë një realitet në zonë duhen monitoruar që të zbatohen në aktivitetin e tyre të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mjedisin, (si shkarkimet në det, në ajër) dhe angazhimet e marra prej tyre në raste të veçanta. Rëndimi i mëtejshëm i zonës me aktivitete të tjera industriale do të sillte pasoja të mëdha për turizmin në zonë por edhe më gjerë. Rastet të derdhjes së hidrokarbureve në zonë kanë treguar se sa e vështirë është kontrolli mbi këto lloj biznesesh. Mendimi i shoqërisë civile, i ekspertëve të mjedisit dhe i komunitetit duhet të jetë parësor në marrjen e vendimeve të tilla radikale për zonën.

-Këto ndikime negative në mjedisin e zonës në studim do të mund të shmangen në rast se do të krijohen kushte për rritjen e ndërgjegjësimit të popullatës, ngritjes së kapaciteteve njerëzore si dhe mundësive financiare dhe me vendimmarrje politike të pandikuara nga interesa personale.

Në zonën tonë të studimit drejtimit ekonomike në këto 25 vjet kanë qenë të paqarta pavarësisht orientimit qendror. Orientimet parësore të zhvillimit i kanë tejkaluar përmasat e një zhvillimi të qëndrueshëm bazuar në shfrytëzimin e asete kryesore të Bashkisë Vlorë. Ekziston një lidhje e fortë midis përdorimit të materialeve, energjisë së përdorur, përdorimit të tokës për aktivitetet prodhuese dhe konsumuese të mirave materiale me njësitë ekonomike, shoqërinë dhe politikat territoriale. Prespektiva e rritjes ekonomike në bashkinë Vlorë, duhet të marrë parasysh dhe të fuqizojnë potencialin e rikthimit të emigrantëve me një eksperiencë disavjeçare në aktivitet dhe sipërmarrjet turistike jashtë vendit. Kjo fuqi punëtore e pajisur me eksperiencën e duhur për të kontribuar në zhvillimin e sektorëve ekonomik duke shërbyer si një shtysë për fuqizimin e ardhshëm të koezionit social dhe bashkëveprimit gjithnjë e më frytdhënës me vendet e rajonit.

## 3. Plani i Shërbimeve dhe Infrastrukturave Publike

### 3.1 Infrastrukturë publike e propozuar

#### 3.1.1 Transporti i propozuar

##### *Transporti Ajror*

Ngritja e një Aeroporti Sezonal në Akërnj, me vendodhje të përcaktuar, me një pistë të vogël ekzistuese por pa terminal dhe pa kullë kontrolli do të ndryshojë tërësisht karakteristikat e zones duke siguruar një aset shumë të rëndësishëm për promovimin e saj si një destinacion për turistët që mund udhëtojnë nga vende shumë larg nga Shqipëria, por edhe për fluturimet e brendshme të cilat mund të programohen nga Aeroporti i Tiranës.

Ka patur një mungesë për shfrytëzimin e potencialit të zones në planifikimin e fluturimeve të brendshme si rrjedhojë e konkurrencës nga modalitetet e transportit rrugor (makina private, autobusë), por edhe në planifikimin e fluturimeve ndërkombëtare si rezultat i pamundësisë së një kërkesë për realizimin e fluturimeve të planifikuara.

Potenciali qëndron për fluturime charter ndërkombëtare gjatë periudhës së verës në shërbim të zonave përreth me një distancë jo më shumë se 50 km ose 1 orë udhëtimi me autobus nga vendodhja e aeroportit në Akërnj.

Do të shtohen vëmprimtarite sezonale për nevojat e aeroportit në lidhje me aspektet e kërkesave për mirëmbajtje gjatë gjithë vitit dhe disponueshmërinë dhe fleksibilitetin sezonal të punonjësve dhe shërbimeve mbështetëse të aeroportit (policia, zjarrfikësi, qendra shëndetësore, etj).

Nevoja qëndron për të arritur qëndrueshmërinë ekonomike ose për të siguruar subvencionet alternative të domosdoshme për të operuar brenda aeroportit, pa marrë parasysh investimet e duhura për zhvillimin e tij.

Sugjerimi është për realizimin për një pistë 1.8km të gjatë e tillë që të shërbejë për fluturime charter për avionat me distancë të mesme duke lidhur vendin e origjinës me destinacionet evropiane.

##### *Transporti hekurudhor*

Edhe pse vendi aktualisht është i aksesueshëm me tren vetëm në Novoselë dhe Vlorë, shpejtësia e vogël e lëvizjes dhe shërbimi i rralluar janë jo optimale, i shoqëruar me problemet të segmenteve të caktuara si rrjedhojë edhe e konkurrencës nga modalitetet e transportit rrugor (makina private, autobusë, furgon) shpjegojnë rënien në numrin e udhëtarëve që përdorin këtë formë transporti. Rehabilitimi edhe pse afatgjatë i këtij sistemi transporti do të përmirësojë ndjeshëm rrjetin rrugor, kohën e udhëimit, kushtet e transportit duke eliminuar transportin abuziv, të pakontrolluar dhe të rrezikshëm për qytetarët.

##### *Transporti Detar*

Ne Portin e Vlorës sh.a. po zbatohet projekti për ndertimin e bankinave të reja me një vlerë 15 mln Euro të financuar nga Kooperacioni Italian duke rritur rolin e portit të pasagjerëve

Një plan për zhvillimin e turizmit detar është i nevojshëm për integrimin e bregdetit në itinerarët e gjerë të lundrimit nga Adriatiku në bregdetin e Jonit, nisur nga fakti se, aktualisht, Shqipëria përbën një lidhje përgjatë bregdetit lindor të Adriatikut dhe të Jonit. Mundësia e transportit detar me anije për vizita turistike, por edhe për pasagjerë, është me shumë interes për t'u promovuar. Sipas programit strategjik për Rigjenerimin i Portit të Vlorës, janë identifikuar 3 projekte të rëndësishme që janë; krijimi i terminalit të ri të pasagjerëve, terminali i kroçerave dhe zhvillimi i fasiliteteve. Në qytetin bregdetar mungojnë fasilitetet e marinës detare si edhe sportet detare. Në këto kuader sipas programit strategjik Marina dhe Vlora si qytet Marine, janë identifikuar këto projekte; zhvillimi i marinës urbane në shëtitoren bregdetare pranë Portit Vlorë, zhvillimi i portit në triport, krijimi i Klubit të Nautikës me pishinë të hapur, sporte ujore dhe klubin e lundrimit me vela dhe krijimi i klubit të zhytjes.

Gjithashtu projekti i shëtitores bregdetare sëbashku me një zonë plazhi publik me objekte rekreative përgjatë gjithë ballinës-ujore urbane të Vlorës (7.5 km) dhe shërbimet turistike me anije lundrimi do të përmirësojnë ndjeshëm aksesueshmërinë në të gjithë bregdetin duke shfrytëzuar në maksimum potencialin e tij dhe shërbimet për turistët.

#### *Transporti Publik*

Për Bashkinë Vlorë zhvillimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm do të jetë një orientim mjaft i rëndësishëm strategjik. Për zhvillimin e transportit publik janë identifikuar 4 projekte të mëposhtme :

- Lidhja midis qendrave urbane (autobuza rajonal)
- Lidhja midis gjithë fshatrave me transport publik
- Krijimi i stacionit qendror për autobuzët përpara stacionit hekurudhor
- Krijimi i shërbimit të transportit ujor (taksitë ujore) për të bërë një tur të plazheve kryesore dhe pikave turistike brenda gjirit të Vlorës dhe Sazanit të kontrolluara nga Bashkia.

#### ▪ *Itinerari i varkave Taksi të propozuara gjatë sezonit të verës*

Për krijimin e itinerareve turistike me kosto të ulët gjatë rrugëve panoramike janë identifikuar 3 projekte:

- zgjerimi i rrugëve panoramike të rivierës së Vlorës përgjatë gadishullit të Karaburunit
- përmirësimi i rrugës për në Zvërnec dhe bregdetin Adriatik
- përmirësimi i aksesueshmërisë për në plazhe/ krijimi i zonave të parkimit/peisazhi

Transport turistik me varkataksi do të jete prioritet ne te ardhmen dhe transport alternative ne sezon. Itinerari e VarkaveTaksi:

Triport – Port I Vlores- Plazhi I Skeles- Uji i Ftohte ( stacion Lungomare)  
Plazhi i Kalasë – Jonufer- Radhime – Orikum – Pashaliman  
Zvernec- Nartë- Uji i Ftohte – Radhime- Orkum.  
Zvernec- Vlore Port- Karaburun , Palasë- Dhermi

Parkimet: Programi për kontrollin e parkimit brenda Vlorës

1. Kontrolli i parkimit përgjatë shëtitorës bregdetare në zonën urbane
2. Sigurimi i parkimeve përgjatë plazheve

### 3.1.2 Infrastrukturë rrugore e propozuar

#### **RRJETI RRUGOR**

Rrjeti i rrugëve është një pjesë integrale e një zonë urbane apo rurale, pasi lidh zonat dhe vendet, si dhe lehtëson lëvizjen e njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë e tij, funksionin dhe qëllimin.

Qasja rrugore është në çdo rast e një rëndësie të madhe duke marrë parasysh se alternativa kryesore e transportit për njerëzit në këtë rajon është makina. Në këtë moment nuk ekzistojnë rrugë të vazhdueshme bregdetare. Duhet të depërtohet në brendësi dhe të kalohet shpesh herë nëpërmjet luginave gjë që e bën të gjithë përvojën një eksperiencë shumë të fragmentuar. Behet i nevojshëm në këtë kuadër koncepti i një qasje bregdetare në tre nivele nëpërmjet a) rrugës së vazhdueshme peisazhistike bregdetare b) rrugës kryesore bregdetare që vazhdon më tej në brendësi duke lidhur të gjitha vendbanimet malore c) korridorit ekspres të autostradës ndërrajonale.

Projektet më të rëndësishme për aksesibilitetin e rrugëve janë si më poshtë:

- *Bypass-i i rrugës Fier-Vlorë* do të përmirësojë një pjesë të konsiderueshme të aksesueshmërisë në Vlorë dhe Himarë (Dhërmi) nga qendra metropolitane e Tiranë-Durrësit dhe aeroportit ndërkombëtar duke reduktuar kohën e udhëtimit me 20-40 min.
- *Konektiviteti midis Borshit dhe Tepelenës*. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm që i kombimuar me bypass-in e Vlorës mund të përmirësojë ndjeshëm aksesin ndaj Rivierës së Himarës
- *Projekti i "Rrugës së Lumit"* përmirëson lidhshmërinë e rrugëve të brendëshme midis Vlorës dhe Borshit nëpërmjet luginës së Shushicës dhe Vranishtit.
- *Rrugën Peisazhistike Blu* përgjatë qendrave: Divjakë- Pish Poro- Nartë- Vlorë- Dhërmi (sipas projekteve prioritare të Ministrisë së Transporteve 2014).

### **Rrjeti i rrugëve kryesore**

Po punohet për by-passin e Vlorës që lidh autostradën Levan – Vlorë Sh8 me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjatësia e këtij aksi është 29 km dhe fillon tek rrethrotullimi në fund të rrugës Levan-Vlorë dhe shmang qytetin duke kaluar në Veri të tij duke përfunduar në Orikum.

#### ▪ *Udhezime për infrastrukturen e sistemit rrugor*

Per përmirësim e lidhjeve nëpërmjet rrugëve ndër-rajonale janë identifikuar disa projekte;

- Përfundimi i bypass-it të Vlorës
- Përmirësimi i rrugës hyrëse në Radhimë
- Përmirësimi i Rrugës hyrëse ne Orikum
- Rehabilitimi i rrugës për në Pashaliman
- Rehabilitim i rrugës Orikum-kisha e Marmiroit
- Lidhjet rrugore të brendshme të Vlorës me SH4. Lidhshmëria e rrugës ekzistuese Peshkëpi-Selenicë me SH4
- Konektiviteti I Petroliferës së Vlorës. Sigurimi I një lidhje të drejtpërdrejtë midis Petroliferës së Vlorës dhe rrugës nacionale
- Projekt i rrugës së Lumit përgjatë luginës së Shushicës
- Ndërtimi i rrugës lidhëse Babicë-Selenicë

Per përmirësim e rrugëve dytësore që lidhin fshatrat me Vlorën janë identifikuar keto projekte;

- Përmirësimi i lidhjes së fshatrave me rrugët kryesore
  - Çezma e Llakatundit-ura Grabjan Shushicë
  - Kryqi-lagja Mehalle, Drithas ,Shushicë
  - Qëndër Drithas-Varreza, Shushicë
  - Ura Grabjan-Rezervuar, fshati Shushicë
  - Lagja Komitet-Qëndër fshati, Mekat-Kisha Shushicë
  - Bunavi Shushicë
  - Hidrovor - Akerni, Novosele
  - Skrofotine, Novosele
  - Aliban, novosele
  - Qëndër Llakatund-Pompa Llakatund, Shushicë
  - Qëndër Shushicë –Beshisht, Shushicë
  - Lapidari Çeprat-Qëndër Çeprat , Shushicë
  - Qëndër Novoselë
- Ndërtimi i një unaze lidhëse me fshatrat e Panajasë (Panaja-Bestrovë-Kërkovë-Hoshtimë)
- Ndërtimi i rruges lidhëse midis Bishisht-Trevëllazër
- Krijimi i një lidhje midis Babicës së vogël me rrugën e vjetër kombëtare (Bestrovë)

- Ndërtimi i një rruge nga Kanina në shëtitoren bregdetare të Vlorës

Per përmirësim e sistemit të rrugëve urbane në Vlorë janë identifikuar 6 projekte:

- Hyrje e re për në Portin e Vlorës (zgjerimi I Transballkanikes)
- Zgjerim i rrugës Pelivan Leskaj
- Zgjerim i rrugës nga kryqëzimi i Vlorë-Kaninës deri tek Shkolla e Marinës në Shëtitoren bregdetare
- Ndërtimi i një rruge të re paralele me shëtitoren bregdetare
- Shtrimi i rrugëve të qytetit që janë në gjendje të keqe
- Shtrimi i rrugës së unazës perëndimore në qytetin e Vlorës

#### *Rivitalizimi i qendrave urbane dhe rurale te bashkise Vlore*

Rivitalizimi i qendrave urbane do te realizohet nepermjet nje seri projektesh te propozuara te cilat synojne aksesueshmerine, levizshmerine, rijetezimin ne pjese te harruara te qytetit dhe zgjerrimin e shetitores ne pjesen urbane te bregdetit.

- Programi i akupunkturës (acupuncture) urbane për qendrën e Vlorës
- Restaurimi i fasadave të ndërtesave përgjatë bulevardit kryesor
- Ndërtimi i trotuareve, ndriçimit publik dhe infrastrukturës përcjellëse në zonën e Topanase
- Krijimi i një rruge restorantesh tradicionale (Jani Koncari/ Kontandin Kristoforidhi)
- Transformimi i Pazarit të Vjetër (Kulla e Sahatit) në një Pazar Artizanal
- Zhvillimi i një amfiteatri për aktivitete sociale në kështjellën e Kaninës
- Krijimi i parkut të madh urban të qytetit në ish- zonën e aeroportit ushtarak i dedikuar për fëmijët me sporte, laboratorë shkencor, hipizëm, rezervuarë uji, kopsht botanik (Parku Kreativ Mesdhetar: Fëmijët e Gëzuar)
- Krijimi i një shëtitoreje të gjatë dhe i një zone plazhi publik me objekte rekreative përgjatë gjithë ballinës-ujore urbane të Vlorës
- Përmirësimi i hapsirave publike nëpër fshatra, krijimi i qendrave lokale në zonën e fshatrave
- Rikualifikimi i hapësirave publike dhe i blloqeve me banesa të braktisura në fshatrat malor
- Krijimi i shëtitores bregdetare dhe i fasiliteve përgjatë ballores së plazhit të Orikumit

#### **Njesia administrative Oender**

##### ***Rruget e reja urbane te propozuara:***

*Rruget Urbane Primare* : Bestrova (53 m);

*Rruget Urbane Sekondare*: Panaja (971 m); Hoshtima (660 m); Kerkova (595 m); Babica e Madhe (500 m); Narta (1831 m).

*Rruget Urbane Terciare*: Panaja (565 m); Hoshtima (885 m); Kerkova (798 m); Bestrova (1327 m); Babica e Madhe (500 m); Babica e Vogel ( 582 m); Xhyherine (1088

m); Sherishte (3569 m); Kanina (925 m); Narta (1346 m); Zvernec (4026 m).

*Rruget urbane te propozuara per **Rehabilitim**:*

*Rruget Urbane Primare* : Panaja (2025 m); Hoshtima (826 m); Kerkova (963 m);  
Bestrova (676 m); Babica e Madhe (1849 m); Sherishte  
(1568 m); Narta (2069 m); Zvernec (832 m).

*Rruget Urbane Sekondare*: Hoshtima (908 m); Kerkova (276 m); Babica e Madhe (1874 m);  
Xhyherine (745 m); Sherishte (1020 m); Kanina (2211 m); Narta  
(4517 m); Zvernec (4026 m).

*Rruget Urbane Terciare*: Panaja (1598 m); Hoshtima (999 m); Kerkova (1301 m); Bestrova (792  
m); Babica e Madhe (10510 m); Babica e Vogel (1188 m);  
Xhyherine (2253 m); Sherishte (4950 m); Kanina (3180 m); Narta  
(3273 m) - ( per plotet e reja ska ende rruge) (2591 m – pedonale,  
kalldrem);  
Zvernec (1458 m).

▪ **Njësia administrative Shushicë**

Rruga kryesore e qendrës administrative është e shtruar (vetem 5 km) ndërsa rreth 95 % e saj është e pashtruar dhe në kushte të vështira.

*Rruget urbane te propozuara per **Rehabilitim**:*

*Rruget Urbane Primare* : - **Shushicë** (4,5 km)

*Rruget Urbane Sekondare*: - **Bunavi ,Beshisht, Grabian** - Gjithe rrjeti rrugor për fshatrat i pa strukturuar

- **Mekat, Çeprat** (2,2 km)

- **Kthesa Ceprat - Qender Ceprat** (1.1 km)

- **Risili - Qafa E Kociut - Risili - Llakatund** (8.3) km

*Rruget Urbane Terciare*:: - **Drithas**- pjeset te segmentit rrugor te fshatit Drithas per t'u asfaltuar

- **Llakatund** - rrugët e brendshme të fshatit per t'u asfaltuar

▪ **Njësia administrative Novoselë**

Ndër të metat e sistemit rrugor të njësisë Novoselë është fakti se rrugët që të çojnë në bregdet janë të pasistemuara dhe në gjendje të keqe, gati të pakalueshme sidomos në stinët me reshje.



***Rruget urbane te propozuara per Rehabilitim:***

Rruget Urbane Primare : **Shushicë** (4,5 km)

- Rruget Urbane Sekondare:
- Rruga kryesore e njësisë **Novoselë** që kalon përgjatë fshatrave Aliban, Fitore deri në Bishan, Delisufi, Dellinjë (12 km) ka nevojë per ndricim
  - **Bunavi ,Beshisht, Grabian,** Gjithe rrjeti rrugor për fshatrat i pa strukturuar
  - **Mekat, Çeprat** (2,2 km)
  - **Risili - Qafa E Kociut - Risili - Llakatund** (8.3km)
  - **Mifoli**, ka nevojë per t'u asfaltuar
  - **Akërne**, Rruga hyrese ne Akërne me gjërësi (5.0m)

ka nevojë per t'u asfaltuar.

- **Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë,** rruget kane nevojë per t'u asfaltuar
- **Novosela -Akerni-Poro** (9.0km)
- **Fitore - Bishan \_Poro -Delisuf** (10,5km)
- Segmenti **Bunavi e Sipërme - Bestrovë** (2.7 km)

- Rruget Urbane Terciare:*
- **Drithas**, pjeset te segmentit rrugor te fshatit drithas per t'u asfaltuar
  - **Llakatund** - rrugët e brendshme të fshatit per t'u asfaltuar
  - **Kthesa Ceprat** - Qender Ceprat (1.1 km)

▪ **Njësia administrative Orikum**

Për njesinë administrative Orikum mund të thuhet se sistemi rrugor nuk është edhe aq problematik. Të gjitha fshatrat lidhen me rrugën nacionale me rrugë automobilistike.

***Rruget urbane te propozuara per Rehabilitim:***

*Rruget Urbane Sekondare:* - **Tragjasin e vjeter**, rruga nuk është në kushte të mira, ka nevojë per t'u asfaltuar.

- Radhimë pjesa e poshtme, pjesa e rrugës nacionale ka nevojë mirëmbajtje

## **3.2 Rrjeti i propozuar i infrastruktures së shërbimeve publike**


Shumica e sistemeve të infrastrukturës (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), do të vendosen në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, çdo sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të nderpritet nga një sistem tjetër - si psh., kullimi dhe

kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot. Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Në lagjet e qytetit do të behen zgjerime me degëzime perpendikulare në drejtim të lagjeve. Lidhjet merrjetin duhet të bëhen në korridorët sekondarë më të afërttë linjës kryesore qendrore. Monitorimi i rregullt icilësisë së ujit të pijshëm, të parametrave kimike dhe mikrobiologjikë duhet të bëhet në vazhdimësi në stacionet epompimit, si edhe në pikat fundore të çdo degëzimesekondar.

Relievi i Vlores është faktor përcaktues për sistemin e kullimit të gjithë zones. Në zonat e vendosura në shpate kodrash, graviteti dhe forma natyrore e shpatit do të përdoret për kullimin dhe furnizimin me ujë. Në zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat e identifikuar me rrezik për përmbytje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, në sipërfaqe për të parandaluar çdo përmbytje të zonave të ulta.

Me studimin e Vlores, bashkia do të mund të realizojë rehabilitimin e sistemit të kanalizimeve ekzistuese, sikurse zgjerimin e rrjetit në mënyrë që të lidhë të gjitha zonat e banuara me rrjetin kryesor të kanalizimeve. Trajtimi i sotëm mekanik i ujërave të ndotura duhet të mbyllet/përmirësohet dhe trajtimi i kombinuar mekaniko - biologjik duhet të ndërtohet.



**Figura 6 Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore**

### *Sistemi i kanalizimeve*

Do të ndjekë aksin qendror të infrastrukturës. Për ndërtimet e reja (dhe infomale) ata do të lidhen në zgjerimet e rrjetit grumbullues sekondar dhe terciar, ndërsa gropat ekzistuese septike duhet të monitorohen/rehabilitohen/mbyllet në mënyrë që të shmangët ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore. Meqënëse kjo do të kërkojë investime të mëdha, është propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit të përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe parametrave të

cilësisë (p.sh. marrja e mostrave në rrjet, në vendin dhe në kohën e duhur për CSB, E.coli, etj). Në këtë mënyrë mund të arrihet me zbutjen e situatës së tanishme.

#### *Energjia elektrike dhe telekomunikacioni*

Kabllot duhet të vendosen në një kanal në njërën anë të rrugës në mënyrë të rregullt. Tubat ujore (të kullimit, kanalizimeve dhe të furnizimit me ujë), duhet të kalojnë në anën e kundërt. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen pranë sipërfaqes (për të parandaluar kontaminimin e mundshëm nga ujërat e ndotura urbane dhe ato të kanalizimeve), tubat për ujërat e ndotura urbane/industriale në mes dhe kanalizimi më poshtë.

#### *Infrastruktura ujore*

Zgjidhja më e mirë për infrastrukturën ujore duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro - ekonomike afatgjate të burimeve të ujit, duke marrë parasysh të gjitha burimet sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore. Kjo punë tashme ka filluar me Studimin e Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), të cilat mbulojnë të gjithë zonën në jug, nga qyteti i Vlorës në Sarandë. Meqenëse investimet afatgjata duan kohë dhe vlera të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, për të mbuluar sa më shumë të jetë e mundur zonat e populluara.

### **3.2.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë**

#### *Vlerësimet e kushteve hidrogeologjike dhe hidrologjike*

Vlerësimi i rrjetit hidrografik dhe burimeve nëntokësorë të ujit në zone, i kapaciteteve të tyre dhe mundësitë për projekte në perspektivë të zhvillimit të infrastrukturës ujore, janë bazuar në studimet ekzistuese, si edhe në disa studime të ndërmarra rishtazi në zonë.

#### *Situata hidrologjike*

Zona e studimit përshkohet nga një numër rrjedhash ujore, ku më i rëndësishmi është *Uji*, i cili merret nga burimet e shumta nëntokësore që përshkojnë pjesën jugore të qytetit Vlores, ku me të rëndësishmit ndodhen në zonën e Ujit të Ftohte (Tyneli), në zonën pas Vilave dhe tek Kalaja. Këto burime nepermjet pompave kalojnë ujin nga zona e Ujit të Ftohte në lagjen 10 korriku e më pas në depot në Kuzum Baba dhe të Bishti i Kalldremit e më pas nepermjet rrjetit shperndares kryhet furnizimi me ujë. Rrjeti i shperndarjes ka humbje të shumta.

Bazuar nga sa u përmend më sipër, mund të thuhet se shfrytëzimi i burimeve ujore në zonën e studimit *nuk* janë përdorur mjaftueshmerit për të përmbushur kërkesat për ujë, që rrjedhin nga një konsumim në rritje të tij në të ardhmen, *duke pasur parasysh* kërkesat në rritje nga zhvillimi i turizmit.

Konsulenti mendon se shërbimet definitive të furnizimit me ujë në zonën e projektit duhet të zgjidhen në një fokus më të gjerë hapësinor, ekonomik dhe teknik dhe jo duke u përqendruar në çdo njësi në veçanti. Zgjidhjet e veçanta dhe lokale duhet të mbështeten dhe të zbatohen, duke ju referuar zgjidhjes përfundimtare të të gjithë territorit të Bashkisë Vlore, ose edhe më gjerë, gjithmonë nëpërmjet studimeve të thella dhe të detajuara të burimeve ujore, jo vetëm në zonën e bashkisë Vlore. Ky koncept do të çojë në përdorimin më të mirë të mundshëm të pasurive ujore për zhvillimin e duhur perspektiv të këtij territori.

Uji inxjerrë nga pusët e cekëta shtetërore dhe private të hapura, është shpesh i ndotur për shkak edhe të efekteve infiltruese të ujërave të zeza, duke bërë që direktivat përkatëse të BE-së 80/778/EEC dhe 98/83/EEC të mos jenë plotësuar deri me sot. Kjo situatë rrezikon drejtpërdrejtë dhe në vazhdimësi shëndetin e njeriut, prandaj kërkon t'i jepet prioritet i lartë kapërcimit të këtij problemi.

#### *Mundësitë e furnizimit me ujë*

Zgjidhja më e mirë për infrastrukturën ujore duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro - ekonomike afatgjate të burimeve të ujit, duke marrë parasysh të gjitha burimet sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore. Kjo punë tashme ka filluar me Studimin e Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), të cilat mbulojnë të gjithë zonën në jug, nga qyteti i Vlorës në Sarandë. Meqenëse investimet afatgjate duan kohë dhe vlera të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, për të mbuluar sa më shumë të jetë e mundur zonat e populluara.

Sikurse u përmend edhe më sipër kjo do të arrihet nëpërmjet investimeve të konsiderueshme. Aktualisht duhet propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe atyre të parametrave të cilësisë së ujit (p.sh. përcaktimit të vendeve dhe kohës për marrjen mostrave të ujit, CSB, E.coli). Në këtë mënyrë mund të zbutet pakënaqësia për cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë.

Detyra kryesore e pushtetit lokal në infrastrukturën e ujit është që të fokusohet në:

- (a) përmirësimin e situatave ekzistuese (afatshkurtër);
- (b) përgatitja e zgjidhjes përfundimtare lokale apo rajonale (afatgjatë);

Natyrisht mënyra e sipërmendur do të varej nga mbështetja financiare dhe institucionale, si edhe bashkëpunimi në nivel qendror dhe lokal. Krahas perspektivës së furnizimit me ujë, Bashkia duhet të jetë e përqendruar në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, përmes:

- (i) kontrollit dhe furnizimit me cilësinë e ujit (p.sh. përcaktimin e vendndodhjes dhe kohës për marrjen e mostrave të ujit, CSB, E.coli);
- (ii) zgjerimit dhe furnizimit me ujë dhe rrjetin ekzistues të kanalizimeve për të mbuluar shtëpitë e reja;
- (iii) eliminimin e të gjitha rrjedhjeve të ujit;

- (iv) instalimi i matësave të ujit (ujëmatësve);
- (v) përmirësimi i shpërndarjes së ujit;
- (vi) rritja e masave të menjëherëshme për mbledhjen e taksës së ujit, për shërbimet e ujit, duke u përqendruar në çështjet e rëndësishme institucionale dhe parametrat e cilësisë së ujit.

### *Infrastruktura e ujit të pijshëm*

#### **Qyteti Vlorë**

Rrjeti i shpërndarjes së ujit të pijshëm është shumë i amortizuar. Nëpërmjet investimit hollandez me një vlerë prej 24 milion Euro është mundësuar depo e madhe e ujit me kapacitet 6000m<sup>3</sup> së bashku me rrjetin shpërndarës nga stacioni i pompimit në Ujin e Ftohtë tek depo mbi Bishtin e Kalldrëmit.

Eshtë parashtruar në projektet prioritare marrja e masave për realizimin dhe plotësimin e kërkesës për uji të pijshëm me të gjitha parametrat e tij sipas normës së përcaktuar nga strategjia kombëtare e UK me një sasi prej 150l/ditë në të gjithë territorin e bashkisë dhe rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit ujësjellës dhe atij kullues.

Ndërhyrjet specifike për përmirësimin e sistemit të furnizimit me uje të pijshëm për çdo njësi do të jenë si më poshtë:

#### **Njësia administrative Qendër Vlorë**

**Bestrovë:** Zevendesimi i gjithë rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm i cili është totalisht i amortizuar.

**Kërkovë:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Panajaja:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Shtim i depove të ujit.

**Hoshtimë:** Përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Babicë:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. ( Babicë e madhe 5,4 km dhe Babicë e vogël 3,4 km). Shtim i depove të ujit.

**Xhyherinë:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm (3,7 km). Shtim i depove të ujit.

**Sherishte:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm (2 km).

**Kanina:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm (5 km).

**Zvërnec:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm (8 km). Shtim i depove të ujit.

**Nartë:** Zevendesim dhe përmirësim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

### **Njesia administrative Shushice**

**Shushicë:** Permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Llakatund:** Permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Mekat:** Permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Shtim i depove të ujit.

**Grabian:** Zevendesim dhe permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Fshati Bunavi:** Zevendesim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Shtim i depove të ujit.

**Risili:** Permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Drithas:** Permiresim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm.

**Beshisht:** Zevendesim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Shtim i depove të ujit.

### **Njesia administrative Novosele**

Njësia administrative Novoselë identifikohet si një zonë ujëmbajtëse me kapacitet të lartë të mundësive të prodhimit të ujit të pijshëm jo vetëm për nevojat e popullatës por edhe me mundësi të furnizimit të fshatrave të komunës Qendër si dhe të qytetit të Vlorës. Ajo furnizim dhe Aliban dhe Akërni. Novosela e merr furnizimin direkt nga rrjeti. Po kështu fshatrat Çerkovinë, Skroftinë e Mifol e marrin nga daljet që janë lenë në linjën e dërgimit të Panajase . Trevllazeri furnizohet nga depoja që e merr ujin nga stacioni i pompave në Skroftinë.

Zevendesim dhe permiresim i tubacione kryesore për shkak të kohës së gjatë të gjatë e gjatë e shërbimit. I nevojshëm çpimi i puseve të reja.

Në vitet e fundit është investuar për përmirësimin në gjendjen e infrastrukturës të ujit të pijshëm të njësisë. Kështu janë realizuar:

Rindërtimi ujësjellësit Delisuf

Rikons. ujësjellësi Mifol

Ujësjellësi Novosele

Ujësjellësi Çerkovinë


Ujësjellësi Shamogjinë Panaja

Rikons. ujësjellësi Skroftinë

Problematika e furnizimit me ujë për këtë njësi konsiston në sigurimin e kapacitetit prodhues të stacionit të ujit. Në këtë mënyrë garantohet furnizimi i popullatës në prespektivë dhe sigurohet sasia e nevojshme e ujit të pijshëm për strukturat e ardhme të turizmit dhe të aktiviteteve prodhues që do instalohen në zonë.

### **Njësia administrative Oriku**

**Ujësjellësi i ri furnizon me ujë 24 Orë Oriku qendër, Radhimë, Dukat i Ri, Tragjas pjesërisht. Biznese të vendosura buzë detit përgjatë Oriku e marrin ujin nga Pashë Aliman.**



Harta 13-Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar

### 3.2.2 Rrjeti i propozuar i kanalizimeve

#### *Sistemi i kanalizimeve*

Në sistemin e kanalizimeve të qytetit Vlorë investimi kryesor ishte projekti në kuadrin e programit PHARE, i cili përfshinte ndërtimin e kolektorëve kryesorë të ujërave të zeza (me diam që varion 800 - 1000 - 1200mm) dhe sistemin e trajtimit të tyre. Për këtë sistem janë ndërtuar 6 stacione pompimi dhe nëstacione elektrike që shtyjnë drejt hidrovorit mbetejet e qytetit. Sistemi sot është pjesërisht në funksion. Ndërkohë u ndërtua sistemi i trajtimit të ujërave të zeza, i cili ende nuk është në funksion. Faza e dytë e projektit mundësoi lidhjet e zonës nga akademja deri tek 7 pallatet, rrjeti sekondar me atë kryesor, si dhe i njëjti zbatim për zonën e Skelës. Pritet të zbatohet faza e tretë dhe e katërt që parashikon lidhjet e rrjetit sekondar në zonat e rrugës transballkanike, aviacionit, lagjes 1 Maj, 24 Maj, Qeriba Derri e Bashkimi. Investimi për këto dy faza kap një vlerë afërsisht 13,5 milion Euro.

Qyteti ka rrjetin ekzistues të kanalizimeve nga uji i ftohtë deri tek impianti i përpunimit. Është në projektet prioritare rivënia në punë me kapacitet të plotë dhe rritja e kapacitetit të trajtimit të ujërave të zeza në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në qytetin e Vlorës.

Po ashtu rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e tyre në zonat e zhvillimit informal është projekt i propozuar nga plani.

#### *Sistemi i kullimit*

Zona ka stacione pompimi dhe disa kanale me rrjedhje të lirë. Hidroçtacioni i Vlorës gjendet në jug të kufijve të kompleksit lagunor. Ai kullon një sipërfaqe prej 1 000 ha. Kapaciteti pompues është afërsisht 16 000l/s. Uji shkarkohet në det.

Pastrimi i kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin kullues.

Ndërhyrjet specifike për trajtimin e ujërave të ndotur për çdo njësi do të jenë si më poshtë:

#### *Njësia administrative Qendër*

**Bestrovë:** Rikonstruksioni i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

**Kërkovë:** Rikonstruksioni i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

**Panajaja:** Ndertim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

**Hoshtima:** Ndertim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

**Babicë:** Ndertim dhe përmirësim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.



**Xhyherinë:** Rikonstruksion i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike

**Sherishte:** Ndertim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike

**Kanina:** Rikonstruksion i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike

**Zvërnec:** Rikonstruksion i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike

**Nartë:** Ndertim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike..

### *Sistemi i ujitjes*

Rezervuarët e ujërave të ëmbla që gjenden në fshatrat e Vlorës (si në Bestrovë, Zvërnec , Novosele, Poro etj) kanë një rëndësi të dyfishtë për zonën. Së pari shërbejnë si i vetmi burim uji i ëmbël për faunën dhe së dyti edhe si burim uji për ujitje për tokat. Pastrimi i kanaleve lidhëse me detin dhe shtimi i ujërave te embel do te permiresojne ndjeshem situaten

### *Sistemi i vaditjes*

Stacioni i Gorricës gjendet në pjesën lindore të Nartës. Ai drenazhon një sipërfaqe prej 1 000 ha. Kapaciteti pompues është afro 16 000 l/s. Uji derdhet në lagunë.

### *Njesia administrative Shushice*

Rikonstruksion i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike

### *Sistemi i ujitjes*

Sot ujitin 450 ha tokë bujqësore, nga të cilat 350 ha në fshatrat Risili, Çeprat, Grabian Shushicë e Llakatund me veprën ujitese: "Kanali i Penkovës" me nje gjatësi prej 9 km me rrjedhje te lirë.

Fshati Bunavi ujit rreth 100 ha tokë nga rezervuari pranë ketij fshati nëpermjet kanaleve me gjatësi 7 km.

Vepra e marrjes së ujit nga lumi Shushicë deri tek kanalet e treta ujitëse janë në varesi të Bordit të Kullimit.

Kanalet e treta të ujitjes dhe kullimit në ngarkim të fermereve dhe Bashkisë, kanë një gjatësi 12 km.

### ***Sistemi i kullimit***

Kanalet kryesore kullues të Llakatundit, ku futen kolektorët dhe kanalet e para e të dyta kulluese janë në varësi të Bordit të Kullimit ku nevojitet pastrimi dhe permiresimi i kaneleve te kullimit, kurse kanalet e treta kulluese, rreth 6 km janë në ngarkim të fermereve dhe Bashkisë.

### **Njësia administrative Novoselë**

**Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Trevllazër, Çarkovinë, Skrofotinë, Akërnj:** Ndertim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

**Novoselë:** Permiresim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur.

**Fitore, Aliban:** Rikonstruksion i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

Janë bërë disa investime të mëparshme për zgjerimin e rrjetit në fshatrat e njësisë si:

Ndërtim KUZ Firore

Ujra të bardha Mifol

Kanalizim i Ujrave të bardha ne fshatin Fitore

Iniciativat e qeverisjes qëndrore momentalisht janë fokusuar në zgjidhjen e problemit të ujrave të zeza për qendrat e mëdha urbane dhe është i nevojshëm krijimi e hapsirave teknike për ndërtimin e impianteve purifikuese të ujrave të zeza.

### ***Sistemi i kullimit***

Hidrostacioni i Akërnisë ka një kapacitet pompimi prej 11 000l/s dhe kullon 6 500 ha. Gjendet në pjesën veriperëndimore të kompleksit lagunor. Pjesa kryesore e ujit hidhet në det dhe një pjesë e vogël hyn në pjesën lindore të Nartës. Pastrimi i kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë do te permiresje ndjeshem kapacitetin kullues duke sghmangur keshtu edhe rrezikun e permbytjeve.

### ***Sistemi i ujitjes***

Kanalet vaditetse të pa mirembajtur për 25 vjet dhe vetëm sivjet filluan të pastrohen. Nevojiten nderhyrje per mirembajtjen dhe pastrimin e ketyre kanaleve per te rritur pjellorine e tokes.

### **Njesia administrative Orikum**

**Orikumin e vjeter:** Permiresim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur.

Pjesa tjeter e fshatrave funksionon me gropa septike. Me fonde te bankes Islamike po ndertohet impianti i perpunimit te ujerave te ndotur per ti sherbyer nje popullsie prej 55.000 banore me nje siperfaqe 2ha dhe kapacitet 4000m<sup>3</sup>/dite.

**Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë :** Ndertim i rrjetit te infrastrukturës së ujërave të ndotur dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

Projektet e infrastrukturës ujore dhe kanalizimeve në vendbanimet e Bashkisë Vlore përshkruhen në listën e projekteve, të grupuara në katër lloje të ndërhyrjeve të nevojshme (si më poshtë). Projektet specifike do të bazohen në studimet e fizibilitetit përkatëse, sipas kushteve të vendbanimeve.

Tipi i ndërhyrjes së nevojshme të kërkuar:

1. Zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet ekzistuese për të mbuluar të gjithë zonën e populluar/sigurimin e impiantëve të trajtimit për çdo njësi banimi, në funksion të kushteve;
2. Ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura: (i) të veçantë për çdo zonë ose (ii) impiant trajtimi të përbashkët me zonën bashkëngjitur.
3. Ndërtimi i objekteve sanitare turistike në afërsi të plazhit, tualet publik lidhur me impiantin e trajtimit më të afërt, (ii) impiant kompakt i ndarë.
4. Ndërtimin e impiantëve kompakt të parafabrikuar ose gropave septike të rregullta për shtëpitë e veçuara.

Në fazën e dytë të trajtimit radikal duhet të realizohet rehabilitimi, kontrolli, ose heqja e gropave septike në afërsi të objekteve ujore/stacioneve të pompimit dhe respektimin e standarteve të funksionimit dhe menaxhimit të mbetjeve të tyre. Në çdo rast duhet të ekzistojë monitorimi sistematik i cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe atij në rrjetin e furnizimit. Monitorimi i rregullt dhe permanent i parametrave kimike dhe mikrobiologjike për cilësinë e ujit të pijshëm duhet të respektohet dhe zbatohet.

*Udhëzues për projektet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet*

*A. Faza e projektim/planifikimit:*

- Duhet bërë një studim kompleks (ekonomik, hidrogeologjik, social), që të ofrojë më shumë se një alternativë. Më i miri duhet të zgjidhet bazuar në:
  - a. koston;
  - b. mundësitë e financimit;
  - c. kohës së zbatimit;
  - d. kostove të funksionimit;
  - e. teknologjisë;
  - f. fleksibilitetit të funksionimit të rrjetit, etj.
- Zbatimi në faza i planit, sipas burimeve të financimit.
- Ndarjen e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në seksione, bazuar në njësitë hidraulike (burim, puse, vepërmarrje);

- Disa fshatra të Bashkisë së Himarës mund të kenë rrjete të përbashkëta kolektorësh të ujërave të zeza, në varësi të kushteve duke bërë vlerësime për çdo rast dhe sigurisht i realizuar/zbatuar në faza.

*B. Faza e zbatimit:*

- Të gjitha projektet parciale duhet të marrin në konsideratë studimin afatgjatë dhe rajonal të furnizimit me ujë.
- Monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pijshëm nëpërmjet analizave kimike dhe bakteriologjike (sipas kriterëve të Këshillit të Evropës).
- Shpërndarje dhe menaxhim sa më të mirë të ujit për një funksionim sa më të mirë të sistemit;

Duke ditur që investimet afatgjata kërkojnë kohëdhësi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme, që investimet afatshkurtra dhe *afatmesme në infrastrukturë* të jenë të fokusuara në zgjerimin errjetit të shpërndarjes së ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur zona të banuara.

*Përmirësimi i gjendjes aktuale duhet të ndjekë aktivitetet/projektet e mëposhtme:*

- Detajimi i një programi investimesh në bazë të vlerësimit realist të kostove përkatëse.
- Përmirësimi i shpejtë afatshkurtër që mund të zbatohet deri në tre vjet, për të minimizuar ndryshimin midis nevojës/kërkesës për ujë dhe pasurisë ujore të zonës, *e financuar nga qeveria qendrore/lokale*;
- Hartimi i një plani infrastrukturor afatmesëm dhe afatgjatë, që mund të plotësojë nevojat për ujë familjar, industrial, tregtar dhe atë të sektorit të turizmit, *të financuar nga qeveria qendrore ose donatorët*;
- Formulimi dhe miratimi i një rregulloreje për trajtimin e ujërave të ndotura për shërbimet e reja, hotelet dhe apartamentet (*për më shumë se 20 shtretër/persona*) për:
  - a. Ndërtimin nga ana e tyre të impiantëve biologjikë të trajtimit të ujërave të ndotura;
  - b. Funksionimin e tyre nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e inspektoratit publik të bashkisë;
  - c. Ujërat e mbetura pas trajtimit të derdhen në përrenj ose të filtrohen në tokë pa efekte ndotëse;
  - d. Të organizohet në mënyrë permanente largimi i mbetjeve fekale sipas një rregulloreje përkatëse, e monitoruar gjithmonë nga inspektorati bashkiak.
- Për hotelet/shtëpitë “BB” apo dhomat me qera, me më pak se 20 shtretër duhet të formulohet dhe miratohet një rregullore për:
  - a. Ndërtimin e impiantit të tyre bashkëkohor të trajtimit të ujërave /gropa septike pa efekte mjedisore;

- b. Pastrimin/shkarkimin permanent të gropave septike individualisht apo të organizuara nga bashkia (kundrejt një takse të caktuar).
  - c. Organizimin e derdhjeve të këtyre gropave në një rrjedhë tëpercaktuar/kanal.
- Kontrollin, rehabilitimin ose mbylljen e gropave septike në afërsi të burimeve ujore apo stacioneve të pompimit;
  - Zbatimi i standardeve për funksionimin dhe menaxhimin e mbetjeve;
  - Në çdo rast duhet të ketë kontroll sistematik të cilësisësë ujërave në rrjetin e furnizimit me ujë.

#### *Konceptimi i kostos për projektet e propozuara*

##### *Për furnizimin me ujë*

Kostoja eprojekteve të veçantado të kërkojë një studim rajona Itë fizibilitetit dhe do t'i referohet zgjidhjes dhe teknologjisë përkatëse, e pranuar nga qeveria dhe pushteti vendor.

Kostoja në vetvete është funksion i:

- a) Numrit të popullsisë që do t'i shërbejë;
- b) Kërkesës specifike për ujë;
- c) Relievit të zonës;
- d) Teknologjisë dhe materialit të përdorur;
- e) Pronësisë mbi tokën, etj.

Në stadin e këtij studimi, bazuar dhe në informacionin që disponojmë mund të themi se, sikurse u përmënd edhe në raport, Konsulenti është i mendimit për një zgjidhje rajonale të furnizimit me ujë dhe atij të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura. Për një vlerësim të shpejtë mund të merren në konsideratë kostot aktuale të përafërta për këto lloje punimesh si:

- a) Kosto për furnizim për vendosjen e tubacionit DN nga 150 - 900 në 330-350 Euro/m;
- b) Kosto njësi për rezervuarët me kapacitet 1000 m<sup>3</sup> deri 170.000 - 200.000 Euro.

Kostoja progresive duhet të marrë në konsideratë koston e veprës së marrjes, stacionet e pompimit dhe puseve, të cilat të gjithasë bashku formulojnë kostone projektit për çdo projekt të furnizimit me ujë.

*Për ujërat e ndotura:* për projektet e largimit dhe të përpunimit të ujërave të zeza, kostoja e projekteve të veçanta do të kërkojë një studim rajonal të fizibilitetit për mundësitë e zgjidhjes për çdo zonë të Bashkisë së Vlores. Ajo do të jetë në varësi të zgjidhjes së propozuar dhe teknologjisë së përdorur, të pranuar nga qeveria dhe pushteti lokal.

#### **Menaxhimi i Lagunës, Lumenjve dhe Kanaleve**


**Laguna e Nartës** është një nga trupat ujore më të studiuara në zonë. Plani i Menaxhimit për zonën e peizazhit të mbrojtur Vjosë-Nartë i hartuar nga GEF/UNDP ka përcaktuar qartë drejtimit kryesore të menaxhimit dhe duhet zbatuar në masën 100%. Sidoqoftë kujdes i veçantë duhet bërë në drejtim të mirëmbajtjes së kanaleve komunikuese me detin, kontrollit të të gjithë parametrave

fiziko-kimikë të ujit në mënyrë periodike, peshkimit në lagunë, gjuetisë, ndikimit të kripores në afërsi të lagunës së Nartës dhe zhvillimit të kontrolluar të zonës përreth saj.

Mbajtja/ruajtja e lumenjve: Qëllimi kryesor i ruajtjes/mbajtjes së ujit të lumit është për të rivendosur rrjedhën natyrale dhe historike të ujit të pastër të lumit. Një nga problemet kryesore është fakti se rrjedhat e lumenjve të zonësparaqesin në zona të caktuara rrezikshmëri lidhur me përmbytjen e tokave përreth duke rrezikuar edhe tokat. **Lumi disa herë ka përmbytur zonat përreth duke shkaktuar dëme të mëdha në kompanitë e inerteve dhe në ekonomitë e vogla bujqësore. Marrja e masave apo hartimi i një plani menaxhimi sipas standardeve paraqitet në nevojë e ngutshme për lumenjtë e zonës. Këto masa duhet të sjellin parandalimin e hedhjes së mbeturinave, parandalimin e derdhjes së ujërave të zeza në luginën e lumit si dhe reduktimin e nxjerrjes së inerteve nga lugina e tij. Një plan i gjerë menaxhimi ku të përfshihen të gjitha Komunitat dhe bashkitë që kontribuojnë në ndotjen e tij do e shndërronte atë si pjesa prej 80 km e tij që gjarpërojnë. Puna rehabilituese duhet të sigurojë vazhdimësinë e shtratit dhe të rrjedhës ujore të lumit, ndërkohë që duhet të kontrollohen shkarkimet e objekteve të ndryshme, që ndodhen rreth tij. Është e rëndësishme të theksohet se planet duhet të specifikojnë standardet e cilësisë së ujit, në veçanti ato të BE-së për trupat ujore, si edhe hapat e nevojshme që duhet të ndërmerren për t'i arritur ato. Një numër masash urgjente, përveç gjositjes, duhen ndërmarrë për të parandaluar një katastrofë ekologjike.**

### ***Ujitja dhe Kullimi***

Skemat e rehabilitimit të lumit duhet të marrin në konsideratë problemet e kullimit, të pritave malore, dhe ato të përmbytjeve në një mënyrë sa më të plotë. Parametrat e kullimit duhet të plotësohen sa më shumë të jetë e mundur duke synuar ruajtjen e rrjedhës natyrore të lumit, mbrojtjen e pasurive natyrore dhe peizazhin nga dëmtimi.



Harta 14-Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar

### 3.2.3 Rrjeti i furnizimit me energji dhe telekomunikacioni

#### Qyteti Vlorë

Qyteti aktualisht mbulon nevojat për energji nga:

Nenstacioni Vlora 1 110/35/20/6kv;

Nenstacioni Vlora 2 110/20kv;

Nenstacioni Uji i Ftohte 35/6kv;

Nenstacioni Skele 35/6kv;

Dhe gjithashtu për gjithë bashkinë janë edhe nenstacionet Nenstacioni Smokthine 35.10kv; Nenstacioni Gorisht 35/6kv

Zona e studimit të jugut mbulohet kryesisht nga një njësi prodhimi: Vlorë për pjesën veriore (Vlorës deri në Borsh). Në shumë zona, rrjeti është i vjetër dhe akoma punon në kushte teknike antike me 35 Kv për tensionin e 'lartë' dhe 10 Kv për tensionin e 'mesëm'. Si rezultat, për pasojë të vjetërsisë së rrjetit dhe nënstacioneve, sistemi pëson humbje të mëdha.

Fuqizimi i nënstacionit 400/110 kV Zëmbllak dhe zgjerimi i rrjetit 110 kV Babicë-Sarandë në zonën juglindore, gjithashtu ka mbyllur në unazë një pjesë të rrjetit ekzistues 110 kV. Në këto kushte krijohet mundësia e furnizimit të zonës Jugore, nëpërmjet fluksit të fuqisë që futet nga nënstacioni 400/110 kV i Zëmbllakut. Për pasojë reduktohet fluksi i fuqisë që vjen nga linjat e largëta të rrjetit 220 kV, duke balancuar më mirë dhe vet unazën 220 kV të Jugut, që përbën një problem për sigurinë e furnizimit të një zonë të gjerë.

Ndërkohë në fazë po behet ndërtimi i dy n/st 110 kV në zonën e bregut të detit Jon: Orikum dhe Himarë.

Në Nënstacionin e Vlorës është në zbatim një projekt që transformon rrjetin e vjetër nga 35 në 110 kV. Zona turistike Vlorë - Sarandë do të sigurojë furnizimin me energji si pjesë e rrjetit 110/20 kV së shpejti. Linja 110/20 kV pjesërisht funksionon në qytetin e Vlorës që prej shumë vitesh dhe ka një diferencë të madhe në furnizimin me energji elektrike me zonat të cilat mbulohen akoma me 6 apo 10 kV. Ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim apo gadishmëri të plotë të TEC-it në Vlorë, do të rriste sigurinë në furnizimin me energji. Përfundimisht ka shumë stacione hidrocentralesh në rajon të cilët kontribuojnë në furnizimin me energji të linjave lokale. Të tilla sot janë katër në territorin e Bashkisë Vlorë. Termocentrali i Vlores i ndërtuar në vitin 2009 me një fond prej 96.6mln Euro me financim të BE, BERZH dhe BEI është në pronësi të KESH. Për momentin nuk është në punë pas një defekti në zonën e ftohjes.

TEC është i ndërtuar prej një blloku 98 MË me cikël të kombinuar të energjisë elektrike dhe përbehet nga turbina me gaz 68MË dhe turbina me avull 30MË dhe gjeneratori i avullit të tejnxehur. Ka mundësi zgjerimi për dy blloqe të tjera të të njëtes fuqi duke arritur një fuqi totale të instaluar deri 291MË. TEC-i mund të funksionojë me dy lloje lëndesh djegëse:

1 me naftë diesel nr2 me fuqi kalorifike të ulet në masën 42612 kJ/kg;



2 me gaz natyror me fuqi kalorifike te ulet ne masen 34534kj/m3

Zhvillimi i projektit TAP dhe perfundimi ne nje kohe sa me te shpejte i tij eshte nje mundesi edhe per venien ne pune te TEC-it.

Edhe gjatë vitit 2015 nuk është prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve ende nuk është mundësuar vënia në punë e TEC-Vlora.

KESH sh.a dhe kontraktori i ndërtimit të TEC-it janë në proces gjyqesor për zgjidhjen e kundërshtive lidhur me defektin në sistemin e ftohjes dhe mbylljen e njëanshme të kontratës nga TCM(nga kompania e kontraktuar) që në vitin 2012. Pritet që një kompani e specializuar konsulence të përfundojë projektin e riparimit të defektit në sistemin e ftohjes në TEC Vlora. Mendohet nga KESH që të përgatitet një studim pre-fisibiliteti ku do të analizohet në mënyrë krahasuese kosto e përdorimit të gazit natyror në prodhimin e energjisë elektrike nga TEC Vlora.

#### **Njësia administrative Qendër - Elektriciteti:**

**Bestrovë:** Bestrova furnizohet me energji elektrike nëpërmjet rrjetit që lidhet drejtpërdrejtë nga Komuna e Novoseles dhe shoqërohet me problematikën që shoqëron zonën në tërësi. Linjat më parë kalojnë nga Panaja, që është fshati i parë nga ku shpërndahet elektriciteti edhe në dy fshatrat e tjerë Bestrovë dhe Kërkove. Hoshtima po ashtu furnizohet me energji elektrike nga rrjeti kryesor që vjen nga komuna e Novoseles.

**Babicë:** Ky fshat furnizohet me energji elektrike nga qyteti ti Vlores, nepermjet nje stacioni elektrik qe ndodhet ne pjesen e brendshme te lugines, aty ku kalon rruga qe lidh fshatin e Babices, me ate te Sherishtes. Stacioni elektrik i Babices, eshte i mah dhe me nje kapacitet te konsiderueshem per te mbuluar me energji elektrike kater fshatrat, Babicen, Xhyherinen, Babicen e vogel dhe Sherishte. Nga stacioni elektrik i Vlores furnizohet me energji elektrike edhe Kanina, Zvërneci e Narta.

#### **Njësia administrative Shushice**

Rrjeti ekzistues 35/10 i energjise elektrike eshte i dobet dhe me probleme pritet te zbatohet projekti i OSHE per rrjetin e ri 6kë me qender ne Xhyherine.

#### **Njësia administrative Novosele**

Njësia aktualisht furnizohet me enegji nga rrjeti 35/10kv ne Mifol

#### **Njësia administrative Oriku**

Njësia furnizohet me energji elektrike nepermjet nenstacioneve:

Nenstacioni Radhime 35/10kv;

Nenstacioni Oriku 35/6kv

### ***Telekomunikacioni***

Aktualisht ka një mbulim nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të Bashkise. Përdorimi i kablove optike për Internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen edhe nga operatorë të fuqishëm mobile si T Mobile, Vodafone dhe Plus.

#### *Operatorët e rrjeteve fiks dhe mobile në qytetin Vlorë*

Të dhënat e siguruara nga regjistri elektronik-ATLASI për operatorët e rrjetit fiks të shtrirë në qytetin Vlorë ALBtelecom, Abcom, NISATEL, ASC

Në tabelën e mëposhtme jepet informacioni mbi radio antenat e operatorve celular në qytetin Vlorë. GSM Telekom Albania, Vodafone Albania, Vodafone Albania, Plus Communication: LTE Telekom Albania, Vodafone Albania.



### 3.2.4 Menaxhimi i mbetjeve urbane

**Mbetjet urbane** Vlorë gjenerohen më shumë se 40000T/vit mbetje urbane dhe po aq afërsisht edhe mbetje inerte me një mesatare prej rreth 1.9kg mbetje/ditë/banor. Sot fusha e aviacionit mban afërsisht rreth 250 000m<sup>3</sup> mbetje. Pavarësisht studimeve të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve gjendja mbetet problematike. Afërsia e pikës së grumbullimit të mbetjeve me qytetin e Vlorës është një problem akut që lidhet ngushtë me cilësinë e ajrit në zonë, me shëndetin e popullatës dhe zhvillimin e tij. Një zonë të nxehtë përbëjnë edhe mbetjet dhe ndotjet kimike në zonën e plazhit pranë ish Uzina e Sodë-PVC, (Vlerësimi i merkurit dhe metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit Raporti teknik i monitorimit Lazo, Cullaj,Baraj), e cila në vitet 1967-1992 ka shkarkuar drejtpërdrejt në det mbeturina të lëngëta (rreth 500 m<sup>3</sup>/orë) me përmbajtje të lartë mercuri, rreth 1.1 mg/L me një total prej 64 ton. urizmit.

**Qender, Vlore** Mbetjet urbane ne te ardhmen do te depozitohen ne landfilfin e Sherishtes. Ky landfild to te akomodoje dhe mbetjet e qytetit Vlore.

**Panajaja:** Gjendja e mbetjeve urbane edhe në këtë fshat është kaotike dhe mungon një infrastrukturë minimale. Mungesa e konteneirave per keto mbetje, e rëndon edhe më tej këtë gjendje. Natyra e bukur me një bimësi të pasur ku një pejzash të rrallë ofrojnë Eukaliptet në të dyja anët e rrugës së vjetër kombëtare. Ndërtimi i autostradës e ka lehtësuar zonën nga ndotja akustike dhe ambjentale e automjeteve.

#### **Shushice**

Sasi mesatare e mbetjeve qe prodhon Shushica eshte 8 ton/dite. Per te gjithë fshatrat.

**Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili** depozitimet shkojne pergjate bregut te lumit. Grumbullimi i plehrave ne te ardhmen do te depozitohet ne landfillin e Sherishtes.

#### **Novosele**


Grumbullimi i plehrave per gjithë fshatrat e njësisë Novosele depozitohet afer Lumit Vjose. Novosela prodhon mbetje 15 ton /dite. Për momentin problemi i mbetjeve të ngurta është zgjidhur me një rrjet kazanësh për hedhje mbeturinash dhe largimin e tyre në zonën e minierës së vjetër të Mushqetas. Problem shqetësues janë edhe mbetjet ndërtimore. Për momentin pjesa e dherave të nxjerrë nga gërmimet është zgjidhur nga vetë firmat e ndërimit. Mbetjet industriale ne këtë njësi janë të pakta. Ne te ardhmen mbetjet do te depozitohen ne landfildin e Sherishtes.

#### **Orikum**

Mbetjet grumbullohen ne Dukat. Sasia e mbetjeve te prodhuara ehte 9 ton ne dite. Te gjithë fshatrat e njësisë administrative Orikum depozitojne mbetjet ne Dukat.

### 3.3 Konsiderata mbi planet e niveleve të tjera dhe ndikimi i tyre mbi territor

Një element shumë i rëndësishëm, që plani merr në konsideratë janë dhe dy dokumentat baze ku përshkruhen zhvillimet e ardhshme të territorit si dhe zhvillimet strategjike të tij, siç janë PPK dhe PINS bregdeti. PINS bregdeti jep direktiva të rëndësishme të cilat janë marrë në konsideratë në plan në lidhje me infrastrukturën rajonale dhe menyrën e zhvillimit të transportit në zonat të ndryshme të bregdetit. Këto dokumente janë marrë në konsideratë gjithashtu për polet e zhvillimit në territorin në studim duke përmendur polin bujqësor, ekonomik, energjitik etj. Gjithashtu elementet strategjike të impaktit kombëtar mbi gjithë territorin e vendit si, aeroport hekurudhe, itinerare të ndryshme të levizjes turistike etj. Harta tregon lidhjen me rajonin që Bashkia siguron si shembull i planifikimit të infrastruktures në nivel kombëtar.



**Figura 7 Poli ekonomik Vlorë-Fier-Berat**  
*Burime: PPK 2030*

### 3.4 Tipologjia dhe shpërndarja në territor e shërbimeve sociale

Organizimi dhe shpërndarja e mirë e objekteve arsimore, kujdesit shëndetësor, gjelbërimit, objekteve kulturore e sportive, ka një ndikim të madh për krijimin e zonave atraktive dhe funksionale urbane dhe rurale. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë që, këto objekte të jenë të mjaftueshme dhe të arritshme. Në lidhje me shërbimet sociale, Bashkia Vlore ka një organizim qendror urban që ofron shumë të tilla. Ndërkohë ka nevojë që të përmbushë sfidat e një popullsie heterogjene, që spostohet vazhdimisht përgjatë gjithë vitit, me shtrirjen e vendbanimeve dhe aksesin shpesh të vështirë për shkak të distancave, cilësinë e infrastrukturës dhe gjeomorfologjisë së terrenit.

Sikurse dihet shërbimi social i referohet një grupi specifik të popullsisë ose vendi/zone të veçantë: edukimi, që lidhet me banorët të përhershëm të një zone, duhet të llogaritet në bazë të të dhënave aktuale të popullsisë. Në mënyrë të ngjashme objektet sportive i referohen kryesisht strukturës së një zone urbane dhe janë më të rëndësishme për rastin e qytetit të Vlorës ( pa përfshirë këtu sportet e ujit dhe ato që lidhen me turizmin dhe aktivitetet e kohës së lirë). Nga ana tjetër, objektet e kujdesit shëndetësor duhet të mbulojnë sa më shumë të jetë e mundur, nevojat e të gjithë territorit dhe popullsisë, konkretisht nevojat e popullsisë së përhershme gjatë gjithë vitit, por edhe të turistëve dhe vizitorëve, që kryesisht përqendrohen përgjatë zonave bregdetare dhe përkohësisht gjatë sezonit të verës. Në mënyrë të ngjashme, objektet kulturore u vijnë në shërbim banorëve vendas dhe në të njëjtën kohë përbëjnë edhe atraksione të rëndësishme për turistet dhe vizitorët e zonës.

Së fundmi, hapësirat e gjelbëra publike siç janë parqet dhe shëtitorët, kryesisht i referohen zonave urbane të Vlorës dhe zonave të reja të zgjerimit, dhe në një masë më të vogël shesheve të brendshme të banesave dhe atyre sipërfaqeve të vogla në zonat malore. Për pjesën tjetër të territorit, me karakter rural dhe zgjerimet e plazheve si dhe entitetet natyrore dhe mjedisore, nocioni i hapësirave të gjelbëra urbane për keto zona është i ndryshëm.

Në këtë kapitull, nevojat për shërbim social janë definuar dhe percaktuar sipas standarteve dhe indikatorëve të VKM 671/2015. Metodologjia përfshin vlerësimin e sasisë minimale të tokës së kërkuar dhe qëndrueshmërinë e njësisë me qëllim për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale dhe infrastrukturë. Vlerësimi është bazuar në projeksionet e popullsisë të vitit 2031, sipas parashikimeve përkatëse të ekipit planifikues, dhe kategorizimet e veçanta ku përfshihet popullsia sezonale (sidomos për njësitë administrative të Orkimit dhe Vlorës).

Vleresimi gjithashtu bazohet në nivel të dhenash për njësi administrative për shkak të mungesës së të dhënave të detajuara (Census për vendbanime). Bazuar në këto të dhëna, propozimi i kërkuar për njësi/ sipërfaqe duhet të shpërndahet në çdo vendbanim, duke ndjekur nevojat kryesore, potencialet dhe tendencat e secilit. Në të njëjtën kohë kjo procedurë është në përqasje me synimin dhe rolin kryesor që ka secili vendbanim (në distancë: qendra administrative, qender turistike etj). Një tjetër parameter i rëndësishëm është udhezimi dhe parashikimi nga plani kombëtar (PPK dhe PINS Bregdeti) për strukturën e vendbanimit dhe hierarkinë e qendres urbane. Këto direktiva janë specifikuar në nivel lokal dhe janë marrë në konsideratë nga PPV. Së fundmi, një parameter baze është perlllogaritja e rrezes së shërbimit për të siguruar një shpërndarje më të mirë hapësinore dhe akses në shërbime.

Për arsye qartësie “njësitë hapësinore” të përkrahura gjatë fazave të mëparshme, të Analizës dhe Vizionit, në këtë fazë lidhen më mirë me njësitë administrative, bazuar në standardet e planifikuara për secilën. Në këtë situatë organizimi i propozuar për secilin nga vendbanimet është si më poshtë:

- **Njësia administrative Vlorë**  
Vendbanimet: qyteti Vlorë, ish- Bashkia Vlorës
- **Njësia administrative Orikum**  
Vendbanimet: Orikum, Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Rradhimë
- **Njësia administrative Qendër**  
Vendbanimet: Hoshtimë, Panaja, Bestrovë, Bestrovë e vogël, Kërkovë, Babicë, Babicë e Vogël, Kaninë, Sherishtë, Xhyherinë, Nartë, Zvërnec
- **Njësia administrative Shushicë**  
Vendbanimet: Risili, Mekati, Drithasi, Llakatund-Shushicë, Grabian, Çepirat, Beshisht
- **Njësia administrative Novoselë**  
Vendbanimet: Fitore, Aliban, Poro, Zhykë Grykëshqipe (Delisuf), Dëllenjë, Akërni, Bishan, Mifol, Trevllazer, Skrofotinë, Cerkovinë

Sipas pritshmërive demografike për zhvillimin e popullsisë, bazuar në të dhënat INSTAT, Bashkia Vlorë përfshihet në kategorinë e tretë (deri në 100.000 banorë) dhe shërbimet sociale janë planifikuar sipas standardeve të përkrahura më poshtë në tabelë:

**Tabela 14 Standardet e kërkuarapër shërbimet sociale në Shqipëri**

Qendra të banuara	Siperfaqe bruto banimi	Hapesirë e gielbër	Kopsht, cerdhe, shkolla	Struktura për përdorim publik	Territor sportiv	Parkimi publik	Shërbim tregtar i kufizuar	Gjithsej
	m <sup>2</sup> /ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.	m <sup>2</sup> / ban.
<b>mbi 100,000 banorë</b>	25	5	4.5	2	1,6	6	5	53,1

Udhëzimet e përgjithëshme mbi organizimin e njësive hapësinore dhe shpërndarjen e shërbimeve:

- Njësitet e reja/zonat e infrastrukturës sociale mund të gjenden brenda zonës ekzistuese të banimit, ose në zonat peri-urbane apo zgjerimet e propozuara (në varësi të llojit të shërbimit).
- Njësitet e reja/zonat mund të gjenden në bashkitë ekzistuese/ infrastruktura publike, por me kusht që të mos shkelin standardet minimale.
- Gjatë ndarjes së njësive të reja administrative, është preferuar të vlerësohet infrastruktura ekzistuese (ndertesat e bashkisë, duke ndertuar blloqet tradicionale, hapësirat publike, etj.) duke pasur për qëllim përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (përdorimin e tokës, materialet, etj.), si dhe të vlerësohet trashëgimia kulturore.
- Ndarja përfundimtare e propozuar e njësive / me numër dhe madhësi, parcela dhe zona mund të konsiderohet do të përcaktohen gjithashtu nga Planet e Detajuarë Lokale (PDV). Në çdo rast, PDV-të duhet që të mos jenë në konflikt me direktivat apo propozimet nga PPV. Gjithashtu, disa nga propozimet për njësi mund të ketë nevojë për lehtësira (ose për specializime të tjera) të studiuara dhe një investigim më të detajuar , prioritet për zhvillimin e tyre.

Bashkia Vlorë ka një përqindje të popullsisë sezonale të dallueshme ku fluksi i (turistëve, vizitorëve dhe popullsia kombëtare sezonale), e cila është përqëndruar në zonën bregdetare (Vlorë, Orikum dhe Qendër). Për llogaritjen e standardeve të planifikimeve janë marrë në konsideratë projeksionet për popullsinë vendase për 2031 dhe ka një rritje modeste për turizmin rreth 10%.



<b>Tabela 15 Të dhënat për përlogaritjen e popullsisë së turizmit</b>			
<b>Indikatorët</b>	<b>Njesive administrative</b>		
	<b>Vlora</b>	<b>Orikum</b>	<b>Qender</b>
<b>Projeksionet Popullsia Rezidente<sup>1</sup></b>	81859	5665	7846
<b>Popullsia e rikthyer në periudhën e verës</b>	48429	2751	3852
<b>Pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore</b>	17820	5400	1750
<b>Turistët (në ditë)</b>	4600	950	200
<b>Visitore Ditor</b>	8000	1540	750
<b>Të punësuarit sezonal</b>	1800	355	135
<b>Totali</b>	<b>162508</b>	<b>16661</b>	<b>14533</b>

*Burimi:* Punuar nga ekspertët me dhenave nga INSTAT, 2016

Plani i propozuar për një infrastrukturë sociale specifike, i cili duhet të marrë në konsideratë nevojat e të gjithë përdoruesve, supozon që ky shërbim duhet të planifikohet gjithpërfshires për gjithë nevojat e popullsisë. Për këtë arsye, standartet e planifikimit për shërbimet: Hapësirë e gjelbër (AR), Shëndetësi (SH) dhe Parkim publik (IN) janë propozuar duke u bazuar në popullsinë vendase si dhe tek turistët/sezonal për shkak të rolit të tyre në numrin e popullsisë turistike gjatë pikut të sezonit. Shërbimet tregtare të kufizuara, janë parashikuar të planifikohen, duke marrë në konsideratë nevojat e popullsisë vendase dhe turistëve sezonal duke përfshirë kategorinë e “Të punësuarëve sezonal”.

### **Vlerësimi i standardeve të planifikimit**

#### *Njësia Administrative Vlorë*

Mundësitë e planifikimit për kategori:

#### *Hapësirë e gjelbër (AR):*

Rrjeti i hapësirave të gjelbëra dhe të hapura luan një rol të rëndësishëm ekologjik në përmirësimin e mikroklimës, biodiversitetit dhe kontrollin e balancave të rrjedhave ujore. Ai gjithashtu rrit strukturën urbane dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë

së jetës urbane dhe të imazhit të përgjithshëm të një zone, duke e bërë atë tërheqëse. Kuadri i ri ligjor i ndan zonat e gjelbëra urbane në tre kategori :

- Gjelbërimi i përgjithshëm publik;
- Gjelbërimi i kufizuar publik;
- Gjelbërimi i veçantë.

Çështja e Gjelberimit Urban përmbledh vleresimin e situates se tanishme dhe planifikimin e rrugeve me gjelberim, lulishteve te lagjeve dhe parqeve urbane. Sipas normave te tanishme kombetare standarti i referuar eshte  $8 \text{ m}^2$  per person, i cili perputhet pothuajse plotesisht me praktiken e vendeve te BE.

Me disa perjashtime, kjo norme eshte pothuajse e neglizhuar dhe duhet të interpretohet duke marre në konsiderate tre lloje të ndryshme të gjelberimit urban:

- a. Parqet e qyteteve duhet të merren si parqe urbane, që njihen gjithashtu si parqe bashkiake (Amerika e Veriut) ose parqe publike ose siperfaqe te hapura (Mbreteria e Bashkuar), eshte nje park ne qytete me pajisje dhe hapësira te inkorporuara qe ofrojne çlodhje, zbavitje dhe siperfaqe te gjelbra per rezidentet dhe vizitoret ne bashkine perkatese ose nje siperfaqe publike në qytet që është pronë publike dhe që perdoret për çlodhje, pajisje kopshtarie, që rekomandohet të vendosen në rrethinat e qytetit.
- b. Lulishtet e lagjeve janë zakonisht të vendosura ne distance ecje me kembe (jo me larg se 250 m nga banesat. Në shumicen e rasteve ato jane të pajisura me stola, sheshe lojrash për femije, kioska (per pije, gazeta e revista) dhe shpesh integrohen me tregje te hapura javore.
- c. Gjelberim pergjatë rrugeve kryesore dhe trotuareve

**Në Vlorë zona e gjelber** është e shpërndarë në qytet (88 hektare) dhe e përqendruar në pjesën perëndimore të qytetit (pylli me pisha - 214 hektarë i llogaritur me foto ajrore) duke arritur kështu një total prej rreth 300 hektarësh, nderkohë që nevoja aktuale, sipas normativave shqiptare, eshte rreth 100 hektarë. Ky pyll pishash është aktualisht i mbrojtur nga Drejtoria e Pyjeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe nuk mund të konsiderohet si gjelbërim publik.

Ne vitin 2031, popullsia do të kapë vlerën ekuivalente të rreth 160.000 banore (perfshi këtu edhe vershimin e turistëve) duke e çuar kështu shifren e kerkeses totale në gati 115 hektare zonë publike të gjelber. Siperfaqja totale e planifikuar është 312 ha dhe permbush standartet vetem nese pylli i pishave ose një pjese e tij perfshihet në të.

Për sa i perket tregjeve, ato jane identifikuar brenda nje plani te pergjithshem

tematik i cili lidh tregjet e shumices me dyqanet e pakices se lagjeve, tregun e zarzavateve dhe ate peshkut. Sidoqofte duke pasur parasysh shkallen e ketyre 4 qyteteve (te madhesise mesatare ne Shqiperi), shitja e frutave dhe zarzavateve ne katet perdhe duhet te inkurajohet dhe promovohet duke e bere me te ngushte lidhjen midis prodhuesit dhe konsumatorit. Perndryshe tregjet mund te vendosen brenda nen-njesive urbane dhe te llogariten si pjese e Infrastruktures sekondare lokale.

*Arsim (AS):*

Sigurimi i objekteve arsimore është një pjesë integrale e planifikimit të politikave dhe praktikave moderne. Arsimi fillor dhe ai i mesëm dhe i lartë, i ofrojnë brezit të ri mjetet teorike dhe praktike, që do të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë objekte të mjaftueshme, ndërsa parimi themelor për funksionimin efikasë të objekteve arsimore është aksesueshmëria në to.

- *Objektet e arsimit bazë (çerdhet, kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare):*
  - *Në zonat urbane* (qyteti i Vlores), parimi i aksesit është i përfshirë në planifikimin e objekteve të arsimit fillor, të cilat janë të lidhur me lagjet, duke siguruar qasje me rrugët lokale dhe dytësore të lagjeve. Distanca ajrore të mbulimit të zonave të shërbimit respektojnë dispozitat kombëtare të planifikimit.
  - *Në zonat rurale*, i cili është rasti më i ndeshur në territorin e bashkisë, objektet arsimore kanë një mbulim të vogël rajonal, për shkak të terrenit dhe të vendbanimeve, popullsisë së vjetër dhe numrit të kufizuar të nxënësve. Ato duhet të jenë të vendosura në qendrat e njësive të banuara. Është e nevojshme që të lehtësohet sa më shumë të jetë e mundur aksesit i nxënësve në objektet arsimore dhe edukative, për shembull nëpërmjet autobuzëve dhe sigurimit të vendstacioneve të tyre për të siguruar transportin e sigurtë të nxënësve, që përdorin autobuzët e shkollave.
  - *Objektet e arsimit të mesëm* (shkollat e mesme, qendrat profesionale dhe shkollat, etj), duhet të pozicionohen në zona që kanë aksesibilitet të lartë, përfshirë edhe transportin publik. Për rastin e Vlorës, duke pasur parasysh sipërfaqen e territorit, objektet e arsimit të mesëm konsiderohen të parëndësishme duke pasur parasysh karakterin dhe strukturën hapësinore të zonës.

Hartëzimi i njohurive është përshtatur mbi bazat e metodave të mëposhtme. Pasi janë identifikuar facilitetet arsimore, përcaktohen zonat e arritjes sipas dy pikave:

1. Nje distance 500 m me kembë nga ndertesat ekzistuese (per kopshtet dhe shkollat fillore) dhe 1000 m (per shkollat emesme).

2. Popullsia rezidente (afersisht 2000-10000 per shkolla fillore, dhe afersisht 10000-120000 per shkollat e mesme).

Një analizë e mangësive është kryer për te vlerësuar nevojat për facilitete arsimore falë një investigimi të detajuar dhe vëzhgimit në terren përsa i përket shkollave. Eventualisht keto të fundit do të duhet të rinovohen ose zgjerohen sipas nevojës. Ndërsa, vendndodhja e ndërtesave të reja është identifikuar brenda zonave të cilat nuk janë të përfshira brenda zonave të mbulimit të identifikuara më pare.

#### Aktualisht gjenden:

	Sip. ekzistuese e ndërtuar	Nevoja e tanishme per sip te ndertuar
<b>19 Kopshte</b>	9440	-5020
<b>18 Shkolla 9-vjecare</b>	25 985	- 34 879
<b>8 Shkolla te mesme</b>	15623	-7690

*Shënim: shenja negative shenon gjithmone mungese.*

**Tabela 16 Shkollat 9-vjecare (gjendja dhe nevojat e tanishme)**

#	Emri i Shkolles	Nr. i nxënësve	Nr. i kateve	Sip. e plotit (m <sup>2</sup> )	Sip. e ndërtuar	Standarti i sip. së ndërtuar (6m <sup>2</sup> /p)	Sip. e nevojshme (m <sup>2</sup> )
1	Zenel Murro	363	1	250	170	2178	-2 008
2	Zigur Lelo	284	2	2 700	352	1704	-1 352
3	24 maj	599	3	4 900	2 160	3594	-1 434
4	Musa Cakerri	785	3	2 100	1 698	4710	-3 012
5	Lef Sallata	854	3	3 800	1 710	5124	-3 414
6	Ismail Qemali	931	3	2 400	2 160	5586	-3 426
7	Marigo Posio	753	4	5 075	3 640	4518	-878
8	Muco Delo	493	4	2 600	1 040	2958	-1 918
9	4 Heronjte	314	2	4 200	1 130	1884	-754
10	Teli Ndini	586	3	3 000	1 845	3516	-1 671
11	Avni Rustemi	515	3	2 800	1 860	3090	-1 230
12	Rilindja	1090	3	3 400	1 620	6540	-4 920
13	15 Tetori	498	3	1 200	340	2988	-2 648
14	28 nentori	242	2	1 200	340	1452	-1 112
15	Ibrahim	507	3	3 000	2 200	3042	-842
16	P.L.M	88	2	2 100	570	528	42
17	Naim Frasheri (9 vjecare)	80	3	3 800	2 150	480	1 670

18	Shkollë e Re	1162		10 000	1 000	6972	-5 972
	<b>T O T A L</b>	<b>10 144</b>		<b>58 525</b>	<b>25 985</b>	<b>60864</b>	<b>-34 879</b>

**Tabela 17 Shkollat e mesme (gjendja dhe nevojat e tanishme)**

#	Emri i Shkolles	Nr. i nxenesve	Nr i kateve	Sip e plotit (m <sup>2</sup> )	Sip e ndërtuar	Standarti i sip se ndertuar (6m <sup>2</sup> /p)	Sip e nevojshme (m <sup>2</sup> )
1	Ali Demi	1105	3	3 700	2 989	6630	-3 641
2	Halim Xhelo	570	3	7 400	3 684	3 420	264
3	M. Q. Ataturk	789	3	3 700	3 291	4 734	-1 443
4	Shkolla e RE	65	3			390	-390
5	Tregetare	263	3	3 900	1 830	1 578	252
6	N.Fraseri	80	3			480	-480
7	Ped "Jani Minga"	281	3	4 980	2 159	1 686	473
8	Pavarësia	1314	4	9700	1670	8580	1120
	<b>T O T A L</b>	<b>4467</b>		<b>3338</b>	<b>15623</b>	<b>17220</b>	<b>-7690</b>

**Tabela 18 Kopshtet (gjendja dhe nevojat e tanishme)**

#	Emri i Kopshtit/ Cerdhes	Nr i nxënësve	Nr. i kateve	Sip. e plotit (m <sup>2</sup> )	Sip. e ndërtuar	Standarti i sip. së ndertuar( 6m <sup>2</sup> /p)	Sip. e nevojshme (m <sup>2</sup> )
1	Kopshti nr .2	177	2	1313	788	1062	-274
2	Kopshti nr. 3	95	2	856	514	570	-56

Shërbim Konsulente, për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore, për Katër Bashki, Vlorë, Sarandë,  
Himarë, Konispol

3	<b>Kopshti nr.8</b>	100	2	372	200	600	<b>-400</b>
4	<b>Kopshti nr.9</b>	198	2	633	223	1188	<b>-965</b>
5	<b>Kopshti nr.10</b>	263	2	2388	1433	1578	<b>-145</b>
6	<b>Kopshti nr. 11</b>	201	2	372	223	1206	<b>-983</b>
7	<b>Kopshti nr.13</b>	126	2	454	272	756	<b>-484</b>
8	<b>Kopshti "1 Maj"</b>	138	2	1149	689	828	<b>-139</b>
9	<b>Kopshti nr. 1</b>	138	2	607	364	828	<b>-464</b>
10	<b>Kopshti nr. 5</b>	109	2	607	360	654	<b>-294</b>
11	<b>Kopshti nr. 7</b>	145	2	243	146	870	<b>-706</b>
12	<b>Kopshti nr. 14</b>	163	2	3838	2303	978	<b>1325</b>
13	<b>Kopshti nr. 15</b>	145	2	450	225	870	<b>-645</b>
14	<b>Kopshti "Lef Sallata"</b>	127	2	350	300	762	<b>-462</b>
15	<b>Kopshti "M. Çakerrri"</b>	73	2	1960	300	438	<b>-138</b>
16	<b>Kopshti "4 Heronjtë"</b>	58	2	5050	250	348	<b>-98</b>
17	<b>Kopshti "Z. Murra"</b>	38	2	499	300	228	<b>-72</b>
18	<b>Kopshti "Z. Lelo"</b>	57	2	3250	250	342	<b>-92</b>
19	<b>Kopshti tek 7 pallatet</b>	38	2	500	300	228	<b>72</b>
	<b>T O T A L</b>	<b>2389</b>		<b>24891</b>	<b>9440</b>	<b>14328</b>	<b>-5020</b>

Informacioni dhe të dhënat mbi kopshtet kanë qenë pjesërisht të disponueshme. Departamenti i planifikimit urban dhe departamenti i arsimit bashkiak kanë qenë të vetmit që kanë siguruar informacionin në lidhje me numrin total të kopshteve dhe femijve nga departamenti i Planifikimit urban. Në lidhje me 8 shkollat e mesme, të dhënat janë raportuar nga departamenti i arsimit në Bashki.

Në qytetin e Vlorës gjenden gjithashtu si shërbime arsimit rreth 15 shkolla të tjera 9-vjeçare dhe të mesme private dhe statusi i tyre është ende i papërcaktuar ndërkohë që për komunitetin plotëson pjesërisht nevojat komplementare por nuk mbetet i aksesueshëm për të gjitha shtresat e popullsisë

Objektet e arsimit në Vlorë nuk i mbulojnë nevojat e tanishme bazuar në normativen 6 m<sup>2</sup> për student/nxenes dhe për më tepër ato janë të lokalizuara shumë larg familjeve. Më shumë se gjysma e nxenesve dhe kopshteve duhet të ecin më shumë se 500 metra. Gjysma e të rinjve (ata që jetojnë në pjesën perëndimore të qytetit) duhet të ecin më shumë se 1 Km për arritje në shkollat e mesme.

Aktualisht sipërfaqja e ndertuar që nevojitet, për shkollat kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme është rreth 50.000 m<sup>2</sup>. Në 2031, me ekuivalentin e popullsisë 160.000, nevoja do të rritet në 80.000 m<sup>2</sup> sipërfaqe të ndertuar e barabartë me një sipërfaqe ploti prej 240.000 m<sup>2</sup>. Numri total i kopshteve, shkollave 9-vjeçare dhe të mesme që planifikohen të shtohen për vitin 2031 është rreth 22.

### **Shëndetësi (SH):**

Mbulimi me objekte të kujdesit shëndetësor është një komponent thelbësor i standardeve të pranuar të jetesës dhe një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, të bazuar në shërbime cilësore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet banorëve të përhershëm të zonës (sidomos në rastet e popullsisë në moshë të madhe (plakje), si dhe për vizitorët dhe turistët nga perspektiva e rritjes së parashikuar të sektorit turizmit.

#### Objektet Shëndetsore

Sipas ligjit/praktikës së tanishme brenda bashkive mesatare sistemi shëndetsor organizohet si më poshtë

- Spitalet Rajonale (shërbimi ndaj pacientit perrajonin),
- Spitalet Bashkiake (shërbimi ndaj pacientit perbashkinë),
- Qendrat e Kujdesit Shëndetsor (QKSH), (shërbim i specializuar për paciente të jashtëm për çdo rajon bashkiak – deri në 25 000 banorë) Deri tani janë parashikuar 3000 banorë për doktor në një QKSH.

**Tabela 19 Standartet e aplikuara per Facilitetet kryesore Publike dhe Urbane**

Facilitetet Shendetso re	Popullsia e Planifikuar	Shtreter/ban ore (8/1000)	m2/shtra t	Siperfaq e e ndertuar	Siperfaqja e nevojshme	Index
Spitale	150 000	1 200	18	21 600	<b>72 000</b>	0,3
Qendra				5 250	<b>7 500</b>	0,7

**Spitalet:** Kapaciteti i kërkuar 8 shtreter/1000 banore te ekuivalentit të parashikuar te popullsisë). Siperfaqe e ndertuar = 18 m<sup>2</sup> per krevat. Siperfaqja e plotit = 0,3 indeks.

**Qendrat shendetso re:** Kapaciteti i kerkuar (Siperfaqe e ndertuar) = 0,035 m<sup>2</sup> per banore (ekuivalenti i parashikuar i popullsisë). Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,8 indeks.

**Kopshte:** Target: 30% e 10 % te ekuivalentit te parashikuar te popullsisë. Siperfaqe e ndertuar = 6 sqm per femije. Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,6 indeks.

**Shkolla nentë-vjeçare:** Target: 13 % te ekuivalentit të parashikuar te popullsisë. Siperfaqe e ndertuar = 6m<sup>2</sup> per femije. Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,6 indeks.

**Gjimnazet:** Target: 40 % e 10 % të ekuivalentit te parashikuar të popullsisë. Siperfaqe e ndertuar = 6m<sup>2</sup> per nxenes. Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,6 index.

**Pishinat:** Target (përdorues potencial per pishinat): 7 % te ekuivalentit te parashikuar të popullsisë. Siperfaqja e plotit: 0,5 m<sup>2</sup> per perdorues. Numri i pishinave = Siperfaqja e plotit / 1250 m<sup>2</sup>.

**Biblioteka Publike:** Target (perdoruesit potenciale): te ekuivalentit te parashikuar te popullsisë. siperfaqe e ndertuar = 0,1 sqm per banore. Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,3 index.

**Parqe /Lulishte:** 7 m<sup>2</sup> per banore te ekuivalentit te parashikuar te popullsisë).

**Varreza (15 vjet):** 50 vdekje per 1000 banore ne vit te shumezuar me 15 vjet.

**Qendra Sportive:**Siperfaqe e ndertuar 1 sqm per banorëte ekuivalentit te parashikuar te popullsisë. Siperfaqja e plotit = siperfaqen e ndertuar / 0,03 index.

Në këtë kapitull do ti jepet një rendesi e veçante shendetësise, arsimit, gjelberimit dhe fasiliteve të tjera. Këtyre fasiliteve të tjera i janë dhënë permasat sipas standarteve nderkombetare dhe praktikave te mira të perdorura (sidomos ne zonen e Ballkanit).

**Varrezat** duhet të zmadhohen në siperfaqe dhe duhet te merret ne konsiderate edhe nje kulture e re varrimi qe do te zevendesonte varrin me zgjidhje te tjera alternative, siç jane memorialet kolektive per individet e kremuar si dhe varre disa kateshe per te futur arkivolet.

Gjithashtu, për shkak të ndertimeve te viteve te fundit Bashkia nuk ka toke te tepert ne dispozicion per ta perdorur per fasilite publike, si thertore, impjante trajtimi te ujrave te zeza, dhe objekte te tjera publike dhe private si tregje te shumices, qendra komerciale. Në këto kushte, vend-vendosja e tyre duhet te gjendet jashte zones administrative “zyrtare”. Kjo aspekt duhet të mirë percaktohet së bashku me çeshtjen e kufirit bashkiak që është ende I pa vendosur




**Zona e aeroportit** të vjeter, pritet t'i sigurojë qytetit një hapësirë të madhe ku do të mund te vendoset pjesa më dërmuese e faciliteteve publike. Gjithashtu edhe disa zona te braktisura te shperndara aty-ketu duhet te konvertohen ne facilitete urbane që do të ndertohen dhe menaxhohen nga partnership publik/privat.

**Zonat Sportive** - Siperfaqja e pishinave që nevojiten ne qytetin e Vlorës, e perllogaritur për 15 vitet e ardhshme, eshte sipas standardit 7% e popullsisë. Kjo vlerë i korrespondon 11.200 përdorues për 15 vitet e ardhshme që i nevojitet një sipërfaqe totale ploti 5600 m<sup>2</sup> e përkthyer në rreth 5 pishana të shpërndara në njësi. Duke parë situatën aktuale të Vlorës propozohet pishinë olimpike në Lungomare, pishinë olimpike në vendin ekzistues (rigjenerim dhe zgjerim) si dhe dy pishina të tjera në pjesën perëndimore dhe jugore të qytetit.

Parashikohet shtimi i qëndrave sportive pranë Lungomares si dhe në dy zonat informale të qytetit.

Qëndrat e Kujdesit Shëndetësor Primar të quajtura gjithashtu edhe *ambulanca* (ndihma e parë për pacientët ku punojnë mjekë të përgjithshëm),



Bazuar në organizimin e mesiperm territorial të sistemit shendetsor dhe standartet e aplikuara ne vendet fqinje të Ballkanit, janë aplikuar standartet e meposhteme:

- Spitale Rajonale,
- Spitalet bashkiake (shërbimi i pacientit per bashkine: 7 shtreter / 1000 banore),
- Qendrat e Kujdesit Shendetsor (HCC): deri ne 25 000 banore secila; siperfaqja e dyshemese nga 0,02 ne 0,05 meter katror per banor, siperfaqja e kapjes (mbulimit) rreth 1 000 / 1 500 mt distance.
- Qendrat Primare per Kujdesin Shendetsor (*ambulanca*) qe do te vendosen ne nen-nesite e identifikuara urbane brenda zonave rezidenciale urbane dhe jane perfshire ne perllogaritje.

Në Vlorë ka një spital rajonal me 516 shtreter, një spital qyteti pa shtreter për momentin dhe 8 Qendra Shendetsore (50 doktorë). Po kështu është planifikuar të ndertohet një spital bashkiak (kapaciteti 1230 shteter) në zonen e meparshem të serave (rrethuar me

vije të nderprere në hartën e mesiperme). Një total prej 7,9 hektarësh (dhe 23.760m<sup>2</sup> ndertim) janë planifikuar për një popullsi prej 150.000 banorësh. Spitali rajonal ekzistues (2,6 ha) do të vazhdojë të shërbejë në nivel rajonal, sidomos duhet një plan kombëtar për objektet e shëndetsisë për të udhëhequr zhvillimin e infrastrukurës së shëndetsisë.

Për sa i përket QSH, totali i sipërfaqes së ndertuar, sipas standarteve duhet të rritet në 5775 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e plotit = 8250m<sup>2</sup>) (shih Tabelën e Standarteve me sipër). Për të përmbushur këtë funksion janë identifikuar dhe planifikuar 2,3 hektare. Supozohet që PHCC (*ambulanca*) do të operojnë në mënyrë të pavarur me mjekët e përgjithshëm.

### **Vlerësimi i standardeve të planifikimit- Njësia Administrative, Qendër, Novoselë, Orikum, Shushicë**

Organizimi dhe shpërndarja e mirë e ambjenteve arsimore, kujdesit shëndetësor, gjelbërimit, objekteve kulturore e sportive dhe parkimit, jep një kontribut të madh për krijimin e zonave funksionale, të atraksionit urban dhe rural. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë që këto objekte të jenë të mjaftueshme dhe të arritshme. Kjo sigurohet mbi bazën e vlerësimeve sasiore dhe cilësore të nevojave sipas numrit të banorëve, karakterit të zonës dhe modelit hapësinor të shpërndarjes së popullsisë rezidente. Numri i banorëve është treguesi kryesor për vlerësimin sasior të tërësisë së shërbimeve të nevojshme, ndërsa nëndarja funksionale e territorit në njësi hapësinore, njësitë strukturore dhe nën-njësitë është parimi udhëzues mbi të cilat organizohet shpërndarja e shërbimeve. Turizmi formon një parametër të veçantë që krijon nevoja shtesë në disa pjesë të territorit për një gamë të caktuar të shërbimeve.

Sikurse dihet një shërbim social i referohet një grupi specifik të popullsisë ose vendi/zone të veçantë: edukimi, që i referohet banorëve të përhershëm të një zone, duhet të llogaritet në bazë të të dhënave aktuale të popullsisë. Facilitetet sportive i referohen kryesisht zonave rezidenciale por gjithashtu edhe zonave turistike. Në mënyrë të ngjashme objektet sportive i referohen kryesisht strukturës së një zone urbane dhe janë më të rëndësishme për rastin e njësisë administrative Qendër (duke mos llogaritur sportet e ujit dhe ato që lidhen me turizmin dhe aktivitetet e kohës së lirë). Nga ana tjetër, objektet e kujdesit shëndetësor duhet të mbulojnë sa më shumë që të jetë e mundur nevojat e të gjithë territorit dhe popullsisë, konkretisht nevojat e popullsisë së përhershme gjatë gjithë vitit, por edhe të turistëve dhe vizitorëve, që kryesisht përqendrohen përgjatë zonave bregdetare dhe gjatë sezonit të verës. Në mënyrë të ngjashme, objektet kulturore i shërbejnë banorëve vendas, por shërbejnë në të njëjtën kohë si atraksione të rëndësishme për turistët dhe vizitorët e zonës.

Së fundmi, hapësirat e gjelbra dhe të hapura, në kontekstin e hapësirave publike, parqeve dhe shëtitoreve, i referohen kryesisht zonave turistike duke pasur parasysh që vendbanimet ekzistuese rurale kanë nevojë vetëm për sheshe të vogla të hapura në shërbim të komunitetit lokal. Nocioni i hapësirave të gjelbërta urbane nuk është i rëndësishëm duke pasur parasysh karakterin rural të zonës.

Sipas standardeve shqiptare një sipërfaqe prej 17.5 m<sup>2</sup> për banor është e nevojshme vetëm për facilitetet në nivel njësie administrative:

- 7 m<sup>2</sup> për shëndetësinë dhe arsimin,
- 7 m<sup>2</sup> gjelbërim,
- 1,5m<sup>2</sup> për varreza,
- 2 m<sup>2</sup> në qendra sportive (duke përfshirë edhe pishinat).

Gjithashtu, është e nevojshme për t'u theksuar se në rastin e njësisë administrative Qender nevoja për sigurimin e një numri të shërbimeve si, spitale, qendra kulturore dhe tregëtare është zëvendësuar nga afërsia e njësisë administrative me qytetin e Vlorës. Kjo është marrë parasysh në vlerësim.

Më poshtë janë dhënë shpjegime më të hollësishme të përdorimit të planifikimit të standardeve.

**Arsimi**- Sigurimi i ambienteve arsimore është një pjesë integrale e planifikimit të politikave dhe praktikave moderne. Arsimi fillor dhe ai i mesëm, i ofrojnë brezit të ri mjetet teorike dhe praktike, që do të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë ambiente të mjaftueshme, ndërsa parimi themelor për funksionimin efikas të ambienteve arsimore është aksesueshmërinë e tyre.

*Ambjentet e arsimit fillor (çerdhe, kopshte dhe shkolla 9-vjeçare)*

- Në *zonat rurale*, siç është edhe shumica e territorit të njësisë administrative, infrastruktura arsimore mbulojnë në nivel rajonal, për shkak të vendbanimeve të vogla malore, plakjes së popullsisë dhe numrit të kufizuar të nxënësve. Ato duhet të jenë të vendosur në qendrat e njësive. Ajo çfarë është e nevojshme me qëllim lehtësimin sa më të madh të jetë dhe mundësinë e aksesit të nxënësve në ambientet e arsimit fillor është për shembull organizimi i stacioneve të autobusit në menyre të tilla që të garantohet siguria e nxënësve gjatë momentit të pritjes së autobusit të shkollës.
- *Ambientet e nivelit arsimor të shkollave të mesme* (shkollat e mesme, shkollat profesionale, qendrat profesionale, etj) duhet të jenë të vendosura në zona të cilat janë shumë të arritshme, duke përfshirë këtu edhe transportin publik. Për rastin e Qendres, nevojat për arsimin shkollor të mesëm gjenden aktualisht në qytetin e Vlorës.

Kuadri i ri ligjor parashikon normat minimale për njësi strukturore të banimit dhe nën njësi të lidhura me shpërndarjen e ambienteve arsimore:

- Kopshtet: Target: 30% e 10% të popullsisë të parashikuar ekuivalente. Siperfaqe Kati = 6 m<sup>2</sup> per fëmijë. Siperfaqe e parceles = Siperfaqe Kati / indeksi 0,4.

- Shkollat fillore: Target: 13% e popullsisë së parashikuar ekuivalente. Siperfaqja Kati = 6 m<sup>2</sup> per fëmijë. Siperfaqe e parces= Siperfaqe Kati / indeksi 0,4.
  - Shkollat e mesme: Target: 40% e 10% të popullsisë së parashikuar ekuivalente. Siperfaqe Kati = 6 m<sup>2</sup> per fëmijë. Siperfaqe e parces = Siperfaqe Kati / indeksi 0,
- Normat më të detajuara për ambientet arsimore janë treguar në tabelën e mëposhtme.

<b>Tabela 20 Normat për ambientet arsimore</b>				
<b>Vendndodhja</b>	<b>Klasat/kapaciteti</b>	<b>Madhësia e parcelës (ha)</b>	<b>Parcela m<sup>2</sup>/nxënës</b>	<b>Distanca ajrore e mbulimit të shërbimit</b>
<b>Çerdhe</b>				
<b>Qytet: 25-30 fëmijë / 1,000 banorë; Fshat: 13-15 fëmijë/ 1000 banorë</b>	1	0.09	30	200-300 m
	2	0.15	25	
	3	0.22	25	
	4	0.24	20	
	10	0.04	40	
	20	0.06	30	
<b>Kopshte</b>				
<b>Fshat</b>	1	0.15-0.2	24-32	500 – 900 m
	2			
	3	0.24-0.3	20-25	
	4			
	5	0.32-0.4	18-22	
	6			
<b>Shkolla 9-vjeçare</b>				
<b>Fshat</b>	8	0.6	20	1000
	16	0.8	28	1200
	24	1.2	21	1900
<b>ambientet e arsimit të mesëm</b>				
<b>Tipi i shkollës</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>Madhësia e parcelës (ha)</b>	<b>Parcela m<sup>2</sup>/nxënës</b>	<b>Distanca ajrore e zonës së mbulimit</b>
<b>Shkolla të mesme profesionale (shkolla turizmi)</b>	16	1.4	25	1000
	20	1.6	20	1200
	24	1.8	19	1400
	28	2	18	1500
<b>Shkolla të mesme në fshat</b>	8	1	31	2500
	12	1.4	28	3000
	16	1.6	25	4700

**Kujdesi shëndetësor-** Sigurimi i objekteve të kujdesit shëndetësor është një komponent thelbësor i standardeve të pranuar të jetesës dhe një parakusht i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, të bazuar në shërbimet cilësore. Vëmendje e veçante duhet t'i kushtohet banorëve të përhershëm të zonës (sidomos në rastet e popullsisë në moshë të madhe (plakje), si dhe për vizitorët dhe turistët nga perspektiva e rritjes së parashikuar të sektorit të turizmit.

Normat minimale të kujdesit shëndetësor jo spitalor, të rëndësishme për rastin qendrave shëndetësore (kujdesi shëndetësor primar) janë:

Qendrat Shëndetsore, njësia Qendër: Kapaciteti i kërkuar (Siperfaqja e Katit) = 0035 m<sup>2</sup> për banor (parashikohet popullsi ekuivalente). Siperfaqja e parcelave = Siperfaqe kati / 0,6 indeksi. Në këtë rast është konsideruar se nevojat në kujdesin spitalor janë të mbuluara nga qyteti i Vlorës.

dhe që i shërben një popullësie rezidente të madhe ka një veçori, përfshirjen e zonave të mëdha informale. Ky problem reflektohet në shumë drejtime por dy ato më kryesoret janë mungesa e planifikimit të infrastrukturës dhe shërbimet publike në keto zona. Kjo bën që standardet e planifikimit të adoptohen sipas nevojave faktike në të gjitha njësi administrative dhe fshatrat e kësaj Bashkie dhe veçanërisht vlen të theksohet në zonat informale. Element tjetër i rëndësishëm që lidhet me koordinimin e kuadrit ligjor dhe strategjive kombëtare sektoriale për bashkinë Vlorë është referimi i Vlorës me zhvillim zonë industriale-ekonomike që në të njëjtën kohë është zonë tampon për pjesën e mbrojtur mjedisore dhe në të njëjtën kohë kësaj zone në strategjinë kombëtare të turizmit i përcaktohet prioriteti për zhvillimin e turizmit. Në të ardhmen është e nevojshme të bëhet një renditje sipas rëndësisë së këtyre prioriteteve.

#### **4.5 Përcaktimet kryesore për temrat e referencës për planet vendore**

Bashkia Vlorë ka përcaktuar përmes kësaj PPV-je njësitë strukturore të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të planeve të detajuara vendore, mbi bazën e kritereve ligjore dhe atyre të parashtruara në këtë. Këto PDV do të hartohen me nismën publike ose private në zona të cilat janë:

- Një njësi strukturore;
- Disa njësi strukturore bashkë;
- Çdo zonë me prioritet për zhvillim

Qëllimi kryesor i PDV-ve do të jetë zhvillimi dhe/ose rihvillimi i një zone, rigjenerimi /ripërtëritja e një zone kryesisht urbane, ndërtimi i infrastrukturave publike. PDV-tw kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi. Nisma për hartimin e tyre duhet të mbështetet nga pronarët që kanë në pronësi jo më pak se 51 për qind të sipërfaqes së zonës, për të cilën propozohet PDV.

Kryetari i Bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detajuar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar dhe pasi ka informuar dhe kryer takime publike me palët e interesuara.

Kryetari i bashkisë vendos mbi miratimin e planit të detajuar vendor mbi bazën e raportit teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor dhe të botuar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të tretën e sipërfaqes së zonës përkatëse. Në rast se ka kundërshtime, kryetari i njësisë



së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrton vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor. Në përfundim të procesit, Kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara.

Këshilli Bashkiak monitoron procesin e miratimit të PDV-së dhe garanton respektimin e procedurave ligjore për miratimin e saj. Në rast se konstaton mangësi apo shkelje, këshilli e kthen PDV-në për rishqyrtim nga Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, brenda 60 ditëve nga miratimi i saj. Përpara vendimmarrjes së mësipërme, Këshilli mund të organizojë një ose disa takime publike me palët e interesuara.

Plani i detajuar vendor me nismë private regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksioni vetëm pasi të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në pronësi të autoritetit publik përkatës. Struktura, forma, pjesët përbërëse të përmbajtjes, procesi për nismën, informimin dhe takimet publike të detyrueshme, hartimin dhe miratimin e planit të detajuar vendor, kriteret për përcaktimin e kufijve të zonës që trajtohet me plan të detajuar vendor dhe kushte të tjera, përcaktohen në rregulloren e zhvillimit.

Procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

Përfitimet e Bashkisë Vlorë nga të drejtat për zhvillim dhe vlera e rritur e tokës do të përdoren për ndërtimin ose financimin e infrastrukturave publike, kryesisht në zonën ku janë përftuar.

Sipas VKM 671, Dokumenti i PDV-së përmban, të paktën:

- Dokumentin e analizës për zonën/njësinë;
- Strategjinë e zhvillimit të zonës/njësisë;
- Propozimin me përcaktime territoriale;
- Rregulloren e PDV-së;
- Vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin PDV-së (Studimin e fizibilitetit);
- Hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilës prej pikave më

sipër, në shkallën që varion nga 1:500 në 1:2,000, në përputhje me madhësinë e zonës;

- Relacionin e propozimeve të planit;
- Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis;
- Planin e veprimeve dhe investimeve për zbatimin e PDV-së;
- Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PDV-së;
- Në rastet e PDV-së me nismë private, dokumenti i PDV-së përmban edhe kontratën e bashkëpunimit mes palës private të interesuar për hartimin e PDV-së dhe autoritetit përgjegjës për hartimin e PDV-së.

Dokumentin e analizës për zonën paraprind përcaktimet e planit dhe bazohet në analizën e thelluar që ofrohet nga PPV-ja apo PVS-ja. Në çdo rast, analiza e zonës/njësisë përmban:

- Hartat në shkallë 1: 500 ose 1:2,000 në varësi të sipërfaqes së zonës/njësisë përkatëse, që prezantojnë rilevimin teknik të topografisë, hapësirave, përdorimeve, parcelave, objekteve dhe infrastrukturave në zonë, emërtimet, dimensionet, si dhe kufirin e saj;
- Dokumentim të detajuar fotografik të zonës/njësisë;
- Hartën shoqëruar me listën e pronarëve të parcelave dhe objekteve dhe të gjitha të dhënat për çdo pronë sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Relacionin me rregullat dhe hartat që tregojnë zonat dhe strukturat e mbrojtura, nëse ka të tilla, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe për trashëgiminë kulturore;
- Analizën e detajuar të problemeve mjedisore, të peizazhit dhe të infrastrukturave, në përputhje me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor apo planeve vendore sektoriale;
- Analizën e cilësisë së objekteve ekzistuese dhe të nevojave për rigjenerim, konservim apo mirëmbajtje.

Kushtet bazë të cilat do të aplikohen për një zonë të caktuar që i nënshtrohet PDV-së sipas një strategjie të caktuar:

- Relacionin dhe hartat për planin e propozuar të përdorimit të tokës pas riorganizimit të parcelave përmes ndarjes dhe/ose bashkimit. Përdorimi i tokës paraqitet për kategoritë bazë, nënkategoritë dhe për funksionet apo aktivitetet sipas shpërndarjes së tyre në parcela dhe në çdo objekt;
- Relacionin dhe hartat për planin e propozuar të të gjitha infrastrukturave të nevojshme kryesore dhe dytësore në zonë, përfshirë parkimin;
- Paraqitjen grafike të propozimeve për të garantuar akses dhe përdorim të

barabartë dhe të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat;

- përcaktimin në hartë dhe argumentimin në relacion të objekteve që do të shemben dhe atyre që do të rigjenerohen dhe/ose do të restaurohen;
- paraqitjen volumetrike dhe gjurmën e objekteve/strukturave të parashikuara;
- paraqitjen e detajuar në relacion dhe në hartë të shpërndarjes së intensitetit të ndërtimit dhe të koeficientit të shfrytëzimit të tokës për çdo parcelë, si dhe të distancave dhe lartësive të objekteve në përputhje me rregulloren e zhvillimit;
- mënyrën e zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në përputhje me ligjin dhe me rregulloret përkatëse.

Rregullorja e PDV-së përmban, të paktën,:

- Përkufizimet e termave të përdorur;
- Shpjegimin e kodeve të përdorura për:
  - kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
  - sistemet/ zonat/ njësitë;
  - kode të tjera sipas rastit.
- Normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas kësaj rregulloreje;
- Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, që përfshijnë, të paktën:
  - normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.
  - normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore, nëse ka elemente të tillë në zonë;
- përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu), nëse ka elemente të tilla në zonë.
- rregullat për zhvillimin e njësisë/zonës që përmbajnë, të paktën:
  - kushtet e zhvillimit;
  - kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
  - aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës;
  - përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.
- të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
- rregullat e nëndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi
- rregullat e sistemit rrugor dhe transportit që përmbajnë, të paktën:
  - përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
  - kushte teknike dhe përmasat;

- parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit, sipas legjislacionit të posaçëm;
- përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë anëve të trupit të rrugës;
- rregulla arkitektonike, sipas rastit;
- rregullat për përdorimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindjet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

#### 4.6 Përcaktimet kryesore për termat e referencës për planet sektoriale

Dokumentat më të rëndësishëm ku duhet bazuar hartimi i Planit Vendor sektorial janë:

Plani Vendor dhe Plani Kombëtar Sektorial. Pikëprerja e këtyre dy instrumentave përbën pikënisjen e hartimit të planit vendor sektorial. Një element tjetër që duhet marrë në konsideratë është hartimi i buxhetit afat mesëm dhe afatgjatë i buxhetit bashkiak në zbatim të këtij plani.

Autoriteti përgjegjës, përmbajtja e dokumentit të PVV-së, nisma për hartimin e PVS-së; hartimi i PVS-së, bashkërendimi i PVS-së, këshillimi dhe takimi publik në kuadër të PVS-së, botimi në regjistër i PVS-së, miratimi, hyrja në fuqi e PVS-së kryhen duke ndjekur si bazë procedurat e përcaktuara për PPV dhe PKS.

Disa nga planet sektoriale që duhet të hartohen në vijim të zbatimit të kësaj PPV-je janë:

**1. Plani sektorial për një turizëm të qëndrueshëm:** ky plan do të tentojë të përfshijë prioritetet në tipet e turizmit të cilat do të zhvillohen në zonë:

- Krijimi i formës së agroturizmit dhe promovimi i produkteve locale të zonës (vaj ulliri, vreshtari, pentari, agrume dhe nen produkte quemesh-djath) të njësive administrative Novosele, Orikum, Shushice
- Krijimi i formave të reja të turizmit natyror dhe kulturor, sport, aventurat në lagunat,
- Prezantimi i vazhdueshëm i produkteve të reja alternative në programin e paketave
- Eksplorimi i destinacioneve të turizmit ekologjik

- Rritja e segmentimit të tregut edhe nepermjet promovimit tw trageteve turistikw

**1- Plani sektorial i transportit, fokusuar ne transportin detar:** Me qëllim dhënien e zgjidhjeve afatgjata për të përmirësuar dhe eficientuar flukset e transportit privat dhe publik si dhe transportit te mallrave në Bashkinë e Vlorë, nepermjet planit duhet të synojë:

- a) Zgjidhjen e skemës së transportit nw çdo stacion/plazh dhe veçanerisht do tw synojw promovimin e transportit alternativ, ate me taxi ujore pergjate gjithe bregdetit si dhe gjithe sezonit turistik.
- b) Mundësimin e krijimit te disa shtigjesh biçikletash pergjatw vijws bregdetare nepermjet pedonaleve si pergjate plazhit te vjeter, skele dhe Karaburun.
- c) Promovimin e lëvizjës së gjelbër dhe uljen e emetimeve të karbonit në ajër
- d) Promovimi i portit te Vlores si port i karakterit miks por me synim për ta zgjeruar si destinacion dhe për tragetet.
- e) Lidhjet më eficiente të zonave te brendshme me zonat pergjate bregdetit me qellim qe te kemi permiresim te sherbimeve shëndetësore, arsimore dhe sociale përmes transportit publik

**2- Plani sektorial i menaxhimit të mjedisit:** Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mjedisit në Bashkinë Volrë dhe mbrojtjen e pasurimev/bnurimeve natyrore si avantazhi me i forte qe kjo zone ka . Ky plan duhet të përmbaje minimalisht:

1. Menaxhimin e zones se mbrojtur Kartaburim-Llogara; Narte-Vjose.
2. Menaxhimin e hotspoteve, TEC, porti i Vlores, zona industrial ekonomike.
3. Menaxhimi i gjithe zonave te plazhit.

**3- Plani sektorial i strehimit:** i cili duhet të synojë garantimin e mundësive të strehimit të përballueshëm financiarisht për të gjithë popullsinë rezidente te Bashkisë w Ky plan duhet të përmbajë minimalisht:

- a. Analiza të thelluara demografike, që evidenton problematikën e bashkisë, analizen e zonave si dhe problematika te tjera qe ka kjo bashki.
- b. Analizë të thelluar mbi situatën aktuale të strehimit në Bashkinë Vlore si dhe evidentimin e stokut te banesave te pashfrytezuara.
- c. Propozime të skemave të ndryshme financiare dhe rolit që duhet të luajë Bashkia për të garantuar strehim të përballueshëm
- d. Propozime konkrete mbi projekte komunitare me fokus strehimin social

## 4.7 Evidentimi i faktorëve që mund të shkaktojnë një rishikim të pjesshëm të PPV

PPV-ja është një dokument i cili hartohet nga Bashkia mbi bazen e kërkesave dhe zhvillimeve kombetare nwn drejtimin e AKPT-së bazuar ne ligjin 107/2014, dhe është dokumenti baze udhëzues për zhvillimin në 15 vitet e ardhshme të territorit. Faktorwt tw cilet shkaktojnë rishikimin e PPV-sw, sipas pikës 2, të Nenit 26 të Ligjit 107/2014 konform procedurës që përcaktohet në të. Faktoret janë:

- Në rastin kur kemi ndryshime të caktuara territoriale si ndarje administrative që çon në ndryshime dhe ndarje të re territoriale
- Në rastin kur kemi ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore
- Në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo të përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Procesi i rishikimit dhe i miratimit të planit realizohet sipas përcaktimeve të procedurës së thjeshtuar në përputhje me nenin 14, të VKM 607, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”. Procedura e thjeshtuar është procedura e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të rishikimit të dokumenteve të planifikimit sipas parashikimeve ligjore përkatëse.

Përfundim nga ky rregull përbëjnë planet e detajuara vendore.

Procedura e thjeshtuar, zbatohet kur:

- PPV-ja e Bashkisë Vlorë do të rishikohet për çështje që nuk prekin qëllimet e përmbajtjes së saj dhe nuk cenon vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore;
- rishikimi i rregulloreve të planifikimit nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale dhe të parashikimeve të planit përkatës;
- rishikimi i dokumenteve sipas pikës 1, më lart, shoqërohet me kritere apo kushte më të hollësishme sesa dokumenti në fuqi;
- parashikohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.

Përdorimi i procedurës së thjeshtuar ka për efekt përfundimin e miratimit të nismës si dhe përgjysmimin e afateve të përcaktuara për bashkërendimin e këshillimit dhe takimit publik sipas ligjit të planifikimit dhe akteve nënligjore përkatëse.

## 5. Shtojca e PPV-ve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TEKSTI  
I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË \_\_\_\_\_ MIRATOHET  
KRYETARI I KKT-së

\_\_\_\_\_  
KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Miratuar me vendim të këshillit të bashkisë \_\_\_\_ nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_  
Hartuar nga: Bashkia \_\_\_\_\_  
Subjekti i kontraktuar: \_\_\_\_\_  
Subjekti mbështetës: \_\_\_\_  
Me financim të: \_\_\_\_\_

### 1. Të dhëna të përgjithshme për bashkinë

	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
1.1	Sipërfaqja e njësisë vendore	64922 ha	Sipërfaqet Natyrore, Ujore, Tokat Bujqesore, Tokat Urbane, Infrastruktura
1.2	Numri i popullsisë ekzistuese	104827 banorë	Popullsia rezidenciale sipas INSTAT
1.3	Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	29200 ha	Peisazhi i Mbrojtur Kombëtar Vjose-Narte Zona e Mbrojtur Kombëtare e Karaburun - Sazan Manastiri i Zvernecit Kalaja e Kanines Zona Arkeologjike e Triportit Monumente Individuale të deklaruara
1.4	Sipërfaqet e miratuara të zonave informale	610 ha	Zonat e aprovuara nga ALUIZNI (Babica, Vlore zona informale)
1.5	Problematika mjedisore	-	Trajtimi i shkarkimeve të ujërave të zeza që derdhen nga Qyteti i Vlores dhe ish Komunes Qender Ndertimi i fabrikës së mbetjeve të ngurta

## 2. Propozime të PPV-së

	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
2.1	Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme	-	Zhvillimi turistik dhe investime shoqëruese Aktivitete Turizmi te interesit te vecante (ekoturizem, agroturizem) Numer i kufizuar i shtëpive të dyta
2.2	Përdorimet kryesore të propozuara të tokës	-	Rezidenciale, Turizem, Bujqesi, Gjendje Natyrore
2.3	Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	3000-5000 banore	Vleresimi sipas studimeve ekonomike dhe demografike
2.4	Numri total i turistëve të pritshëm për 15 vitet e ardhshme	130.000 Turiste	Duke përfshirë edhe për imigrantet e kthyer, punëtorët sezonalë dhe banorët e shtëpive të dyta.
2.5	Sipërfaqja totale ekzistuese e urbanizuar	2919 ha	Sipas hartës (orthofotos) të vitit 2013 dhe 2015
2.6	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	39 ha	Shtëpive kryesore dhe të dyta në zonat e zgjerimeve të vendbanimeve dhe zonat e reja
2.7	Sipërfaqja totale e ndërtimit të shtuar për zhvillimin e turizmit	72 ha	Zonat e percaktuara turistike duke përfshirë kamping dhe aktivitetet ekologjike dhe infrastruktura turistike
2.8	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	212 ha	Shërbimet publike dhe zonat e Aktiviteteve tregtare dhe industriale
2.9	Sipërfaqja e përgjithshme e zonave në mbrojtje	60290 ha	Zonat Natyrore, zonat Bujqesore dhe zonat e Trashëgimise Kulturore
2.10	Sipërfaqja e përgjithshme e banesave për strehim social	2.5 ha	
2.11	Sipërfaqja të gjelbra shtesë	75 ha	Hapësirat e Gjelbra Zona sportive
2.12	Numri i njësive strukturore	858	Harta e Njesive strukturore



### 3: Të dhëna financiare

Emërtimi		Vlera dhe Njësia	Specifikime
3.1	Vlera e përgjithshme e planit e investimeve kapitale	150.000.000 Euro	Në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
3.2	Fazat e zbatimit të zhvillimit	Çdo 5 vite ose periudhat përkatëse.	Të ndara në periudha brenda vlefshmërisë kohore, të planit për njësitë dhe nën njësitë strukturore përkatëse\
3.3	Studimin teknik të parafizibilitetit		Argumentohet zgjidhja e propozuar dhe kostot e përafërta me zërat kryesore

### 4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim

Nr	Kapitulli/Dokumenti	Hartohet / Miratohet	Referenca Ligjore	Check list
1	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 52 i VKM 671, 29.07.2015	✓
2	Analiza dhe vlerësimi i territorit	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 53 i VKM 671, 29.07.2015	✓
3	Parashikimet e planit	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Sipas Neni 54 i VKM 671, 29.07.2015	✓
4	Vlerësimi strategjik mjedisor	Hartohet dhe miratohet	Sipas Ligjin Nr. 91/2013	✓
5	Materiali hartografik	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 57 dhe Stoica 1 i VKM 671, 29.07.2015	✓
6	Rregullorja e PPV-së	Hartohet dhe miratohet	Sipas Neni 56 i VKM 671, 29.07.2015	✓

### 5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit

Nr	Tematika e hartës	Lloji i hartës	Shkalla	Kodi i Hartës	Check list
----	-------------------	----------------	---------	---------------	------------

1	Harta Bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:25.000	1	✓
2	Harta Përjashtimore	Harta e elementeve përjashtues	1:25.000	1a	✓
3	Harta Administrative	Hartë kufijtë administrativ	1:25.000	1c	✓
4	Harta Topografike	Harta terrenit	1:25000	2	✓
5	Hartat e elementeve ekzistuese të territorit	Harta gjeologo - inxhinierike	1:25.000	2a	✓
6		Harta hidrogeologjike	1:25.000	2b	✓
7		Harta e rreziqeve gjeologjike	1:25.000	2c	✓
8		Harta hidrografike	1:25.000	2d	✓
9		Harta e burimeve natyrore	1:25.000	2e	✓
10		Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore	1:25.000	2f	✓
11		Harta e bonitetit të tokës	1:25.000	2g	✓
12		Rrezikshmeria Sizmike	1:100.000	2h	✓
13	Pozicionimi strategjik me raport në rajonin	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik	1:100.000 1:300.000	3	✓
14	Vlerësimi Ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punëtore.	1:100.000	4	✓
15	Vlerësimi Social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:25.000	5	✓
16	Vlerësimi Demografik	Përqendrimi i popullsisë në territor	1:25.000	5a	✓
17	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integritit	1:25.000	7 7a	✓

18	Harta e Rëndesise Kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:25.000	8	✓
19	Problemet Mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor	1:25.000	9	✓
20	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë; funksionet dhe aktivitetet	1:25.000	10	✓
21		Nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet	1:10.000	10a	✓
22	Infrastrukturat	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm	1:25.000	11a	✓
23		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza	1:25.000	11b	✓
24		Rrjeti rrugor ekzistues	1:25.000	11c	✓
25		Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji	1:25.000	11d	✓
26	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rizhvillim.	1:25.000 1:10.000	12 12a	✓
27	Tipologjitë hapësimore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave	1:25.000 1:10.000	13 13a 13b	✓
28	Periferaliteti	Zona sipas: largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; nivelit të kriminalitetit; problemeve të ndryshme sociale	1:100.000	14	✓
29	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim	1:25.000	15	✓
30	Metabolizmi Urban	Harta e fluksit të ujit	1:25.000	16a	✓

31		Harta e fluksit te energjisë	1:25.000	16b	✓
32		Harta e fluksit te mbetjeve	1:25.000	16c	✓
33		Harta e fluksit i ushqimit	1:25.000	16d	✓
34	Sistemet Territoriale – (situate eksistuese)	5 Sistemet Territoriale	1:25.000	17	✓
35		Sistemi Urban	1:25.000	17a	✓
36		Sistemi Natyror	1:25.000	17b	✓
37		Sistemi Ujor	1:25.000	17c	✓
38		Sistemi Bujqësor	1:25.000	17d	✓
39		Sistemi Infrastrukturor	1:25.000	17e	✓
40	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimit kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat; fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:25.000	18	✓
41	Parashikimi i përdorimit të tokës	Harta e 5 sistemeve territoriale	1:25.000	18a	✓
42		Harta e kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara	1:25.000	18b	✓
43		Harta e nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara	1:10.000	18c	✓
44		Harta e zonave, poleve, korridoreve ekonomik të propozuara	1:25.000	18d	✓
45		Harta e mënyrave të ndërhyrjes të propozuara	1:25.000	18e	✓
46		Harta e tipologjisë të ndertimeve	1:10000	18f	✓
47		Harta e zonave objekteve me vlera historike të propozuara	1:25.000	18g	✓
48		Harta e zonave me prioritet zhvillimi dhe zonave subjekt i PDV	1:25.000	18h	✓
49		Harta e njesive strukturore	1:25.000	18i	✓

50		Harta e shpërndarja e popullsisë dhe planit të strehimit	1:25.000	<b>18j</b>	✓
51	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar	1:25.000	<b>19a</b>	✓
52		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar	1:25.000	<b>19b</b>	✓
53		Rrjeti rrugor dhe vendparkimeve publike të propozuar	1:25.000	<b>19c</b>	✓
54		Rrjeti i furnizimit me energji te propozuar	1:25.000	<b>19d</b>	✓
55		Hapësirave publike, rrugëve të biçikletave dhe kembesore të propozuar	1:25.000	<b>19e</b>	✓
56		Objektet e shërbimeve sociale	1:25.000	<b>19f</b>	✓
57	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave;	1:25.000	<b>21</b>	✓

## 6. Raporti për Kapacitetet Institucionale

Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e qeverive vendore janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe të shumëllojshme. Me gjithë përparimin e bërë gjatë dekadës së fundit, sigurimi me efikasitet dhe përgjegjshmëri i shërbimeve cilësore publike në nivel vendor po përballet ende me sfida të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve të burimeve institucionale dhe njerëzore. Kapaciteti i kufizuar për të hartuar dhe zbatuar strategji të integruara të zhvillimit vendor dhe planeve të zhvillimit territorial, për hartimin e programit buxhetor afatmesëm vendor, aftësia për të trajtuar kompleksitetin rregullator dhe qëndrueshmërinë e strukturave të trajnimit kanë qenë disa nga sfidat kryesore për funksionimin e administratës së qeverisjes vendore.

Sipas Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, fuqizimi i administratës vendore është një objektivi kryesor në suksesin e një sërë reformave si ajo territoriale, ajo e decentralizimit të administratës publike në nivel vendor etj. veçanërisht një sfidë e madhe është ajo e zbatimit të planeve të përgjithshëm vendorë. Strukturat e bashkive të reja po rishikohen në mënyrë që të përshtaten me ndryshimet e reja, për të siguruar koherencë të mirë mes politikave të hartuara dhe të zbatuara në nivel vendor. Performanca e kërkuar dhe kapaciteti adekuat i administratës vendore do të arrihen përmes promovimit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe trajnimeve afatshkurtër dhe afatgjatë.

Reforma territoriale e ka vendosur Bashkinë e Vlorës në një status krejt të ndryshëm përse i takon hapësirës gjeografike-administrative në juridiksion, e si rrjedhojë problematikave dhe kompleksitetit të tyre. Vetëm fakti që, bashkia e Vlorës ka tashmë në përgjegjësinë e vet edhe hapësira jo urbane, zona rurale dhe toka me përdorime bujqësore, është një sfidë e konsiderueshme për punën e përditshme të këtij institucioni. Si rrjedhojë, këto ndryshime të mëdha dhe nevojat tepër të ndryshme të qytetarëve dhe të territorit në zhvillim, kërkojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale në të tjera nivele, për të përballuar me sukses realizimin e këtij Plani të Përgjithshëm Vendor.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vlorë është i domosdoshëm angazhimi i një sërë sektorësh/departamentesh në vënien me sukses në praktikë të tij, duke qënë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një koncept urbanistik. Në këtë kontekst, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe marrja e përgjegjësisë institucionale gjykohet tepër thelbësore veçanërisht për sektorët që përballen me zinxhirin e zbatueshmërisë së PPV:

***Drejtoria Juridik*** me sektorin e Prokurimeve Publike dhe ***Drejtoria e Mrojtjes së Tokës dhe Menaxhimit të Aseteve***, mbështesin *Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban*, duke ofruar konsulencën e nevojshme ligjore në zbatimin e

planit. Prokurimet do të duhet të bëhen një mekanizëm lehtësues dhe garantues i suksesit të investimeve të mundshme si në hartimin e instrumenteve të përcaktuar nga PPV ashtu dhe në programet e projekteve pilot të ndarë sipas fazave. Asetet publike, veçanërisht menaxhimi i hapësirave publike dhe objekteve, marrin gjithashtu një rëndësi themelore në sugjerimet e PPV-së.

*Drejtoria e Menaxhimit Financiar me sektorët e Qendrës Ekonomike* është monitoruese e programit buxhetor dhe sigurohet që parashikimet e PPV reflektohen në PBA. Monitoron situatën e buxhetit dhe çdo vit paraqet raportin për buxhetin ku ofrohen dhe rekomandimet përkatëse për zbatimin e planit. Monitoron të ardhurat të cilat gjenerohen nga bashkia dhe të ardhurat të cilat vijnë drejtpërdrejtë nga parashikimet dhe zbatimi i PPV. Në fund, ofron rekomandimet përkatëse dhe ndryshimet e nevojshme në PPV.

*Drejtoria e Burimeve Njerëzore me sektorin e Protokoll-Arkivës* mbështet drejtoritë e tjera në zbatimin e PPV me anë të shërbimeve të tjera mbështetëse sipas nevojës.

*Institucionet në varësi të bashkisë Vlorë.* Secili institucion në varësi të bashkisë Vlorë koordinon me drejtorinë e planifikimit të territorit të Bashkisë zbatimin e PPV si dhe të programeve përkatës. Çdo vit, drejtoritë hartojnë raportet përkatëse të monitorimit, të cilat i paraqiten bashkisë Vlorë së bashku me rekomandimet specifike dhe konkrete.

*Njësitë administrative.* Koordinojnë me drejtoritë e planifikimit dhe kontrollit të territorit zbatimin e planit dhe monitorimin e tij. Njësitë ofrojnë shërbime këshilluese ndaj qytetarit.

## **6.1. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale të Departamentit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Vlorë.**

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon një qasje më realiste ndaj burimeve njerëzore, që disponon sot Bashkia Vlorë. Funksione të ndryshme, që lidhen me proceset e lejeve të ndërtimit, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e pranisë së arkitektëve/urbanistëve/planifikuesve të kualifikuar, që do të kenë përgjegjësi kryesore në procese teknike, si dhënia e përshtatshmërisë apo aplikueshmërinë e legjislacionit në projekte. Po kështu, inxhinierë ndërtimi do të duhet të vlerësojnë zbatimin e normave teknike. Për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor janë të nevojshëm një sërë ekspertësh të të gjitha fushave që kanë të bëjnë me territorin, si: arkitektë, urbanistë, inxhinierë hidro, inxhinierë ujësjellës-kanalizimi, inxhinierë mjedisi etj.

Analiza mbi gjendjen e kapaciteteve institucionale të bashkisë së Vlorës arriti të dallojë se, mes kufizimeve, ato me ndikim më të ndjeshëm janë:

- Mungesa e kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës në pjesët e reja të territorit bashkiak, i cili është disa herë më i madh nga ai i që bashkia e vjetër e Vlorës administronte para reformës;
- Mungesa e përvojës institucionale në trajtimin e çështjeve të zhvillimit bujqësor dhe në funksionimin e rrjetit kullim-vaditje;
- Mungesat në të dhënat dhe informacionin mbi territorin e ri;
- Mungesat e njësive administrative në bazë materiale të domosdoshme për performancë efikase si PC, Printer, Softëare, etj.;
- Mungesa e kapaciteteve të plota të specializuara në hartimin e planeve sektoriale lokale të menaxhimit të zonave të mbrojtura e mbetjeve urbane, si dhe të planeve të detajuara vendore.

*Drejtoria e Planifikimit dhe Projektimit te Territorit me sektorët e Planifikim Territori, Kontroll-Zhvillimi, Përmirësim Mjedisi dhe Rregjistri Elektronik* kontrollon drejtpërdrejt zbatimin e PPV për Bashkinë Vlorë. Shërben si koordinues edhe për sektorët e tjerë. Detajon PDV sipas rastit. Hallka më e rëndësishme në procesin e monitorimit të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Koordinon dhe monitoron mbarëvajtjen e zbatimit të investimeve në fushën mjedisore dhe monitoron situatën mjedisore. Monitoron zbatimin e planit dhe në fund të çdo viti përgatit një raport vlerësimi ku ofron dhe rekomandimet përkatëse për PPV. Aktualisht, Drejtoria Planifikimit & Kontrollit të Zhvillimit të Territorit përbëhet nga 14 punonjës.

*Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve me sektorët e Shërbimeve sipas 5 njësive administrative Novoselë, Orikum, Qendër, Shushicë* është drejtpërdrejt e lidhur me koordinimin e investimeve të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Territoriale, si dhe parashikimet për investime të planifikuara në PPV. Përgatit raportin përfundimtar të monitorimit në lidhje me ecurinë e investimeve, si dhe jep rekomandime për ndryshimet përkatëse në PPV. Aktualisht, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve përbëhet nga 11 punonjës.

### **6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki**

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të Bashkisë Vlorë nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi. Për këtë, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh janë hartuar dhe renditur në vijim. Këto rekomandime prekin si zbatimin e planit vendor, ashtu dhe ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për hartimin e Planeve Sektoriale, Planeve të Detajuar Vendore apo dhe Masterplaneve.



Mangësitë kryesore të vëna në dukje janë:

- Mosfunksionimi i regjistrimit të të dhënave të lidhur me AKPT;
- Vështirësi në aplikimin on-line të lejeve të zhvillimit.
- Mangësi në ekspertë GIS dhe në përdorim GIS në bashki

Bazuar mbi gjetjet e mësipërme, gjykohet se një sërë masash do të mund të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Vlorë sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij. Si më të rëndësishmet ndër të këto masa, renditen:

Krijimi dhe formalizimi i databazës së informacionit

- Të zgjerohet zyrë e statistikave vendore, që do të grumbullojë të dhëna statistikore bazuar në treguesit e propozuar në plan, si dhe për nevoja të tjera lokale;
- Të plotësohet databaza e informacionit dhe inventarizimit të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe elementeve të tjerë të klasifikueshëm që përfshihen në territorin e bashkisë Vlorë;
- Të kryhet inventarizimi dhe krijimi i një databaze të mirë informacioni në lidhje me zhvillimin ekonomik;
- Të plotësohet baza materiale e vetë bashkisë, si dhe e njësive administrative me pajisje e domosdoshme për arritjen e këtij objekti si PC, Printer, softëare të nevojshëm si Autocad, GIS, etj.

Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të bashkisë në fushat më prioritare si më poshtë:

- Planifikim dhe Menaxhim Territori;
  - Hartim politikash zhvillimi
  - Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit
  - Përdorim i GIS dhe Regjistrimit të Territorit
  - Menaxhim Projektsh
  - Rregulla të përdorimit të tokës
- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim Rural dhe Menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;

- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

### **6.1.2 Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit**

Mbështetur në VKB e vitit 2015 për ndryshimin e funksioneve të komunave dhe përfshirjen e tyre në bashkinë Vlorë, në VKB nr.1, datë 04.02.2016 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve në Varësi dhe të Njësive Administrative 2016”, dhe në Vendimin nr. 46 datë 15.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë “Për disa ndryshime në Strukturën organizative të Bashkisë Vlorë dhe Institucioneve vartëse-2016”, struktura organizative e bashkisë Vlorë përbëhet nga 331 punonjës.

Nëse stafi i tanishëm i Bashkisë së Vlorës është një bërthamë funksionale me përvojë që garanton një proces koordinues efikas të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, nuk ka ende mjaftueshëm specialistë të fushës së GIS, të planifikimit, arkitekturës e urbanistikës. Kjo mungesë mund të reflektohet në probleme gjatë zbatimit të planit dhe projekteve të tij veçanërisht në njësi ku ka zona të ndjeshme me vlera dhe nën presion zhvillimi. Për këtë arsye, sugjerohet pasurimi i organikave, në fillim të njësive të caktuara, me specialistë arkitektë/urbanistë, por edhe inxhinier hidro, specialiste mjedisi dhe ekspertë GIS.

Më konkretisht, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit është në nevojë të fuqizimit me staf profesional veçanërisht për 2 ekspertë shtesë, që specifikisht duhet të jenë: 1 ekspert mjedisor dhe 1 ekspert GIS, ndërkohë që nga personeli ekzistues 3 duhet të jenë inxhinierë hidro.

Po kështu, Drejtoria e Planifikimit dhe Projektimit të Territorit ka nevojë për një strukturë ekstra, prej të cilëve 10 duhet të jenë arkitektë, minimalisht 2 duhet të jenë inxhinierë mjedisi dhe 4 duhet të jenë ekspertë GIS.

Departamenti i Urbanistikës nuk ka ndarje sektoriale, prandaj sugjerohet të ndahet në 2 sektorë: Sektori i Zhvillimit dhe Sektori i Lejeve.

Po hapet Departamenti i Projekteve të Huaja (*PIU - Project Implementation Unit*) që minimalisht duhet të përbëhet nga 4 ekspertë me kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve, në research dhe të kenë eksperiencë të ngjashme të mëparshme. Ky departament mund të jetë me financim të bashkisë ose në marrëveshje me donatorë të ndryshëm për të koordinuar punën në zbatimin e planit gjatë vitit të parë të zbatimit. PIU gjithashtu do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV.

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- marrëveshje për zbatim projektsh të përbashkëta,
- marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e databazës së të dhënave,
- marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore,
- marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike,
- ndërgjegjësimin e publikut
- ngritjen e kapaciteteve vendore
- monitorim të situatës mjedisore

Në njësitë administrative të Vlorës (Bashkia Vlorë) vlerësohet se, gjendja e hapësirave të punës ofron mjaftueshmëri sasiore. Përsa i përket gjendjes fizike dhe pajimit, në këtë institucion mbetet shumë për t'u përmirësuar, veçanërisht në pjesën e teknologjisë, pajisjeve në dispozicion të stafeve teknike dhe teknologjisë se ARC-GIS Ndërkohë, përsa i përket njërive administrative nevojiten disa ndërhyrje në zgjerimin e mjedisëve, në rregullimin dhe rikonceptimin e tyre për t'i bërë efikase e për tu përshtatur me kërkesat e reja.

Më tej, lidhur me logjistikën që pritet të mbështesë bashkinë e Vlorës në zbatimin e PPV-së dhe kontrollin e zhvillimit të mëtejshëm të territorit, vlen të theksohet se do të nevojitet një përmirësim i kushteve të punës dhe përforsim i kapacitetit logjistik të bashkisë me mjete transporti, të nevojshme për t'i bërë të gjitha territoret e reja, të përfshirë rishtaz nën këtë bashki, të arritshme dhe menaxhueshme në kushte optimale.

#### *6.1.2.1 Planifikim pro-aktiv; takime me përfaqësuesit e komunitetit dhe grupeve të interesit për përgatitjen e planeve dhe raporteve*

Bashkia e Vlorës synon të rrisë transparencën ndaj publikut dhe të përmirësojë shërbimet, duke modernizuar dhe digjitalizuar një sërë shërbimesh, të cilat lidhen me Bashkinë. Janë krijuar programe, të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare dhe krijojnë mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë. Megjithatë, në vëmendje të Bashkisë Vlorë duhet të jetë ofrimi i shërbimeve specifike *online*.

Në planin afatgjatë, në vizionin e Bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve qëndrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përsa i përket planifikimit dhe

zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësitë komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qëndrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurojnë me njëra tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia.

Ndihet e nevojshme ngritja e kapaciteteve për të gjithë stakeholders për procedurat e aplikimi *online* te AZHT.

#### *6.1.2.2 Nevoja për infrastrukturë dhe lehtësimin e kërkesave të agjensive të shërbimeve*

Në kuadër të zbatimit të PPV bashkia Vlorë duhet të hartojë një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme qeveritare si dhe me partnerë të tjerë lokale apo edhe me komunitetet. Një sërë marrëveshesh ndërlidhen me:

- Marrëveshje në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit (me Agjencine Kombëtare të Turizmit dhe Agjencinë e Bregdetit) dhe zhvillimit rural;
- Marrëveshje me seksionin përkatës të Ministrisë së Buqësisë për përmirësimin e cilësisë së tokës dhe të ruajtjes së tokës bujqesore;
- Marrëveshje në fushën e mjedisit me Agjencinë Rajonale të Mjedisit
- Marrëveshje me institucione akademike dhe profesionale lokale dhe Universitetin “Ismail Qemali” për ngritjen e kapaciteteve vendore në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të territorit;
- Marrëveshje me MZHU/AKPT për mbështetje në zbatimin e PPV;
- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar/ rajonal;
- Marrëveshje me ZRPP
- Marrëveshje me seksionin e Monumenteve të Kulturës në Ministrinë përkatëse.

#### *6.1.2.3. Asistenca për procedurat e legalizim-rregjistrim të pronës dhe ballafaqime me çështje të tjera të planifikimit dhe të zhvillimit*

Kryetari i Bashkisë Vlorë ngre, me urdhër, grupin përbërës për shqyrtimin dhe këshillin teknik për lejet e ndërtimit. Grupi i ngritur me urdhër të kryetarit shqyrton dokumentacionin, si dhe përgatit me shkrim raportin teknik së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet përkatëse për kryetarin e bashkisë. Grupi duhet të përbëhet **të paktën** dhe jo vetëm nga:

- Përfaqësues i drejtorisë Ligjore (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i sektorit të planifikimit të territorit (2 përfaqësues - njëri prej tyre kryetar i grupit të punës)

- Përfaqësues i sektorit të kontrollit të territorit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i sektorit të mjedisit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i drejtorisë së shërbimeve dhe infrastrukturës (1 përfaqësues)
- Përfaqësues nga rajoni (për njësinë administrative Vlorë) ose përfaqësues nga njësi administrative ku aplikohet leja.

Grupi i punës mund të mbledhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e kërkesave për leje në mënyrë që të respektohen afatet ligjore përkatëse. Gjithashtu, për koordinimin e grupit të punës përdoret sistemi elektronik i lejeve.